Rruga e Arbërit

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (121). MAJ 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

OPINION

Duhen njerëz në krye të punëve, jo në bisht të partive

NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 5

PROFIL

Vëllezërit Mehmeti, në kërkim të teknologjive të reja

NGA **OSMAN XHILI** - FAQE 7

HISTORI

Dy dervishët që zhveshën Hysni Pashën

NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 19

SPORT

Golloborda, djepi i mundjes shqiptare

NGA **XHELIL CIBAKU** - FAQE 17

Sport

Korabi në Superligë, ëndrra e realizuar e dibranëve

Pas 55 vitesh, Korabi rikthehet mes më të mirëve të futbollit shqiptar, pra në Kategorinë Superiore. Një sukses që bëhet edhe më sugjestionues kur kujtojmë që vetëm një vit më parë ekipi dibran kishte siguruar ngjitjen në Kategorinë e Parë.

NGA **EDUARD ILNICA** - FAQE 11,15



Defrim Methasani, Qytetar Nderi:

Sa të kem jetë do t'i mbetem borxh Dibrës!

"Personalitet i spikatur dhe udhërrëfyes në udhëtimin e gazetarisë sportive, që me cilësi personale, njerëzore e sportive ngriti në nivelet më të larta sportin, emrin e ekipit të futbollit Klub Sport Korabi në Dibër e mbarë Shqipërinë, duke u bërë ambasador i denjë i Dibrës dhe misionar i sportit shqiptar". Me titullin "Qytetar Nderi" Këshilli Bashkiak i Dibrës vendosi ka nderuar edhe ekipin e futbollit të Korabit, me motivacionin "Për përfaqësim dinjitoz në ngritjen dhe lartësimin e futbollit dibran në superiore".

NGA **BUJAR KAROSHI** - FAQE 12,13

Siguria dhe zhvillimi social-ekonomik që sjell Rruga e Arbrit



Rruga e re rrit sigurinë e jetës personale. Ajo ndikon në rritjen e sigurisë shëndetësore dhe ekonomike.Siguria ekonomike lidhet me sigurinë e të ardhurave të mjaftueshme të çdo familje, garantimin e pandërprerë të të ardhurave, punësimin dhe shmangien e krijimit të papunësisë, qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e standardit të jetesës, aksesin në rrjetet e siguracionit të jetës e pronës.

Ritja e prodhimit vendas, zgjerimi i llojeve të produkteve dhe shërbimeve, si dhe rritja e investimeve nga kryeqyteti e rajone të tjera të vendit apo e investimeve të huaja, të cilat i lehtëson rruga e re, sjell rritjen e kërkesës për vende të reja pune.

Rruga e Arbrit, duke rritur prodhimin dhe punësimin, si dhe aksesin e popullsisë së rajonit të Dibrës dhe rajoneve fqinje të saj në territorin e vendit, ndihmon drejtpërdrejt në uljen e varfërisë. Kjo u jep qytetarëve akses drejt të njëjtave shanse, duke ndikuar në rritjen e kohezionit dhe integrimit social të këtyre rajoneve të thella të vendit.

Ritja e prodhimit dhe tregëtisë, ulja e kostos, aksesi më i shpejtë me rajone të tjera të vendit, rritja e punësimit dhe e të ardhurave përmirëson sigurinë ushqimore të popullsisë. Kjo do të thotë lehtësim i sigurimit të ushqimeve bazë për të gjithë, në mënyrë që të mos ketë familje që vuajë nga uria.

Nga Dr. **ASTRIT GJUNKSHI** - Faqe 3

reportazh

Josif Bageri, rilindasi "rebel"

Nga **Prof.as. Dr. GENCI LUARASI**

Ne grykën e Parkut Kombëtar të Dibrës fshati Nistrovë është i fshehur nga drurët shekullorë, ku dëgjohet gurgëllima e përroit të Bukovarit, degë e Radikës, buzë të cilit në Rekën e Epërme, fshati në fjalë njihet i rregjistruar 400 vjet më parë në regjistrat kadastralë të Perandorisë Osmane, i banuar me të krishterë shqiptarë, të cilët edhe nën pushtimin osman, nuk e ndryshuan fenë e tyre për arsye të vendodhjes së tyre dhe te karakterit malësor. Fshati me pamjen nga perëndimi sheh Radikën që kohët e fundit, edhe me botimin e ri të studiusve dibranë, ka marrë emër për problemet hidrike dhe mikroklimën...

LEXONI NË FAQET 8 - 9

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>** ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin

www.knauf.al

cyan magenta yelloë black 1

Falenderojmë z. Halil Teodori për donacionin e dhënë për botimin e këtij numri.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ky ishte muaji më i vështirë për të shkruar diçka, pasi pata konkurrencë të tmerrshme me lajmet serioze. Nuk jam në gjendje të dalloj lajmin e vërtetë nga trillimi. Dhe kështu kam frikë se nuk del i bukur shkrimi... Dibra këtë muaj ia ka dalë të mbajë me muhabet gjithë dynjanë në katër anët e botës dhe për këtë duhet vlerësuar...

Në redaksi pata një fluks shkrimesh me vrimë dhe pa vrimë dhe ne vendosëm të mos botonim asnjërin. Sepse kur është koha për të shkruar, nuk shkruajmë, se duam ta mbajmë mirë me qeveritarët, ama kur ata thyejnë qafën, ne nxitojmë t'u japim një shkelm... Jo për t'i dënuar, por për të dëshmuar "dashurinë" ndaj qeveritarit të ri...

Bashkë me kryetarin, tre këshilltarë ikën nga këshilli. Jo se bënë ndonjë krim apo u doli ndonjë video, por se nuk kanë plotësuar atë formularin e "de-kriminalizmit"... Dhe nuk u mor vesh, ishin kriminelë apo se nuk dinin këndim e shkrim për ta plotësuar... Ose, ndoshta edhe kanë harruar ta plotësojnë... Kur njeriu harron krimet që ka bërë, nuk është çudi pse harron edhe ta plotësojë një copë letër...

Por në Dibër nuk ka veç dështime. Ka edhe suksese! Korabi u ngjit në superiore. Shyqyr, se tani janë qetësuar edhe tifozët, edhe kundërshtarët. Një premtim e kemi mbajtur. Të tjerat do t'i mbajmë herët e ardhshme.

Komisioni i Disiplinës i dënoi tifozët e Korabit me 1 vit jashtë stadiumit! O sa mirë, tani Korabi nuk do ketë nevoje të udhëtoje 5 orë me mikrobus për një ndeshje fantastike me tifozë, por do t'i zhvillojë ndeshjet ne Krujë, Tiranë e Durrës dhe tifozët hudashës do ta shohin ndeshjen para televizorit në kuzhinë, tu pi birra e tu sha nga nëna kundërshtarët...

Dibra ia ka dalë të dalë të jetë kryefjalë edhe në Parlament. Jo për Rrugën, as për Skavicën. Por për një mësuese të 9-vjeçares që është hequr nga puna, pasi ka takuar Blushin në Peshkopi. Kur mësuesja fliste tribunave me Ramën, ishte një rilindase, mësuese e mirë, tani që takoi Blushin, është shqupi-ste dhe armike... Dhe për këtë duhet degdisur, braktisur dhe hedhur në rrugë... Ndoshta ka fat herës tjetër dhe takon Ramën. Pastaj ta bëjmë edhe drejtoreshë.

Këtë muaj na u bënë qershitë, por nuk patëm mundësi të flasim e shkruajmë për to. Nuk tingëllonte mirë pyetja: A u poqën? A i vole? A do na sjellësh ndonjë kokërr?

Ka plasur në rrjete sociale çështja e rrugës. Profile anekënd botës – herë me emra të rremë e herë me llagape origjinal, na kërkojnë të nisim protestat... Dhe ne kemi vendosur që ta zhvillojmë një protestë çdo të diel në orën 12.00 të drekës në FB. Kudo që ndodhemi, në plazh apo në shtëpi...

Qeveria ka dhënë shembuj se e do shumë Dibrën: përpara se t'i bëjë rrugën, ka vendosur ta ndriçojë, duke ndërtuar hidrocentrale. Kështu që i ka hapur rrugën ndërtimit të HEC Katundi i Ri! Dhe për këtë po presim njoftimin e radhës se ku do ta ndërtojmë sërish të Riun, Katund të Ri!

Një punonjës poste kishte vjedhur lekët e pensionit dhe është arratisur për në Amerikë. Këtu është shpallur në kërkim dhe është bërë zhurmë e madhe në shtyp. Po të kishte vjedhur më shumë, do ta bënim kryetar bashkie, deputet ose ministër...

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (121). 1 - 31 Maj 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI

Kontribuan për këtë numër:
Eduard ILNICA
Astrit GJUNKSHI
Agim VINCA
Genci LUARASI
Defrim METHASANI
Dionis XHAFA
Metush SKEJA
Mentor HOXHA
Shuaip MARKU
Mevlud BUCI
Ruzhdi LATA
Thanas FEKA
Hamdi SKEJA
Xhelil CIBAKU
Zabit LLESHI
Mehdi DEMA
Renato TOTRAKU

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL902021121900000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

ATA E PREMTUAN RRUGËN DHE NUK E MBAJTËN FJALËN. NDËRSA NE PUNUAM SE BASHKU PËR RRUGËN TONE DHE E NDËRTUAM PËRMES LIRISË SË FJALËS!

Abdi Baleta, Abdi Shehu, **Abdurahim Ashiku**, Abdyl Koleci, Adela Halo, **Adem Bunguri**, Adi Darsi, Adrian Blackledge, Afrim Karoshi, Agim Baçi, Agim Boba, Agim Çadri, **Agim Deva**, Agim Gjini, Agim Kaba, Agim Kasa, Agim Shenjatari, Agim Vinca, Agron Sela, **Agron Tufa**, Agron Xhagolli, Agustin Gjinaj, Ahmet Çaushi, Ahmet Kamberi, Ahmet Përleka, Albert Vataj, Albert Zholi, Aleko Minga, Aleksandër Lipa, Ali Hoxha, Ali Koçeku, Ali R. Berisha, Alma Mile, Anxhi Balla, Andon Andoni, Aneta Cani, Aqif Ademi, Aqif Karaj, Aqif Ymeri, Arbana Xhomemeti, Arben Muça, Arber Leshi, Ardian Reci, Ardit Gjebrea, Arieta Abdiu, Arta Sulovari, Arben Ayrazi, Arian Kadiu, Ariola Lami, Arjana Tafilja, Arjeta Tafçiu, Armond Duraku, Arqile Teta, Arsim Kolari, Artan Gjyzel Hasani, Artan Hoxha, Artan Lame, Arthur Nelsen, Artin Spahiu, Astrit Balliu, Astrit Gjunkshi, Astrit Hoxha, Atli Dema, Avni Alcani, Axel Kronholm, Baftjar Gazidede, Bajram Hyseni, Bajram Xhafa, Bardhyl Agasi, Bardhyl Berberi, Bardhyl Marku, Bardhyl Xhama, Bashkim Frangu, Bashkim Lami, **Bashkim Lleshi**, Bashkim Rama, Bedri Taniri, Begzad Baliu, Behar Gjoka, Ben Andoni, Bena Këruku, Beqir Ajet Shehu, Beqir Sina, Bernard Zotaj, Besnik Alku, Besnik Rama, Blerim Lazimi, Bleta Qormemeti, Bujar Kapexhiu, **Bujar Karoshi**, Bujar Leskaj, Bujar Plloshtani, Bujar Vitija, Dali Horeshka, Dali Noka, Dali Tërshalla, Dalip Greca, Danjel Bica, Dashmir Zaçe, Dashnor Kaloçi, Daut Shehi, Dedë Llesh Doçi, **Defrim Methasani**, Dejang Nova, Denis Lushi, Destan Rama, Dhimitër Shtëmbari, Dhori Qiriazi, Dionis Xhafa, Dita Torte, Dragush Totozani, Dritan Bocku, Dritan Murrja, Drite Ademi, Driton Zenku, Dukagjin Hata, Dylbin Reçi, Edibe Selimi - Osmani, Edison Balla, Edison Ypi, Edlira Haxhiymeri, Edmond Hasani, Edmond Zhulali, Eduard Abazi, Eduard Ilnica, Elliot Hasan Moglica, Elmaz Lala, Elona Mazari, Elvana Zaimi, Emrie Skuka, Engjëll Celibashi, Engjëll Musai, Enver Halili, Enver Hysa, Enver Kaloshi, Eqrem Basha, Eralda Skarra, Erisa Saraçi, Ermir Dizdari, Ermir Hoxha, Ermira Isufaj, Ermira Shehu, Esat Ruka, Eshref Ymeri, Esmeralda Bica, Esmeralda Ilnica, Eva Gjura, Eva Zaimi, Evi Melani, Faik Bruçi, Faik Prençi, Faik Xhani, Faruk Kaba, Fatbardh Cena, Fatjon Pandovski, Fatmir Delishi, Fatmir Minguli, Fatmir Terziu, Fatmir Zhuzhi, Fatos Baxhaku, Fehmi Lleshi, Fejzulla Gjabri, Femi Sufaj, Ferit Fixha, Fitim Dika, Flamur Hadri, Flora Nikolla, Florika Bushi, Gafur Muka, Gafur Zota, Gafur Zoto, **Gazmend Kërkuti**, Genc Melonashi, Genci Luarasi, Genta Nishica, Geri Selenica, Gëzim Alpion, Gjergj Marku, Gjergji Mima, Gjokë Beci, Gjon Fierza, Gjon Ndreja, Grehans Uka, Hajredin Toca, Hairi Mandri, Hairi Shehu, Hairush Mani, Haki Duka, Haki Kola, Haki Përnezha, Halil Rama, Halil Robi, **Halil Teodori**, Hamdi Hysuka, Hamdi Skeja, Hamit Taka, Hamit Vata, Hane Burnett, Hasan Leka, Hasan Lleshi, Hasan Pasha, Hekuran Vladi, Hilë Lushaku, Hyqmet Gonxhja, **Hysen Likdisha**, Hysen Mirku, Hysen Repa, **Hysen Uka**, Hysni Bruçi, Hysni Stafasani, Ibrahim Egriu, Ibrahim Kolari, Ibrahim Milushi, Ida Nurçe, Idriz Xhomara, Ilir Krosi, Ilir Sinanaj, Ilir Spata, Ilirjana Sulkuqi, Iljaz Bobaj, Iljaz Kaca, Ilmi Dervishi, Ina & Erta Disha, Ina Xhaferi, Inva Halili – Kuhn, Isa Halilaj, Islam Cani, Islam Çenga, Islam Sharofi, Ismail Hysa, Isuf Miho, Isuf Salla, Iva Cipuri, Ivzi Cipuri, Jahe Delia (Selmani), Jani Thomai, Jera Isakaj, Jorgji Muzaka, Jorgo Bulo, Kadri Dauti, Kamber Faruku, Kastriot Caka, Keze (Kozeta) Zylo, Klara Kodra, Krenare Ollogu, Kristo Zharkalliu, Kristofor Beduli, Kujtim Boriçi, Kujtim Osmani, Laura Papraniku, Laurant Bica, Lavderim Shehu, Liman Hoxha, Lindita Çela, Lisien Bashkurti, Llazar Semini, Luan Deda, Lulzim Çota, Lutfi Hanku, Lutfi Turkeshi, Mahir Jangulli, Mahmud Hysa, Majlinda Hoxha, Malvina Shehi, Marin Mema, Marius Dobrescu, Mark Tirta, Martin Cukalla, Mehdi Dema, Mehmet Dume, Melsi Tafa, Mendu Dema, Mentas Nasufi, Mentor Hoxha, Merat Ismaili, Mersin Hoxha, Metodija Velevski, Metush Skeja, Mevlud Buci, Mexhit Prençi, Mhill Velaj, Miftar Fana, Mimoza Erebara, Mimoza Shqefni, Mina Hysa, Mira Ymeraj, Miran Tafa, **Miranda Goleci**, Mirela Sula, Mirvet Lala, Moisi Murra, Molnar Kolaneci, Monika Stafa, Muhamet Bitri, Murat Gecaj, Murat Koltraka, Musa Kraja, **Musa Riçku**, Mustafa Tola, Muzafer Korkuti, Myhyr Hoxha, Myslim Islami, Nadire Skënderi (Murra), Naim Berisha, **Naim Plaku**, Naim Zoto, Namik Selmani, Naxhi Hasa, Ndue Dedaj, Nefail Spahiu, Neki Feta, Neki Kaloshi, Nerilda Meda, Nexhi Baushi, Nexhmie Mehmeti, Nikoll Kola, Nikolla Madzirov, Nin Gj. Rajta, **Nuri Abdiu**, Nuri Koleci, Odise Plaku, **Osman Xhili**, Pajtim Përnezha, Pandeli Koçi, Perikli Jorgoni, Përparim Luca, Përparim Spahiu, Përparim Tomçini, Petr Hlobil, Petrit Dunga, Petrit Fetahu, Petro Luarasi, Pjetër Jaku, Qamil Sula, Qazim D. Shehu, Qazim Hata, Qazim Prejsi, Qemal Skendo, Qenan Hasani, Qeram Cibaku, **Rakip Suli**, Ramadan Ajazi, Ramadan Ndreka, Ramazan Biba, Ramazan Buci, Ramazan S. Ilnica, **Ramiz Gjini**, Ramiz Lushaj, Ramiz Zekaj, Rasim Buci, Renato Totraku, Resul Bendo, Rexhep Doda, Rexhep Ndreu, **Rexhep Torte**, Rezeana Hysa, Rifat Malaj, Robert Reçi, Roland Çene, Roland Zisi, Rovena Vata, Rozi Theohari, Rremzi Ndreu, Rruzhdi Bitri, Rustem Deva, Ruzhdi Lata, Sabri Gjeci, Sadik Lala, Saimir Shatku, Sakip Cami, Sali Ajazi, Sali Bushi, Samet Zagradi, Sami Milloshi, **Sashenka Ndreka**, Sazan Goliku, Sazan Guri, Sefedin Shabani, Sefulla Kata, Sejdi M. Hashi, **Selman Mëziu**, Shaban Bitri, **Shaban Sinani**, Shaqir Skarra, Shefki Aliti, Shefqet Hoxha, Shehat Cami, Shehat Marku, Shemsi Daci, Shemsi Manjani, Shemsi Prençi, Sherif Delvina, Shinasi Rama, Shkëlqim Lusha, Shkëlqim Shemsi Hatipi, Shpend Topollaj, Shpetim Cami, Shpëtim Hyka, Shpëtim Pollozhani, Shuaip Marku, Shukri Hajdari, Skënder Minxhozi, Sokol Çobo, Sokol Demaku, Spiro Xhavarra, Srecko Sekeljic, Stephen Schwartz, Suat Saqipi, Suela Lala, Sulejman Borova, Sulejman Tomçini, Syrja Stafa, Tefik Jegeni, Tefik Skera, Tefta Cami, Tefta Nuredini, Thanas Feka, Theodhori Karaj, Ulkie Sinani, Ullmar Qvick, Valbona Zunçe, Valeria Dedej, Valmir Gashi, Valter Shtylla, Vehbi Bajrami, Vehbi Hoti, Veip Proda, Veli Vraniçi, **Vesel Hoxha**, Vezir Muharremaj, Virion Graçi, Viron Kona, Vita Koja, Vojsava Leka, **Xhafer Martini**, Xhafer Seiti, Xhavit Deda, Xheladin Çelmeta, Xhelal Luca, Xhelal Marku, Xhelal Roci, Xhelal Zejneli, Xhelil Cibaku, Xhemail Ali Peci, Xhemal Domi, Xhemal Mato, Xhezair Abazi, Ylber Nuredini, Ylli Molla, Ylli Prapa, Ymer Keta, Ymer Stojku, Zabit Lleshi, **Zaim Elezi**, Zaim Korsi, Zamira Gjeleshi, Zef Çoba, Zejnel Sula



Rritja e prodhimit vendas, zgjerimi i llojeve të produkteve dhe shërbimeve, si dhe rritja e investimeve nga kryeqyteti e rajone të tjera të vendit apo e investimeve të huaja, të cilat i lehtëson rruga e re, sjell rritjen e kërkesës për vende të reja pune

Rritja e prodhimit dhe tregëtisë, ulja e kostos, aksesi më i shpejtë me rajone të tjera të vendit, rritja e punësimit dhe e të ardhurave përmirëson sigurinë ushqimore të popullsisë. Kjo do të thotë lehtësim i sigurimit të ushqimeve bazë për të gjithë, në mënyrë që të mos ketë familje që vuajë nga uria.

Siguria dhe zhvillimi social-ekonomik që sjell Rruga e Arbrit

Nga Dr. **ASTRIT GJUNKSHI***

Rruga e re rrit sigurinë e jetës personale. Ajo ndikon në rritjen e sigurisë shëndetësore dhe ekonomike.Siguria ekonomike lidhet me sigurinë e të ardhurave të mjaftueshme të çdo familje, garantimin e pandërprerë të të ardhurave, punësimin dhe shmangien e krijimit të papunësisë, qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e standardit të jetesës, aksesin në rrjetet e siguracionit të jetës e pronës.

Konceptimi më i përhapur mbi përfitimet nga ndërtimi i Rrugës së Arbrit është se ajo shkurton thuajse trefish kohën e udhëtimit nga Tirana në Dibër dhe sjell mjaft përfitime ekonomike.Sidoqoftë, do të ishte me vlerë të jepet një panoramë më e plotëepërfitimeve që sjell ky investim në rrafshin social-ekonomik, por edhe në fushën e sigurisë. Një konceptim më iplotë do t'i shërbente ndërgjegjësimit të strukturave qeverisëse se çfarë po humbet zona verilindore dhe Shqipëria nga vonesa e ndërtimit të kasaj rruge, por edhe ndërgjegjësimit të publikut për të rritur presionin e tyre pozitiv që ky investim madhor të mos zvarritet.

Në qendër të kësajanalizekam vendosur përfitimetqë ndërtimi i rrugës sjell në sferën e sigurisë, e cila përmban edhe dimensionet e zhvillimit social dhe ekonomik. Një vështrim i tillëështë më se logjik sepse siguria e jetës së njeriut, siguria e komunitetit dhe e gjithë shoqërisë, kanë përparësi absolute.Le tështjellojmë pra ndikimin që sjell ndërtimi i Rrugës së Arbërit në rritjen e sigurisë, nëtë gjithë elementët përbërës të saj.

Së pari, rruga e re rrit sigurinëe jetës personale. Kuptohet se ndërtimi i një rruge shumëmë të shkurtër dhe me parametra sigurie mjaft më të lartë se rruga aktuale ul probabilitetin për aksidentet rrugore, ul stresin e udhëtimit dhe lodhjen fizike.

Së dyti, Rruga e Arbrit ndikon në rritjen e sigurisë shëndetësore. Pakësimi drastik i kohës, por dhe i kostos sëudhëtimit bën që qytetarët e Dibrës, e më gjërë,të mund të kenë akses të shërbimit shëndetësor në spitalet e kryeqytetit, si për urgjenca ashtu dhe për trajtime të specializuara. Ministria e Shëndetësisë do të ketë më të lehtë pajisjen më të mirë të spitaleve rajonale me aparatura të reja apo që mund të transferohen nga spitalet e kryeqytetit. Përveç kësaj, shkurtimi i rrugës ndihmon rritjen e kontakteve kualifikuese të personelit mjekësor të periferisë me ato të kryeqytetit, si dhe me specialistë të huaj. Më tepër do të bëhet në këtë rast edhe për rritjen e masave parandaluese të sëmundjeve përmes vlerësimit më të shpeshtëtë gjendjes shëndetësore. Kështu, një shërbim shëndetësor më cilësor do të përmirësojë shëndetin e qytetarëve dhe do të rrisë jetëgjatësinë.

Së treti, ndërtimi i Rrugës së Arbrit do të rrisë shumë sigurinëekonomike.Siguria ekonomike lidhet me sigurinë e të ardhurave të mjaftueshme të çdo familje, garantimin e pandërprerë të të ardhurave, punësimin dhe shmangien e krijimit të papunësisë, qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e standardit të jetesës, aksesin në rrjetet e siguracionit të jetës e pronës.

Përvoja botërore argumenton me fakte të pakundërshtueshme se zhvillimi modern i komunikimit rrugor ndikon nërritjen e shfrytëzimit më të plotë e racional tëburimeve të pasurisë dhenë rritjen e punësimit për shkak mbështetjes qëkomunikimi u jep aktiviteteve të tjera ekonomike. Për rrjedhojë, ndërtimi i Rrugës së Arbërit krijon mundësi për mirëfunksionimin dhe rritjen e ekonomisë. Njëtransport më i shpejtë dhe fleksibël lejon sektorët e tjerë ekonomik të pësojnë ndryshime strukturore. Duke sjellë kursim kohe dhe kostoje, rruga nxit industrinëqë, edhe në periferi, të adaptohet ndajzhvillimeve teknologjike, të zhvillojëprocese të reja prodhuese, dhe të rrisë pritshmërinë e konsumatorëve.

Rruga e re do të mundësojëriorganizimin dhe racionalizimin e prodhimit dhe shpërndarjes. Ajo do tëulë koston e grumbullimit,nga vendndohje të ndryshme, të mallrave që nevojiten për prodhim, Kjo ul koston e prodhimit, gjë që rrit prodhimin dhe fitimin, dhe stimulon bizneset. Ulja e çmimit të prodhimit nxit shkëmbimin e prodhimit midis Dibrës dhe kryeqytetit, si dhe me rajone të tjera brenda e jashtë vendit. Krijohen kështu kushte të favorshme për tëbërëkommercializimin e bujqësisë, specializimin e industrisë, dhe diversifikimin ekonomik. Rruga mundëson hyrjen e ndërmarrjeve të reja në tregjet e qarkut të Dibrës e më gjërëdhe ndihmon konkurueshmërinë.

Së katërti, ndërtimii rrugës së Arbërit rrit punësimin, qëështë pjesë thelbësore e sigurisë ekonomike të njerëzve. Rritja e prodhimit vendas, zgjerimi i llojeve të produkteve dhe shërbimeve, si dhe rritja e investimeve nga kryeqyteti e rajone të tjera të vendit apo e investimeve të huaja, të cilat i lehtëson rruga e re, sjell rritjen e kërkesës për vende të reja pune, pra rrit punësimin. Mjaft aktivitete të reja prodhuese që do të zhvillohen shtrojnë nevojën për specializimin e të rinjve në profesione të reja. Ky specializim mund të kryhet në kryeqytet apo qytete të tjera të mëdha, por, gradualisht, mund të ngrihen edhe në Dibër degë të reja arsimimi dhe specializimi, madje për të shërbyer në shkallë rajonale, duke përfshirë edhe popullsinë e Dibrës së Madhe dhe të popullsisë shqiptare të Maqedonisë. Kjo do të sillte fuqizimin e sektorit të arsimit, por edhe nivelin e përgjithshëm arsimor e kulturor të zonës.

Së pesti, zhvillimet e lartpërmendura të sigurisë ekonomike do të ndikojnë në rritjen e sigurisë ushqimore. Rritja e prodhimit dhe tregëtisë, ulja e kostos, aksesi më i shpejtë me rajone të tjera të vendit, rritja e punësimit dhe e të ardhurave përmirëson sigurinë ushqimore të popullsisë. Kjo do të thotë lehtësim i sigurimit të ushqimeve bazëpër të gjithë, në mënyrë që të mos ketë familje që vuajë nga uria. Do të krijohej mundësia për rritjen e cilësisë së të ushqyerit. Do të bëhej më i mundur synimi për uljen gjithnjë e më tepër të pjesës së buxhetit familjar që shpenzohet për ushqimet si rezultat i rritjes së të ardhurave familjare dhe e çmimeve të kontrolluara. Siguria ushqimore duhet të synojë deri sigurimin e ushqimit për të gjithë komunitetin edhe në rast të katastrofave që shkaktohen nga natyra apo njerëzit.

Sëgjashti, Rruga e Arbërit, duke rritur prodhimin dhe punësimin, si dhe aksesin e popullsisë së rajonit të Dibrës dhe rajoneve fqinje të saj në territorin e vendit, ndihmon drejtpërdrejt në uljen e varfërisë. Kjo u jep qytetarëve akses drejt të njëjtave shanse, duke ndikuar në rritjen e kohezionit dhe integrimit social të këtyre rajoneve të thella të vendit. Do të kufizohet mjaft apo ndalohet boshatisja e periferisë. Madje, për shkak të shkurtimit të distancës dhe zhvillimeve të tjerë që trajtuam, që përfshin edhe rritjen e punësimit, mund të vërehen edhe rikthim në zonat e origjinës të mjaft familjeve që nuk kanë realizuar vehten në kryeqytet.

Në këtë mënyrë, siç konstatohet qartë, Rruga e Arbërit do të qëndronte në zemër të zhvillimit social dhe ekonomik të Dibrës dhe të rajoneve fqinje, duke përfshirë dhe atë të bashkëatdhetarëve tanë në trojet e tyre në Maqedoni. Ndërtimi i rrugës shkurton distancat; nxit prodhimin, lehtëson bizneset dhe tregëtinë; përmirëson lëvizjen e njerëzve dhe mallrave; kontribuon në heqjen e barrierave dhe shpie në një përmirësim të përgjithshëm të standardit të jetesës.

Rruga e Arbërit, duke rritur prodhimin dhe punësimin, si dhe aksesin e popullsisë së rajonit të Dibrës dhe rajoneve fqinje të saj në territorin e vendit, ndihmon drejtpërdrejt në uljen e varfërisë. Kjo u jep qytetarëve akses drejt të njëjtave shanse, duke ndikuar në rritjen e kohezionit dhe integrimit social të këtyre rajoneve të thella të vendit.

Të gjithë këto janë argumente më se të mjaftueshme se Rruga e Arbërit është një investim i domosdoshëm për zhvillimin e gjithanshëm të gjithë krahinës së Dibrës dhe përtej saj. Kuptohet se, pas ndërtimit të saj jo gjithçka që trajtuam më lart do të mund të zbatohet menjëherë, por hap pas hapi, sipas një plani të detajuar sipas prioriteteve. Kryesorja është që të ndërtohet sa më shpejt rruga.

Çdo forcë politike dhe qeverisëse e përgjegjëshme ndaj rritjes së nivelit të jetesës të popullit duhet të bënte të pamundurën për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Vonesa e ndërtimit të rrugës për afro dy dekada ka ndikuar për keq në mirëqenien e popullsisë së Dibrës dhe rajoneve fqinje. Kjo përbën, në fakt, një padrejtësi. Eleminimi i padrejtësisë ndaj njerëzve mbetet faktori kyç për të përmirësuar jetesën dhe për të rritur sigurinë. Siguria dhe zhvillimi social- ekonomik mund të rritet vetëm nëse parimi i drejtësisë udhëheq politikat e sigurisë të shtetit. Dhe, vendosja në vend e kësaj drejtësie legjitime ndaj popullit ka vetëm një zgjidhje: ndërtimi sa më shpejt i Rrugës së Arbërit, pa justifikime të tjera që e shtyjnë atë pa fund.

** Autori është Doktor i Shkencave për Sigurinë Globale. Ka kryer studimet në Kolegjin Mbretëror të Shkencave të Mbrojtjes në Universitetin e Cranfield-it në Britaninë e Madhe, ku fitoi gradën Master i Shkencave për Siguri Globale. Ka kryer gjithashtu studime e kualifikime në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë, në SHBA, Gjermani, Belgjikë, Zvicër, Austri etj. Ka qenë Ministër Këshilltar në Delegacionin e Përhershëm të Shqipërisë në NATO, në Bruksel. Ai është autor i disa librave që lidhen me çështjen e integrimit në NATO, me interesat tona kombëtare, me Diplomacinë e Mbrojtjes, me menaxhimin e konflikteve dhe me integrimin Euro-Atlantik të Kosovës.*

Një peticion shkruar para 20 vjetësh
dhe Rruga e Arbrit stela-stela sot...

Rruga e Arbrit *si rrugë* **e lindvdekur**

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Është shkruar para 20 vjetësh.Është një peticion, një kërkesë njerëzore firmosur nga 43 intelektualë dibranë e përcjellë strukturave të shtetit shqiptar të kohës që nga presidenti Berisha e me radhë teposhtës së kaskadës shtetërore deri tek prefekti i qarkut të Dibrës.

E gjeta midis relikteve të jetës time që çuditërisht nuk më ka rënë poshtë rrugës së gjatë të ikjes dhe qëndrimit tash njëzet vjet në troje të huaja.

Gjeta edhe një dorëshkrim timin të marsit 1996 me titull "RRUGA E DIBRËS" – DREJT DIBRËS me shënimin: "Alternativa për zhvillimin e zonave malore".

Nuk mund t'i mbajë në arkivin tim, thjesht se ata i përkasin një hapësire që lidhet me një trevë e me zëra që nuk kanë pushuar së ngrituri deri në shkallën më të lartë të pentagramit zërin NDËRTONI RRUGËN E ARBRIT!

Nuk është thjesht një peticion që fillon me "Jemi një grup intelektualësh të rrethit të Dibrës..." është një pamflet historik, një thirrje brezash në shekuj që ecën në këmbë kësaj rruge duke shkruar biografinë e saj.

Citohet Aleks Buda në thënien e tij "Dibra ishte ndër pikat kyçe ku vihej në pikëpyetje ekzistenca e Shqipërisë në dy pjesë".

Citohet Ana Komnena e cila kur flet për fisin ilir të Albanëve-Arbërve, përmend edhe krahinën Albanon që shtrihej gjatë rrugës midis Durrësit e Dibrës, krahina e Arbërisë, me qafa, rrugë të përpjeta dhe kulla të shumta.

Dijetari italian Antonio Baldaçi për këtë rrugë shkruante: "Qytetërimi Romak kishte zhvilluar një rrjet rrugor në Shqipëri, arteriet kryesore transversale të së cilës ishin Via Egnatia... pastaj ajo midis Durrësit e Dibrës duke kaluar nëpër Mat"

Vaid Kormaku, mësues dhe studiues i pasionuar i Dibrës, citohet si "i pari që përmendi faktin se rruga lidhte Stambollin me Detin Adriatik krahas "Via Egnatia" sipas itinerarit: Gallatë – Stamboll-Adrianopol-Filipopol, për të hyrë në trekëndëshin Sofie – Nish-Shkup, gjatë luginave Morava-Vardar, Lugut të Vardarit-Fushës së Pollogut – Gostivar – Mavrovë-Grykë të Radikës bri katundeve Trebisht – Radostush-Dibër e Madhe-Grykë të Vogël – Grykëtë Madhe – Valikardhë-Qafë Buall-Guri Bardhë (Petralba)-Shkallë e Tujanit – Krujë-Durrës.


1.Ilaz Kaca
2.Adem Bunguri
3.Hamit Xhaferi
4.Sami Selishta
5.Hysen Uka
6.Ramadan Bunçi
7.Moisi Murra
8. Hajri Shehu
9.Gafurr Zota
10.Moisi Kamberi
11.Fitim Mata
12.Ali Hoxha
13.Hasan Çipuri
14.Nin Rajta
15.Inajet Shehu
16.Rakip Sinani
17.Qemal Kurtaga
18.Rremzi Zajmi
19.Halil Dibra
20.Dilaver Drizi
21. Luan Kaba
22. Hamedan Ashiku
23. Ivzi Torba
24. Rremzi Çera
25.Nexhmi Bajraktari
26.Selami Shehu
27.Astrit Kuka
28.Jamil Daci
29.Abaz Duka
30.Nexhat Hysa
31.Vesel Hoxha
32.Met Shehu
33.Rafet Gjoka
34. Fari
35. Veli
36. Hazis
37 Lulzi
38 Isak
39. Mentas Daci
40 Geram Daci
41. Nehat Daci
42. Nebi Xhemollja

Rruga e Arbrit është aktualisht stela – stela, arna – arna, pa kokë, pa trup, pa këmbë, pa zë e pa figurë. Për ndërtimin e saj nuk mjafton nënshkrimi i 42 intelektualëve, nënshkrimi i mijëra të tjerëve. Pushtetarët nuk kanë veshë për të dëgjuar e as sy për të lexuar...

Faksimile e firmave të peticionit të parë, 1996

Intelektualët argumentojnë se "Që në mesjetën e hershme...Krahina e Arbrit ka qenë vendi i kryqëzimeve transversale e horizontale të trojeve etnike të kombit shqiptar – epiqendër e trojeve etnike. Këto rrugë janë kthyer në arterie të rëndësishme që kryejnë lidhjet e kombit në kohët moderne".

Dukefolur me gjuhën e argumentit historik etnik, intelektualët dibranë deklarojnë se "Vetëm një rrugë dhe pikërisht ajomë strategjikja nuk është kthyer në rrugë moderne automobilistike. Është fjala për Rrugën e Arbrit, të quajtur më vonë Rruga e Katriotëve, Rruga Durrës-Fusha e Tiranës- Tujan - Qafë Murrizë - Guri i Bardhë- Ura e Vashës - Plani i Bardhë - Qafa e Buallit - Vajkal - Ura e Qytetit (Valikardhë) - Homesh - Dibër."

Protesta e tyre se... "Nuk ka krahinë që të lidhet me kryeqytetin dhe portin e Durrësit në mënyrën më diskrete dhe qesharake se krahina e Dibrës"... pason deklaratën – argument:"Mos të harrojmë se në qoftë se flasim për zona të populluara dhe bujqësore të Shqipërisë së sotme politike, këto janë pellgu i Korçës dhe Lugina e Drinit të Zi".

Ata argumentojnë se "Kalimi i Qafës së Murrizit (1120 m.), sikur edhe pa asnjë tunel e shkurton rrugën 75 kilometër..."

Intelektualët nuk e mbajnë për vete idenë e ndërtimit të rrugës tradicionale nëpër Shkallën e Tujanit. Ata deklarojnë se ajo është shtruar për zgjidhje që në vitin 1929 kur parashikohej ndërtimi i dy tuneleve njeri në hyrje të Shkallës së Tujanit dhe tjetri në të dalë të Shkallës...

Intelektualët argumentojnë se pushteti diktatorial kurrë nuk i dha Dibrës atë që i merrte...kromin, mermerin,pasuritë e mëdha të nëntokës e mbitokës, për të arritur deri në deklaratën e vitit 1972 të kryeministrit Mehmet Shehu i cili tha se "...përmirësimine kësaj rruge mund ta shfrytëzonte armiku për agresion mbi Tiranë" (?!), një argument qesharak që e la Dibrën me një rrugë me 4 metra gjerësi.

Grupi i intelektualëve Dibranë i kërkonte presidentit Berisha, qeverisë, institucioneve si dhe organizmave shtetërore e shoqërore që varen prej tyre..."T'i kthejë Dibrës rrugën e vet tradicionale që edhe dibranët të lidhen me kryeqytetin e vet më të shkurtër..."

Zëri i intelektualëve dibranë mbeti në "koshin e plehrave" të presidentit të atëhershëm të shtetit shqiptar, kryeministër për tetë vjet më vonë, në "koshin e plehrave" të kryeministrave që pasuan...Fatos Nanos, Ilir Metës, Pandeli Majkos, Edi Ramës...

Jo vetëm ai peticion, por edhe më i riu, ai i iniciuar nga Gëzim Alpione të tjerë, firmosur online dhe me kalem në dorë nga mijëra dibranë e bashkëkombës në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e në të gjithë botën.

Me dhjetëra kanë qenë deputetët dibranë të të gjitha ngjyrave partiake ulur në karriget e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Asnjeri nuk u ngjit në tribunën e Kuvendit me peticionin e shkruar dhe me zërin e dibranëve të incizuar në dorë për të kërkuar me forcë ndërtimin e Rrugës së Arbrit. ASNJERI?!

Rruga e Arbrit është aktualisht stela – stela, arna – arna, pa kokë, pa trup, pa këmbë, pa zë e pa figurë.

Për ndërtimin e saj nuk mjafton nënshkrimi i 42 intelektualëve, nënshkrimi i mijëra të tjerëve. Pushtetarët nuk kanë veshë për të dëgjuar e as sy për të lexuar...

Megjithatë firma mbetet, nuk e fshinë asnjë "gomë" e pushtetit. Është dokument historik, dëshirë, vullnet, kërkesë, protestë...

Bashkangjitur po përcjell edhe nënshkrimet e intelektualëve dibranë...

Abdurahim Ashiku

Shënim: Në titull përdora bashkë fjalët LINDVDEKUR. Është nënshkrimi lakonik që bëjnë mjekët në kartelën e fëmijës që ka lindur i vdekur.

Intelektualët argumentojnë se pushteti diktatorial kurrë nuk i dha Dibrës atë që i merrte...kromin, mermerin, pasuritë e mëdha të nëntokës e mbitokës, për të arritur deri në deklaratën e vitit 1972 të kryeministrit Mehmet Shehu i cili tha se "...përmirësimin e kësaj rruge mund ta shfrytëzonte armiku për agresion mbi Tiranë" (?!), një argument qesharak që e la Dibrën me një rrugë me 4 metra gjerësi.

Problemet e pazgjidhura të Dibrës dhe zëri i munguar i shoqatave dibrane

Ka sot dy probleme të mëdha që duhet ti preokupojë të gjithë dibranët: ata që banojnë në Dibër, ata që janë vendosur përgjithnjë në Tiranë e në qytetet e tjera "të buta" të Shqipërisë, ata që kanë ikur përkohësisht apo përgjithmonë larg vendit.

Rruga e Arbrit është e para, e kërkuar zyrtarisht para 20 vjetësh nëpërmjet një peticioni të intelektualëve të Dibrës, e vënë si kryefjalë në faqet e shtypit dhe të televizioneve zyrtarisht që në fushatën zgjedhore të qershorit 2005, e zotuar në tre zgjedhje të tjera radhazi të së djathtës 8 vjet në pushtet dhe të së majtës tash tre vjet.

Rruga e Arbrit zyrtarisht është e tradhtuar.

Mbytja e Dibrës nëpërmjet gjolit të Skavicës është e dyta, mbytje që e shndërron Dibrën në një koloni financiare, që e rrënon dhe pëson atë që në Dibër ka shprehjen e nëmës "Të humb emri!"

Janë këto dy probleme jetike për Dibrën që dy shoqatat që bëjnë emër e zë publik, kësaj dhe asaj ane të kufirit shqiptaro-shqiptar, "Lidhja e intelektualëve dibranë" dhe shoqata "Bashkësia dibrane"duhet të flasin, duhet të bërtasin, duhet të dalin në rrugë e me parullën "PO DIBRËS!" JO SKAVICËS!" dhe "Ndërtoni Rrugën e Arbrit" të tregojnë se e duan Dibrën, e mbrojnë dhe do ta mbrojnë atë.

U bënë kaq vite që zëri i këtyre dy shoqatave e bashkë me ta zëri i atyre që Dibra i ka shpallur "Qytetarë nderi" nuk dëgjohet, që pena e tyre nuk shkruan. Në adresat e tyre nuk gjen asnjë peticion, protestë, solidaritet për mbrojtjen e Dibrës, për zhvillimin e saj. Dibrës iu mbyll dega universitare e universitetit të Durrësit në një kohë që ajo duhet të kishte jo "degë" por "trung me rrënjë" universitar. Askush nuk foli, as zyrtarisht as veç e veç, individualisht në detyrimin intelektual.

Sikur komuniteti dibran që, si thuhet, ka mbi shtatëdhjetë mijë burra, gra, bijë, bija, nipër e stërnipër të ikur nga serbi i viteve 1913-1920 dhe 1943-1944, të dilte një ditë e të mbushte Rrugën e Dibrës do të tronditesh Tirana dhe zëri do të kapërcente kufijtë. Në Tiranë nuk ka komunitet më të pranishëm në një lagje më vete sa "Mëhalla e Dibranëve"

Ishte gjë e bukur kur dibranët e dy krahëve të kufirit shqiptaro-shqiptar u ngritën për të mbrojtur Radikën. Dhe jo vetëm dibranët.

Po pse nuk veprohet kështu sot? Po pse nuk dëgjojnë, nuk shikojnë për atë që po ndodh? Për deklaratat e përditshme të "gjiknurëve" për fillimin e mbytjes së Dibrës? Për heshtjen që mbretëron për ndërtimin e Rrugës së Arbrit?

Është koha që shoqatat dibrane, njerëzit që kanë varur në mur titullin "Qytetar nderi i Dibrës", të heqin "dyllin nga veshët", të heqin "copën e zezë mbi sy", të flasin e thërresin në "kupë të Korabit" për Rrugën e Arbrit, anulimin e ndërtimit të Skavicës, zhvillimin e gjithanshëm të Dibrës

Dibranët e moçëm e mbrojtën Dibrën me pushkë e me gjak, nuk ia lanë serbit...

A.Ashiku

opinion

A ka Dibra forcë që tua tregojë kufirin partive politike tek "Ura e Topojanit" dhe të votojë për një njeri që ngrihet mbi partitë në interes të saj?

Duhen **njerëz në krye** të punëve, jo në bisht të partive

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Dibra po përjeton një ngjarje që është shumë larg nderit të saj, një sulm sarkastik e humor bajat. Artikuj pa kokë e këmbë, emisione televizive ku opinionistët zgërdhihen, vjershëtorë në pleqërinë me "tre këmbë" me vargje erotike në gojë...

Të gjithë në një vrapim të çmendur mundohen ta "gjejnë llafin e ta shtrojnë mutafin". "Lehje n'ujk"...

Kryetari në burg, e shoqja, babai dhe nëna e "viktimës" që shkoi me celular modern në "shtrungë për të mjelë", komshinj, njerëz në rrugët e Peshkopisë...të gjithë janë gjahu i preferuar i gazetarëve dhe gazetarucëve, i gazetave të shkruara dhe elektronike, i stacioneve të radios dhe televizioneve kombëtare, lokale e kabllore...

Shumë bujë për pak ujë...

Nuk u ve faj. Bëjnë punën. Shkruajnë e flasin pa honorare...

Dibra sulmohet dhe përqeshet gjer në aulën e lartë të Kuvendit me stilin e "pozicionit-gjel mbi pleh".

Të gjitha këto bëhen si prolog i zgjedhjeve të reja për kryetar bashkie, si start i një maratone kurtizanesh "elviare"...

Një intelektual dibran nga ata që kanë lënë Dibrën dhe shkruajnë nga Tirana, i drejtohet kryetarit të partisë së tij të dashur dhe i propozon një emër për kryetar të Bashkisë së Dibrës.

Do të desha që ai intelektual (dhe të tjerë me emër dhe prestigj në Dibër, shumë prej të cilëve janë shpallur "Qytetar Nderi") që e njeh Dibrën nga Llanga në Draj Reç e nga Krejë Lura në Gramë, të shpallte kandidaturën e vet për kryetar bashkie, kryetar jashtë të majtës apo të djathtës, jashtë gjysmë të majtës e gjysmë të djathtës - "vaj mbi sallatë" e "spec mbi pilaf"

Dibra ka vuajtur, është persekutuar, është përbuzur, është mashtruar, është truar si asnjë krahinë tjetër e vendit.

Dje dhe sot.

E "djeshmja" lidhen me diktatin dhe me diktaturën që e deshën Dibrën "për krah pune", për të bërë "hapin kilometër e orën minutë", për shfrytëzimin e trurit dhe forcës së saj në ndërtimin e veprave hidroenergjetike, urave dhe kanaleve ujitëse, për të mbushur arkat me valutëne kromit e maunat me mollë e kumbulla drejt botës...

E "sotmja", "demokracia" e do Dibrën pa gojë, pa mendje, pa hap të ecë përpara. E do "dorë lart" për votën, votë për njerëz që as i ka njohur e as e kanë njohur, njerëz pa veshë (me kufje partiake), pa sy (me syze partiake), pa gojë (me mikrofon partiak). Në mbrojtje të Dibrës, në nevojën e saj për ndërtimin e arteries kryesore të jetës së saj sot dhe për të gjithë brezat, Rrugën e Arbrit, në mbrojtjen e bukurisë dhe begatisë së saj, Luginës së Drinit të Zi nga mbytja etj., etj.... nuk është parë kurrë asnjë deputeti saj (i majtë apo i djathtë) të ngjitet në podiumin e Kuvendit dhe të thurë një fjali të vetme në interes të vendit ku ka lindur dhe është rritur.

E "sotmja", "demokracia" e do Dibrën pa gojë, pa mendje, pa hap të ecë përpara. E do "dorë lart" për votën, votë për njerëz që as i ka njohur e as e kanë njohur, njerëz pa veshë (me kufje partiake), pa sy (me syze partiake), pa gojë (me mikrofon partiak).

Na ishin njëherë dy vëllezër elviarë (të ndershëm, shenjtorë). Njeri jetonte në qytet e ishte këpucar, tjetri në mal bari delesh. Bariu vjen një ditë në dyqanin e vëllait dhe i sjell një torbë bezeje të bardhë me qumësht dhe e var në një gozhdë. Duke qenë i ndershëm qumështi nuk rridhte prej bezes.

Në këtë kohë hyn në dyqan një zonjë perri e bukur. Ulet në stol dhe zgjat këmbën që këpucari të marrë masën për këpucë të reja. Këpucari ia merr këmbën dhe e vendos mbi një letër të bardhë dhe nis të bëjë matjet.

Bariut, duke parë skenën, i luajti truni....

Qumështi rrodhi pikë-pikë e zbardhi horasanin e dyshemesë...

Këpucari i tha vëllait:

Eh more vëlla, është kollaj të jesh i shenjtë në mal, por kush e mban shenjtërinë këtu në qytet!

Më thoni një emër me mbiemër, vetëm një, përjashtuar njërin që disa javë më parë doli në një gazetë për të brohoritur "Oh sa mirë me qenë Dibran!".

Më thoni edhe një kryetar bashkie që në këto 11 vjet të "djathtësh" e të "majtësh", t'i ketë thënë në krye të masave "JO SKAVICËS" dhe "PO RRUGËS SË ARBRIT".

Ata përkulur në nëntëdhjetë gradë i kanë thënë me temena "PO PARTISË".

Dibra tash në gjendjen e "kalit që i kanë rënë me shkop kresë" e nuk din nga t'ia mbajë,ka nevojë të shohë pak dritë në tunel, ka nevojë për një drejtues pushteti lokal që ta njohë Dibrën në çdo skaj të saj, thellë dhe gjerë. Bashkia e Dibrës nuk është "bashkia e Peshkopisë" në 7-10 kilometra katrore, është një tërësi territoriale që fillon tek Ura e Topojanit për të vijuar tërë luginës së Drinit të Zi e për tu ngjitur malet e Dibrës, në perëndim e lindje, në Luzni, Katër Grykët e Murrës, Muhurr, Çidhën, Reç, Dardhë, Lurë, Kala të Dodës, Ujë e M'ujë, Korab, Gramë, Skërtec, Hynoskë, Kërçin... Dikur shtrihej në 1600 kilometra katrore e kishte një popullsi rreth dyqind mijë banorë. Tash është diku tek dy të tretat në sipërfaqe dhe ...

Dibra ka halle të vjetra akumuluar nga e kaluara, halle të reja mbjellë e kultivuar në "kubikë" partiakë, nga e sotmja.

Ta njohësh Dibrën dhe të punosh për t'i dhënë gjallëri e jetë do "këmbë të forta" për të ecur dhe "brinjë të forta" për tu mbush me frymë. Do "gjoks" për ta vënë përballë vështirësive që i vijnë nga brenda dhe nga jashtë, majtas e djathtas. Do kurajë për t'i thënë të bardhës e bardhë dhe të zezës e zezë. Do krah të fortë për ti rënë Drinit pash e më pash kundër rrjedhës kur fryhet e merr me vete shkurre, gurë e trungje.

Mbi të gjitha Dibra, në këtë çast të vështirë do njerëz që të kenë mbështetjen e dibranëve dhe jo të partianëve, të njerëzve që e duan Dibrën pa "kunjin e kaut në hulli", pa parti e partiakë me kërrabë në krah.

Dibra ka nevojë për drejtues që ia njohin vlerat e së kaluarës dhe të sotmes, që janë ngjitur dhe kanë zbritur "litarit të Gjalicave" ku u shkrua historia e trimërisë dibrane, monumenti pa "pllakë përkujtimore" e pa "guidë turistike". Dibra do një drejtues që t'i zgjojë "Liqenet e Lurës", "Liqenet e Kacnisë", "Bjeshkën e Zonjave", " Bjeshkën e Panairit"...

Dibra ka nevojë që heroi historik i Shqipërisë të shkojë në vendlindje e jo të "burgoset" në bulevardin e blirëve të plakur të Peshkopisë, ta çojë në Sinë për ti treguar botës se Gjergj i Gjon Dibranit është biri i saj që 18 beteja nga 24 i zhvilloi dhe i fitoi në Dibër me dibranët "shpatë e pathyer" të cilët u vetëflijuan, u dogjën dhe u përvëluan si asnjë trevë tjetër.

Shumë detyra e përgjegjësi ka një drejtues bashkie në Dibër krahasuar me drejtues bashkish në rrethin e 20 kilometrave katrore hapësirë gjeografike, "afër detit e afër mbretit", me rrugë e infrastrukturë shumë më lart asaj.

Një kryetar bashkie partiak, i të majtës apo të djathtës, mbrehur në "karrocë", me shkop majëmprehtë në vithe, nuk mund ta drejtojë Dibrën në të nesërmen e saj të lakmuar nga dibranët.

Një kryetar bashkie jopartiak, i zgjedhur me votën e drejtpërdrejtë të popullit, do të ketë guximin dhe trimërinë të vihet në udhëheqje të njerëzve për ti thënë "NDAL" dorës së zgjatur për mbytjen e saj. Do të marshojë në krye të njerëzve për të udhëtuar rrugës së vjetër të Dibrës, rrugës së Elez Isufit në mbrojtje të demokracisë shqiptare 1924, për tu treguar pushtetarëve se Rruga e Arbrit është Rrugë e Kombit e ndarë dhunshëm nga Londra 1913, duke denoncuar gënjeshtrën më të madhe që i është bërë nga Sali Berisha e Edi Rama, me zë e figurë në këto 11 vjet (2005-2016).

A ka Dibra njerëz të tillë që dalin në fushën e betejës dhe luftojnë për Dibrën?

A ka Dibra forcë që tua tregojë kufirin partive politike tek "Ura e Topojanit" dhe të votojë për një njeri që ngrihet mbi partitë në interes të saj?

Unë them PO.

Shpresoj të mos zhgënjehem...

Athinë, 20 maj 2016



Rruga e mashtruar e Arbërit dhe **Dibra e rrënuar**

Nga **PROF. DR. AHMET KAMBERI**

Në qasjen teknokratiko-robotike, rëndësinë e dorës së parë e ka fakti se sa shpejt do të kthehen në fitmshpenzimet e projektit të caktuar, në kuptimin që projekti të shlyejë shpenzimet dhe të fillojë të gjenerojë para. Në qasjen e përmbushjes së detyrimeve të ndërsjella, vihen në baraspeshë edhe përmbushja e detyrimeve të ndërsjella të pashlyera. Nëse detyrimet e pashlyera janë me peshë të madhe, shpenzimet, sado të mëdha të jenë, konsiderohen të papërfillshme. Në këtë rast, projekti përfshihet në përparësitë e dorës së parë. Nëse, pastaj, kësaj i shtohet logjika se projekti do të ndikojë në zhvillime të tjera, që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomiko-shoqëror të rajonit të caktuar dhe rjedhimisht, edhe në të mirë të vendit, kuptohet se përfitimet prej tij janë të pallogaritshme.

Analizën e plotë mund ta lexoni në linkun: **http://www.gazetadita.al/rruga-e-mashtruar-e-arberit-dhe-dibra-e-rrenuar/**

“T’i ruajmë lumenjtë ballkanikë! Stop ndërtimit të hidrocentraleve!”



Ekipi i Zemrës së Kaltër të Evropës dhe partnerët lokalë nga Dibra dhe Reka organizuan një veprimtari të pazakontë me datë 4 dhe 5 Maj në Parkun kombëtar të Mavrovës.

Kajakistë nga e gjithë Evropa, të udhëhequr nga ish sportisti olimpik Rok Rozman, në kuadër të Turneut nëpër lumenjtë ballkanikë, lundroi me kajak në lumenjtë Radika dhe Lumi i vogël nën sloganin: “Ti ruajmë lumenjtë ballkanikë – Stop ndërtimit të hidrocentraleve!”

Nëpërmjet këtij turneu kajakistët dëshirojnë që të rrisin vetëdijen për bukuritë e lumenjve dhe kërcënimet me të cilat ata ndeshen.

Edhe pse Parku nacional i Mavrovës është një ndër parqet më të vjetra në Evropë dhe një pikë me rëndësi nga aspekti i biodiversitetit biologjik, lumenjtë e tij të kristaltë janë cak për ndërtimin e 19 hidrocentraleve të reja, duke i përfshirë edhe dy hidrocentralet e mëdha, Ura e Boshkut dhe Fusha e Lukovës. Ndikimi i përgjithshëm bashkë me infrastrukturën e nevojshme e sjell në pikëpyetje statutin si park nacional dhe mbrojtjen e llojeve të rrezikuara.

Turneu nëpër lumenjtë ballkanikë është aktivitet i përbashkët i EuroNatur, Riverwatch, Leeway Collective и ËËF në kuadër të fushatës “Të rruajmë zemrën e kaltër të Evropës”, e mbështetur nga Front 21/42, Ekosvest dhe MED me partnerët lokalë, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit dhe Deshat, Dibër.

- Pika e nisjes në lumin e Radikës filloi në fshatin Niçpur te vendi i ashtuquajtur “Shkëmbi i Tërnicës”, ku lumi i Mavrovës derdhet në lumin e Radikës. Dhe në Lumin e Vogël, tek ura e Kaprollit.

Në ledinë pranë f. Jançe u organizua piknik me ushqim tradicional nga rajoni i Rekës.

Në tubimin e të gjithë pjesëmarrësve dhe kajakistëve në hotelin “Tuto F. Jançë” u organizua një takim, ku u prekën çështje të ndryshme mjedisore, që kanë të bëjnë me aktualitetin.

Tereza Shiler nga organizata EURONATUR mbajti referimin me temë “Të ruajmë zemrën e kaltër të Evropës”. Pasi shpjegoi gjendjen e lumenjve në Evropë dhe në Ballkan, ajo bëri thirrje të gjithë financuesve që të tërhiqen nga projektet hidro-energjetike në park, duke apeluar tek qytetarët të mos lejojnë shkatërrimin e zemrës së kaltër të Ballkanit – lumenjve, siç kanë bërë Evropa e tani edhe pse bëjnë përpjekje për kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme, është shumë vonë dhe se dëmet janë të pariparueshme.

Ajo theksoi se nga Qeveria pritet që të zbatojë rekomandimet e Konventës së Bernës. Ndërtimi i projekteve të hidrocentraleve në kuadër të Parkut Nacional të Mavrovës është në kontrast të plotë me objektivat e mbrojtjes së parkut

Rok Rozman nga “Kolektivi Livej”, i angazhuar në turneun e kajakut nëpër lumenjtë ballkanikë, tha se “Lumenjtë kanë domethënie thelbësore jo vetëm për Faunën, por edhe për banorët. Lumenjtë e pastër të Ballkanit kanë potencial të madh për rritjen e zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik, veçanërisht në Parkun Kombëtar “Mavrovë”. Për këtë qëllim lumenjtë duhet të mbetent të paprekur! Peshkatarët, kajakistët, ekologët - ne të gjithë duhet të bashkojnë forcat për të parandaluar ndërtimin e digave në Mavrovë dhe në gjithë Gadishullin Ballkanik “, tha Rozman Rock.

Aleksandra Bujarovska nga Organizata Front 21/42, duke vënë theksin në ruajtjen e parkut nacional, tha se “që nga viti 2013, planet për zbatimin e projekteve të hidrocentraleve në Mavrovë janë subjekt i apeluar para Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës”.

“Në takimin e 35-të, në dhjetor 2015 në Strasburg, Komisioni miratoi një rekomandim për pezullimin e të gjitha projekteve të hidrocentraleve në territorin e Parkut Kombëtar ”Mavrova“. Ky rekomandim është mbështetur nga ekspertë të pavarur të angazhuar nga komisioni, përfundimi kryesor i të cilit është se zbatimi i projekteve të planifikuara të hidrocentraleve në park nuk është në përputhje me statusin e mbrojtjes së parkut, vlerat e tij të forta të eko-sistemit dhe llojeve, në mënyrë që planet për zbatimin e projektet duhet të braktisen”, shpjegoi Alexandra Bujaroska.

Shuip Marku, nga Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit – Dibër, bëri një panoramë të veprimtarive të popullatës lokale të qytetit të Dibrës për ruajtjen e Parkut Nacional të Mavrovës. Mes të tjerash, ai falenderoi miqtë nga Shkupi, Sllovenia dhe Gjermania që angazhohen në mbrojtjen e lumit të Radikës dhe parkut Kombëtar.

“Për ne, Radika nuk është vetëm lum dhe ujë, por është vlerë shumëdimensionale, është identitet. Banorët e kësaj ane quhen lumjanë dhe rekas. Për Radikën është lidhur buka që prodhohet në tokat që ujiten nga ky lum, është historia e trashëgimia jonë, është arti, kënga dhe poezia, është dashuria ndaj mëmëdheut.

Që në vitin 2011 kur Qeveria e Maqedonisë rinisi idenë për ndërtimin e pendave në Radikë dhe devijimin e ujërave të saj për në lumin Vardar gjithë komuniteti u ngritën në mbrojtje të lumit, u mobilizuan qytetarët e Dibrës, Peshkopisë, dibranët në Tiranë, Shkup, New York e në Itali duke organizuar një seri protestash. Mediat e Shqipërisë dhe vetëm disa të Maqedonisë i hapën studio e veta për të senzibilizuar mbrojtjen e Radikës dhe Vjosës.

U realizuan peticione, tribina, aktivitete kreative protestuese si land art, aksion për dhurimin e gjakut, ndarje ushqimi tradicional etj.., vizita protestuese në vendet ku parashiheshin ndërtimet. Takime të shumta me shoqata të diasporës, shoqata ekologjike nga Maqedonia, Shqipëria dhe gjithë Europa. Dibranët morën pjesë në konferenca dhe aktivitete në Shkup, Beograd, Bruksel në brigjet e lumit Vjosa etj.

Karakteristikë e kësaj proteste ishte se në mbrojtjen e Radikës u bashkuan të gjithë pa dallim të përkatësisë etnike, politike e religjioze, së bashku shqiptarë, maqedonas, torbeshë, myslimanë e turq protestonin krah për krah në mbrojtje të Lumit.

Kryetari i komunës së Dibrës dhe këshilli i komunës së Dibrës që në ditën e parë mbështetën komunitetin dhe u radhitën krah për krah me ta, duke u thënë liderëve partiakë se ndoshta gjakun mund ta falim, por ujin Kurrë! JO!

U shkruan shumë poezi, u kënduan këngë si Sajmir Shehu me këngën për Radikën mori pjesë në festival, inxhinierët dibranë botuan librin *Radika dhe Dibra e Madhe*.

Pas rekomandimit të Konventës së Bernës, Banka Botërore e ka braktisur planin e saj për të financuar projektin Lukovo Pole. Megjithatë, rekomandimi nga Komiteti i Përhershëm të Konventës së Bernës nuk ishte mjaft i qartë për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe projekti “Ura e Boshkut” është ende në vazhdim.

Pas prezantimeve të temave u projektua filmi “Për një lum – tregim për Vjosën”

Pas filmit pjesëmarrësit debatuan në temën “Parqet nacionale kundër hidroelektranavet”

Pjesëmarrësit konsiderojnë se plani për projektin Ura e Boshkut duhet braktisur deri në statusin e ruajtjes së popullsisë së rrëqebullit të Ballkanit, sepse Parku Kombëtar “Mavrova” është i njohur si rezervati i vetëm ku riprodhohet ky lloj.

Pjesëmarrësit rikujtuan se Komiteti i Bernës ka dërguar mesazh të qartë për qeverinë e Maqedonisë dhe të Shqipërisë dhe të gjithë të përfshirëve në këto projekte, që nuk duhet të preken zonat të mbrojtura, dhe se Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim sipas këtij rekomandimi duhet të anulojë fonde për projektin. Ata theksuan se vazhdimi i zbatimit të projekteve të hidrocentraleve vogla në territorin e parkut të përkundër rekomandimit të Konventës së Bernës për të pezulluar, është shkelje e Konventës nga ana a Qeverive.

Një turne i tillë u zhvillua disa ditë më pas edhe në lumenjtë e Valbonës dhe Vjosës.

Korresp. Rr.A.

Karakteristikë e kësaj proteste ishte se në mbrojtjen e Radikës u bashkuan të gjithë pa dallim të përkatësisë etnike, politike e religjioze, së bashku shqiptarë, maqedonas, torbeshë, myslimanë e turq protestonin krah për krah në mbrojtje të Lumit.

Radika nuk është vetëm lum dhe ujë, por është vlerë shumëdimensionale, është identitet. Banorët e kësaj ane quhen lumjanë dhe rekas. Për Radikën është lidhur buka që prodhohet në tokat që ujiten nga ky lum, është historia e trashëgimia jonë, është arti, kënga dhe poezia...

profil



VËLLEZËRIT MEHMETI, në kërkim të teknologjive të reja

Nga **Osman XHILI**

Brez pas brezi, pjesëtarët e kësaj familje, në fshatin Trepçë të Dibrës, e nisën dhe vazhduan ekzistencën e tyre me bujqësi, tregti, besë e ndershmëri. Kur qe nevoja me mbrojtë tokën e vatanin, ishin gati dhe jetën ta jepnin, siç bëri stërgjyshi, Zenullai, në luftë me serbin, në vitin 1913. Djali i tij, Mehmeti, i mbetur jetim që herët, u burrërua para kohe nga hallet e shumta. U morr dhe me tregti, me paratë e së cilës bleu mbi tre hektarë tokë. Dashuria për punën u ngjiz tek djali i tij, Irfani, që rriti, edukoi me besimin tek Zoti dhe shkolloi pesë djemtë e tij në profesione të ndryshme. Njëri nga djemtë e tij, Zenullai, që ka emrin e stërgjyshit, ka mbaruar të lartën për Inxhinieri ndërtimi dhe punon në Qark. Ai e kujton babanë e tij si një bujk për t'u marrë model. Nëse hapte vijat për kullim apo për vaditje, ata ishin si t'u vije instrumentin. Nëse priste misër, kashtat e prera do të kishin të njëjtën madhësi, dhe stavët e vëna do të dukeshin si izoipse. Ashtu i rregullt në çdo drejtim, bile dhe një shkrim që ngjante si i stampuar. Nëse sot kam një rregullsi në dokumentacion, këtë gjë ia dedikoj më së shumti babait tim, - thotë inxhinieri.

Vitet 1993 – '95 i gjetën vëllezërit Mehmeti me punë në Nausa të shtetit grek, ashtu si shumë shqiptarë të tjerë. Shërbenin kryesisht në frutikulturë, mollë, dardhë e pjeshkë. Fituan para, por fituan dhe një eksperiencë e që të dyja këto do t'i investonin në biznesin e tyre në vitet në vazhdim. Në vitin 1996 vëllezërit menduan të ngrenë një pikë furnizimi me karburant. Shumë shpejt u bënë të njohur për ndershmërinë, korrektesën dhe respektin me klientelën. Aty ngjitur kishin 2,5 dynymë tokë, që vendosën t'i kthejnë në pemëtore. Mbollën pemë të egra, të cilat i shartuan me lloje të ndryshme, përfshirë dhe ato autoktone, që kishte pasur fshati i tyre. Shumicën e tyre i shartoi babai i tyre, Irfani, që vetëm pak kohë më vonë ndërroi jetë. Do të ishin këto si një kujtim i fundit, mes shumë gjërave të bukura që u kishte lënë fëmijëve e familjes së tij.

Megjithatë, investimi i bërë në pemëtari nuk mund të quhej diçka e rëndësishme. Ai fare pak i tejkalonte nevojat e familjes. Koha kishte ardhur për më shumë sipërfaqe e për më shumë teknologji moderne. Në vitin 2006 do të bënin hapin e dytë. Me asistencën e dy kushërinjve, Zenel dhe Medi Kajës, nga Gjorica, mbollën katër dynymë me pemëtore intensive, të llojeve Starking, Golden dhe pak Fuxhi. Kushërinjtë u sollën fidanët nga Italia, i asistuan në hapjen e gropave të bandierave, që bëheshin në mënyrë automatike, në thellësi 70 cm. Ata u treguan si tendosej teli i çeliktë dhe si realizohej momenti i afrimit tek bandiera, që në gjuhë teknike quhet momenti i përqafimit. Të gjitha këto ua bënë më të lehtë punën vëllezërve Mehmeti, që punonin si një skuadër e organizuar më së miri. Ata kanë mbajtur shënime për gjithë proceset e kryera, shpenzimet, por dhe për prodhimin në rritje. Vitin e dytë pas mbjelljes, morën 22 kuintalë mollë. Në vitin e tretë, 30 kuintalë. Më pas prodhimi shtohej me 30 kuintalë për çdo vit, për të arritur në vitin e dhjetë me 300 kuintalë.

Para dy vitesh sipërfaqja e mbjellë me mollë u shtua me gjashtë dynymë të tjera, nga të cilat u morën 30 kuintalë. Sipërfaqja e mbjellë me pemëtore ka shkuar në afër 1,3 hektarë dhe në pak vite prodhimi mendohet të shkojë mbi 700 kuintalë gjithsej. Këtë vit ata mbollën dhe 200 rrënjë lajthi, që do të thotë dy dynymë me këtë kulturë aq të kërkuar në treg. Do të donin të mbillnin akoma më shumë mollë, por për momentin nuk kanë tokë të përshtatshme. Ndoshta duhen politika më efikase nga shteti për qiramarrjen, - thotë Zenullai. Toka nuk duhet lënë djerr. Ta punojnë njerëzit, ose ta japin me qira.

Vëllezërit Mehmeti sapo kanë mbaruar së ndërtuari një pikë të re karburanti, më të madhe, më të bukur e më funksionale se e para. Pesë persona janë punësuar aty, që po të shtosh dhe dy vëllezërit më të vegjël, shkon në shtatë numri i tyre. Kanë planifikuar dhe zyra në të, një bar kafe për t'u relaksuar paksa pas punës së lodhshme, apo ku të ftojnë një mik për një pushim të shkurtër. Është ndërtuar dhe një dhomë frigoriferike me një kapacitet prej 300 tonësh, nëse shitja e prodhimit mund të mos realizohet direkt. Me gjithë vështirësitë e shumta, të ardhmen e shohin me shumë besim e shpresë. Janë në proces aplikimi te fondacioni Sared për një mjet, që do t'u lehtësonte mjaft shërbimet në pemëtari. Duan të përmirësojnë teknologjinë e vaditjes, për ta bërë në modelin me pika. Gjithnjë në kërkim të çdo gjëje, që përmirëson zinxhirin teknologjik të prodhimit. Ndoshta dhe një qendër prognoze do t'i shërbente mjaft përcaktimit të saktë të kohës, kur do të ishte e nevojshme spërkatja për një sëmundje të caktuar me një preparat adekuat.

Pesë vëllezërit ngjajnë me pesë petale të një luleje të bukur e plot aromë. Më i madhi, Nekiu, ka mbaruar Inxhinieri për shpim pusesh. Për tre mandate rresht ka qenë kryetar i komunës së Melanit. Disiplinimi i ujërave të pijshëm e vaditës, disiplinimi i plehrave dhe mbeturinave, ndërtimi dhe asfaltimi i shumë rrugëve të fshatrave me një cilësi të lartë, do të mbeten disa dëshmi të pakontestueshme të punës së tij ndër vite. Vetëm pak kohë para se të skadonte mandati i fundit, i bëri një tjetër dhuratë me vlerë komunitetit. Një shkollë 9 vjeçare plot dritë, laboratorë e kushte të mrekullueshme, sikur e plotësoi akoma më mirë tablonë. I dyti, Safeti, ka qenë në detyra të ndryshme, por më së shumti si profesor i fizikës në shkolla të mesme. I kompletuar në njohuri, me sjellje që rrezaton mirësi, ai gjatë do të ngelet në memoriet e nxënësve të shumtë që ka pasur ndër vite. Pak fjalë folëm më sipër dhe për inxhinierin tjetër, Zenullain, që punon në administratën e Qarkut. Sa e sa projekte të ndryshme mbajnë firmën e tij si hartues e zbatues, për t'u pasuar ndoshta nga shumë të tjerë në të ardhmen. Dy më të vegjlit, Zamiri dhe Dëfrimi, të sjellshëm e plot kulturë, janë më afër biznesit, karburantit dhe pemëtarisë.

Para se të ndërronte jetë baba Irfani, u la një porosi, një amanet. Pasuria duhet siguruar o djemtë e mi. Por jo në kompani që vjedhin, por te Zoti i gjithësisë. Duhet të jepni çdo vit zekatin e fitimit, prej 2,5 për qind apo një në dyzetë, - siç thotë populli. Po ta bëni këtë, pasurinë tuaj nuk e djeg zjarri, nuk e përmbyt uji dhe nuk e vjedh hajduti. U bënë vite e vite që vëllezërit kanë krijuar një traditë. Me raste festash fetare, ata shpërndajnë ushqime apo vlera monetare për të varfër, për jetimë apo për njerëz të tjerë në nevojë. Shpërblimin e presin vetëm prej Krijuesit dhe Ai ua ka kthyer atyre shumëfish.

Por lulja e familjes Mehmeti ka çelur gonxhe të reja, të bukura, fëmijët e fëmijëve. Disa kanë mbaruar shkollimet e larta, të tjerë vazhdojnë në kolegje prestigjioze, si një stafetë brezash që shkon gjithnjë e më larg, gjithnjë e më lartë.







Sot busti Josig Bagerit gjendet në lulishten e heronjve në Dibër, matanë kufirit shqiptar, duke vështruar me mall trevën e të parëve dhe pasardhësve të tij.

reportazh

Josif Bageri, *rilindasi "rebel"*



Në historinë tij të lavdishme si një bir i denjë i trevës së tij, dhe një shqiptar i dhënë pas shqiptarizmës, ai hyri në këtë botë i padatuar dhe u largua prej saj po ashtu, duke mbetur kurdoherë mes njerëzve të mirë, punëtorë, të drejtë për çështjen kombëtare, parimor në luftë për të drejtat e të varfërve dhe ngritjen e tyre arsimore dhe kulturore.

Rilindasi "rebel", shembull i shpresës të kohës së re me heronj të rinj, aq të domosdoshëm për një Shqipëri demokratike me rrënjë ilire dhe pellazge.

Nga **Prof.as. Dr. Genci LUARASI**

Ne gryken e Parkut Kombetar, te Dibres fshati Nistrove eshte i fshehur nga druret shekullore ku degjohet gurgellima e perroit te Bukovarit, dege e Radikes, buze te cilit ne Reken e Eperme fshati ne fjale njihet i rregjistruar 400 vjet me pare ne rregjistrat kadastrale te Perandorise Osmane, i banuar me te krishtere shqiptare te cilet edhe nen pushtimin osman nuk e ndryshuan fene e tyre per aresye te vendodhjes se tyre dhe te karakterit malesor. Fshati me pamjen nga perendimi sheh Radiken qe ne kohet e fundit te nje viti me pare dhe botimit te fundit te studiuseve dibrave ka mare emer per problemet hidrike dhe mikroklimen qe mbart per zonen ku gurgullon me kengen e tij malore i kthjellet si mencuria e popullsise autoktone dibrane e kudo ndodhur ne trevat shqiptare. Mbrapa ngrihet Mali i Kabashit, ne perendim mali i madherishem i Korabit, ne jug Gur' i Zi, ndersa ne lindje mali i Verdunit. Jeten ne ate zone e jep lumi i njohur i Radikes gjate rrjedhjes te te cilit banoret zbresin ne qytetin e Dibres, ashtu si edhe i riu Josifi djaloshi i holle dhe i gjate zbriste ne Diber ku gjyshi i tij punonte si nallban . Qe i vogel ai dallohej nga etja per aresim nje vecori e te gjithe banoreve te asaj treve me qendrime patriotike ne lidhje me jeten shoqerore dhe dashurine per vendin e tyre. Por, varferia e asaj zone nuk e mundesoi ne menyre te organizuar te plotesonte aresimin fillor e metej, ai per aresye ekonomike qe ne vogeli nisi punen duke ruajtur bagetite e fshatit, por qe ne ato livadhe te takonte patriote te levizjes per liri e zhvillim kombetar. Ne Diber ate kohe vjen A. Frasheri, i cili punonte per ngritjen e ndjenjes kombetare, keshtu duke u rritur djaloshi i ri me zgjuarsi mendon per te ardhmen dhe nje dite zbriti per te kerkuar pune ne Diber, Tetove dhe Gostivar qe do t'i siguronte jo vetem jetesen,e me vone te emigronte ne Sofje te Bullgarise duke nisur punen si shegert ne profesionin e kepucarit, profesion qe e shoqeroi gjate gjithe jetes. Ne kete kohe ne perpjekje per nje jete me te mire ai njihet ne moshe 16-17 vjece me shoqen e ardheshme te jetes Vasiliken, e cila ju be krah i forte ne te mire dhe veshturesi duke mos ju ndare per asnje cast, duke i falur radhasi 9 femije shume prej te cileve nuk e jetuan jeten e tyre me ato kushte te veshtira te jetes se tij, ku ai per asnje rast nuk u perkul veshtiresive dhe mjerimit

Krijimi i familjes per 19 vjecarin trimne vitin 1887 shtroi para kesaj familje te re kerkesen per t'a perballuar, prandaj ata morren rrugen e kurbetit, sot do te quhej emigrimit . Stacioni i tij si per shume emigrante sociale ishte Bullgaria e pikerisht Sofja, e cila po mblithte forca krahu pasi ne ate periudhe ishte shpallur autonome dhe Sofja ishte caktuar si kryeqytet i shtetit te ri te dale nga Traktati i Shen Stefanit. Vertet, qe atje po punohej per krijimin e kryeqytetit te ri, ku po ndertoheshin ndertime, rruge dhe kalldreme, por atje ishte edhe nje mase e madhe shqiptaresh nga viset te jugut te Shqiperise, por nder ta edhe shume dibrane, sidhe te ardhur nga Korca, Kolonja, Permeti, Gjirokastra, Elbasani, Kruja, Dibra.

E solli fati qe te vendosej me keta shqiptare ne kafenene "Albania" dhe dyqanin ushqimor te patriotit boboshtar Dhimiter Nikolla Mole. Atje cdo nate mblidheshin dhe shkembenin hallet e jetes se tyre zanatcinj, punetore ndertimi. Sigurisht, nje pune te madhe krahas tregetise kreu i palodhuri Dhimiter Mole, qe me dashuri aterore filloi te emancipoje keta njerez te punes duke u lexuar libra shkollore, qe terhoqen dhe zhvilluan dashurine per aresimin dhe ndricimin e mendjes se ketyre fukarrenjve.

Ne 1895, vijne te jetojne ne Sofje te sapo diplomuarit e shkolles Normale te Bukureshtit Koste Jani Trebicka bashke me Kristo Papastefan Luarasin. Dhimitri Mole, nga Boboshtica njeri i kenduar, filloi hapat e para e te mesuarit shqip analfabeteve, te cilet ne mjedisin e punes ishin te etur per aresim. Me vone ai hap hanin ku strehon bashkefshatret duke punuar per aresimin e tyre. Figurat e memedhetareve Dh. Mole, A. Shkabes, S. Garos dhe me tej te K.Luarasi dhe K.J. Trebickes i u shtua autodidakti me vullnet te forte J. Bageri me vjershat e tija si nje perfaqesues i ri i te pergatitur ne ate mjedis.

Qe ne fillim talenti i tij vjershetor kishte si teme jeten e njerezve te varfer te punes, por qe dalloheshin per deshiren e paepur per aresim dhe zhvillim.

Shpejt, shqiptaret organizohen ne shoqerine aresimore dhe kulturore me emerin simbolik "Deshira", ku Josifi i ri filloi te spikaste pikerisht me vjershat e tija, ku ndihme dhane librat e para te ardhura nga Bukureshti nga punetori i paepur per aresim e zhvillim Nikolla Naco dhe me pas ne 1896 me botimet e shtypshkronjes "Mbrothesia" (Perparimi) e drejtuar nga ish normalistet K. Luarasi dhe K.J. Trebicka.

Ne 1893 ne nje te Kolloxhekut te vitit 1893 formohet "Shoqeria Deshira" duke botuar libra me Alfabetin e Stambollit. Kjo shoqeri u krijua sipas normave te nje shoqerie shoqerore kulturore dhe aresimore qe pembante programin, stemen, vulen, kuotat sidhe organet drejtuese. Sot, keto duken si gjera te lehta por veshtresite asokohe ishin te dyaneshme si ndergjegjesimi i anetareve nga njera ane dhe presioni turk nga ana tjeter. Josifi kishte nje deshire te paepur te recitonte sidomos vjershat e Naimit – sic e kujton bashkeshortja e Kristos, Polikseni Luarasi Dhespoti, e cila u mesonte ketyre emigranteve shkrimin e kendimin shqip. Si bashkeshote, shoqe dhe bashkepunetore e K. Luarasit e mesuese ne ate shoqeri, e ktheu shtepine ku banonin ne shkolle te mbremjes se ketyre zejtareve. Shoqeria me pas vendosi te krijoje lidhje me familjen Frasheri ne Stamboll ku vajti fillimisht S. Garo.

Qysh ne fillim shoqeria u mundua te shtonte rradhet e anetareve te saj, ku Josifi shprehet per terheqjen e shqiptareve myslimane sidhe shtrirjen e shoqates ne qytete te tjera krahas Sofjes si Filipol, Varna, Rila. Gjithashtu ai filloi t'u afrohet socialisteve bullgare, prej te cileve mesoi shume gjera. Karakteristike ishte se ai perfaqesonte shtresen e zanatcinjve me mjete pune, si kepucar, gurrgdhendes, muratore te cilet krahas duarve perdornin edhe veglat e punes, te cilet ne France duke qenese e ruanin zanatin dhe veglat e tyre per mbijetese, kishin krijuar nje organizate e quajtur Masoneri, e cila kishte adoptuar edhe statutin e saj dhe karakterizohej nga nje hije sekreti dhe fshehtesi profesioale! Kesisoj Josifi shfaq prirje te majta, gje qe solli nje qendrim largues nga shoqeria "Deshira", dhe nga ana tjeter ai tentoi te krijonte nje shoqeri te re "Bashkimi". Ne fakt me ardhjen e K. Luarasit dhe K.J.Trebickes me ngritjen e shtypshkronjes ne sherbim te shoqerise, organizimin e shtypit, me ndihmat materiale te atdhetareve u rrit botimi i nje sere librash dhe vecanerisht te enciklopedise se xhepit "Kalendarit Kombiar" si botim masiv ku vihet re aktivizimi i Josifit me botimin e vjershave dhe te artikujve te tij. Nga ana tjeter ata mundoheshin t'a ndihmonin duke drejtuar bashkeatdhetaret ne dyqanin e tij te kepuceberesit..

Mirepo puna e rende, veshtiresite materiale e renduan shendetin e tij dhe ne vitin 1899, Josifi u semur rende megjithse i paepur dhe ne moshe te re e kaloi kete vale.

Ne fund te vitit 1899, Josifi shkon per nje vizite ne Stamboll qe te njihet me vjershetorin tone te madh Naim Frasheri, ku biseda me te i dha je shtyse veprimtarise se tij te metejshme, por vdekja e mikut te ri ne vitin 1900 e vrau shume.Vete ai e pershkruan takimin me te madhin Naim Frasheri ne Stamboll, qytet qe per shqiptaret patriote e jo vetem atyre ka mbetur si nje Meke e gjithe atyre qe morren udhet per atje. Sic e pershkruan vete: Ne vitin 1898 me 12 te vjeshtes pare, patem fatin e mire te ndeshemi me shpirtndriturin e pa harruet kurri Naim Beje Frasherin,cili n'at kohe ishte shume i semun, po na priti si femin e vet dhe u muerrem vesh fort shum mire tuj u marr vetem per ceshtjen kombetar d.m.th. kuvendi yne ishte vete per ceshtje kombetare. Kuvendimi me kete korife ishte i gjate pavaresisht gjendjes se tij te renduar shendetesore. Vdekja e tij solli nje periudhe te rende per kete hero te Rilindjes sone, i cili u largua nga shoqeria duke udhetuar per ne Serbi: por nga shiu ra ne bresher! Ai filloi te mbante lidhje me Kosoven duke udhetuar ne Peje ku shpreh iden e bashkimit te dy trevave shqiptare me hapjen e shkollave shqipe si shprehje me e larte e shqiptarizmit kunder Turqise. Gjate vizites ne Kosove ai shperndan gazeten "Drita" e Shahin Kolonjes dhe K. Luarasi. Atje takohet me B. Currin. Nderkohe ai mbajti nje qendrim kritik ndaj dy pretendenteve te fronit shqiptar te kohes Aladro Kastrioti dhe Albert Gjikes, ku shprehet kunder fronit si faktor bashkues kombetar kunder Turqise.

Veprimtarine e tij krijuese te vjershave me karakter problemor qe arrin t'a mbledhe ne nje veper madhore te tij "Kopshti Malesor" me 78 faqe qe kishte 43 vjersha te ripunuara, te cilat nxisnin krenarine kombetare, sedren shqiptare, luften kunder Turqise, gjendjen ne Shqiperi, fanatizmin; nuk i mungon humori i holle i treves se Dibres. Ai kalon ne gjurmet e letersise se kohe, por me origjinalitetin e tij. Kjo veper u botua nga Kristo Luarasi ne vitin 1910 ne shtypshkronjen "Mbrothesia". Ne vitin 1905, ai u lidh me Ivanaj dhe gazeten e tij, ne te cilen botoi vjersha, artikuj dhe shkrime politike gjithmone me ngjyre revolucionare kunder Turqise.

Nje shtytje per bashkim luftarak ishte njohja ne Sofje me Cerciz dhe Bajo Topullin, Mihal Grameno te cilet pasi benin ndonje aksion kunder turqeve dhe armiqve te brendeshem te Shqiperise, kurdohere e gjenin te hapur deren e shtepise se Kristo Luarasit me mirepritjen e Poliksenit. Rritja e frymes luftarakete tij arriti aq sa ai u be gati te hidhej ne Diber, ne veprime luftarake duke organizuar "luften per liri". Ne vitin 1907 lidhet me Hil Mosin, kerkon te organizoje nje shoqeri e quajtur "Afron dita", por nga ana tjeter ditet i kishte te pakta. Qendrimi ndaj Turqeve te Rinj me fytyra te reja, por ideologji te vjeter ne vitin 1908 ben qe ai te rikthehet ne Reken e tij, ku nisi te organizonte aresimin, pasi Shqiperia kishte plot armiq . Por gjendja ekonomike e rende, vjedhjet, grabitjet, pasiguria, krijonin nje pamundesi reale per nje pune te mbare.



Gjate dy vjeteve 1909 - 1911 ai nxorri gazeten "Shqypeja e Shqypnise", pavaresisht se e kane luftuar duke e quajtur pro-bullgar ajo ishte nje nga gazetat me progresive te kohes. Gjuha e saj ishte gegenishtja duke hyre ne trevat me dialektin e saj dhe jo vetem aq. Me dhembe po e botonte gazeten, duke mbajtur korespondence me Ibrahim Shytin ne Vlore.Organi i tij ishte nje ze i fuqishem ne ato vite te parapavaresise. Kjo gazete perben sebashku me permbledhjen "Kopshtar Malesori vepren e plote te krijimtarise se tij. Vjershat sebashku me pjese te shkurtera didaktike ishin botuar me pare tek "Shqypeja e Shqypnis" ne rubriken 'Pjese mesimore'. Figura e tij me nje fizik te mprehtete holle mbahet mend nga anetaret e shoqerise "Deshira" nder ta perpiluesit e librit "Shenime historike" e botuar ne Sofje ne 1937, ku sebashku me fotografine e tij japin nje pershkrim te tij, duke e cilesuar si nje memedhetar te flakte Josif Bageri Rekasi, ky patriot i vertete qe punonte pa lodhje, penda e tij prehje s'kishte, vjershat e tij tingellonin ane e kend. Gazeta e tij "Shqypeja e Shqypnis" ishte nje organ politik, i cili mbahej me ndihmat bujare te shqiptareve dhe shperndahej gratis nder shqiptaret e vobekte. Me ne pjesen artistike e permbledhur ne librin "Kopesht Malesori" jane botuar tre vjersha ku jepet vleresimi i patrioteve te Kolonise per kete patriot. Ato shprehin vrasjen e Papa Kristo Negovanit, Spiro Kosturit dhe at Vasil Negovanit, qe titullohet " Nje piramid deshmorevet" ne te cilen autori lavderon heroizmin e te tre patrioteve shqiptare te rene ne lufte pembrojtjen e gjuhes shqipe kunder shovenizmit grek, ndersa dy vjersha te tjera perbejne moton e gazetes se tij. Nje ndihme morale per te ishin edhe pergezimet e shqiptareve te Amerikes, te cilet e vleresuan per shpirtin luftarak qe u ndezi gjakun atyre me ndjenjen kombetare. Nderkohe kurdohere ai mban nje qendrim kritik ndaj cdo fuqie politike europiane. Analiza rreth shtypit te tij eshte e gjere dhe jashte ketij artikulli, duhet thene se ai kerkonte bashkim dhe lufte kunder kujdo dhe ai shkruan dhe boton; boton dhe shkruan. Keshtu qe Josif Bageri u perfshi ne plejaden e botuesve te shtypit te kohes nga me revolucionaret e produktive krahas personaliteteve te spikatur te te shtypurit shqip te kolonise se Sofjes si A. Shkaba, K.J.Trebicka, Josif Bageri, Dh. Mole, P. Ll. Treni e shume te tjere. Ne botimin e Loni Grabockes "Historia Kolonise shqiptare ne Sofje" ai thekson: Nuk dua te le pa permendur edhe nje emer, i cili eshte mjaft i njohur ne rrethet e kolonise se Sofjes, Josif Bagerin. "Per te dime shume pak, por ai eshte nje nga aktivistet e medhej te levizjes clirimtare. Dime vetem kete se ai vete eshte ne Shqiperi dhe me arme ne dore lufton per clirimin e Shqiperise ku gjen dhe vdekjen e tij." Te shumte ishin anetaret e shoqerise Deshira qe e kane njohur dhe pershkruar cilesite e tija. Ai karakterizohej si nje patriot i flakte qe merrej me politike, qe udhetonte dendur ne mes te Stambollit, e Bukureshtit duke shperndare libra duke hyre fshehurazi edhe ne Shqiperi per pune patriotike. Fizikisht kishte nje pamje te bukur pasi vinte nga vende ku kishte uje te paster dhe te ftohte, goje embel pasi kishte pire uje te bute me nje gjuhe shqipe te paster. Kudo qe hynte ishte i mirepritur duke biseduar me bashkebiseduesit per pune politike, hallet e vegjelise i interesuar per punet e kolonive shqiptare ne rajon. Vete jetonte ne Sofje ne nje lagje periferike e quajtur Banishora, ne rrugen Bratja Milladinovi (Vellezerit Milladinov) plote me kopshte dhe shtepi te ralla, ne nje te tille perdhese banonte sebashku me familjen e tij gruan dhe dy femijte, djale dhe vajze. Ishte me zanat kepuceberes dhe shume shqiptare porosisnin tek ai kepucet. Edhe personalitete bullgare te kohes si poeti proletar Dimiter Poljanovi, e vleresonte si nje shqiptar te madh burre shume te zgjuar.

Ne historine tij te lavdishme si nje bir i denje i treves se tij, dhe nje shqiptar i dhene pas shqiptarizmes ai hyri ne kete bote i padatuar dhe u largua prej saj po ashtu duke mbetur kurdohere mes njerezve te mire, punetore te drejte per ceshtjen komberare, parimor ne lufte per te drejtat e te varferve dhe ngritjen e tyre aresimore dhe kulturore.

Nga ana tjeter shume patriote jene perpjekur me te dhena te terthorta te percaktojne vitin e lindjes dhe te vdekjes sidhe vendin ku ka vdekur. Sipas disave prej tyre rezulton qe Josif Bageri ka lindur ne vitin 1868, ndersa sipas te vese se tij Vasilikes,ai ka vdekur me 15 prill te vitit 1916, dhe keto te dhena i ka transmetuar djalit te saj te fundit Aleksander Josif Jovan Bageri.Te dhenat e tija duken me te plota dhe me te besueshme per t'i patur si udherefyes per te kerkuar rreth kesaj figure enigmatike, shpirtzjarrte, te paperkulur me nje llogjike te ftohte si uji i bjeshkeve te Rekes, i rahur me tallazet e egra te jetes, i dashur me kedo i mesuar dhe i gateshem per mbijetese te tij dhe familjes se madhe qe i kishte sjelle e shoqja e tij kurajoze Vasilika nga Prilepi, te cilen e njohu ne Sofje ku banonte tek nje nga tezet e saj me te cilen u martua ne 1886. Shpjegimet dhe datimet e tija jane me te besueshme. Ndersa fundi i tij eshte shume i dhimbeshem.



Ai, diti te beje nje analize te hollesishme Turqeve te Rinj duke u shfaqur si nje protestues i fuqishem.

Nje hop cilesor solli udhetimi i tij ne Rumani dhe Rusi, tek vellezerit shqiptare, gje qe perben nje kapitull te ri ne jeten e tij politike.

Ne 1912 pas shpalljes se Pavaresise ai vjen ne Shqiperi pikerisht ne kohen e Ismail Qemalit dhe te Princ Viedit. Nje kritike te fuqishme ai i ben Esat Pashes, intrigave te tija. Ne kete periudhe udheton shume dhe shikon gjendjen e veshtire te vendit te tij qe e deshperon, shto semundjen dhe varferine qe po i rrezikonte familjen dhe shendetin e tij.

Ne vitin 1916, ndermer nje udhetim heroik ne kundershtim me lutjet e familjes se tij, duke rrugetuar me kembe, pasi nuk kishte mjete financiare per te perballuar kete nisme te re te tij. Ishte rrugetimi i tij i fundit dhe mbyll syte i vuajtur ne prill te 1916, pikerisht 100 vjet me pare i cfilitur dhe i vetmuar ne nje spital te Prishtines, i semure pa asnje qindarke ne xhep, nderkohe qe nje miredashes i mbylli syte dhe i grumbulloi librat e tija. Ai u varros ne Kishen orthodokse te Prishtines, ku gjendet edhe vendvarrimi i tij.(?)

Ky ishte fundi i pamerituar i atij djaloshi guximtar nga Reka e Eperme, per te cilin nje shkrim perkujtimor, nje monografi e Ruzhdi Mates jane gjithesesi pak per te nxjerr ne pah kete figure te gjalle stoike, kryengritese me shpirt epik te paepur. Sot busti i tij gjendet ne lulishten e heroinjve ne Diber matane kufirit shqiptar duke veshtruar me mall treven e te pareve dhe pasardhesve te tij. Ne keto kushte per te perkujtuar kete bir te Dibres e te mencurve dhe punetoreve te aresimit dhe zhvillimit, nje grup intelektualesh, para nje viti me 2 maj 1915 ndermoren nje udhetim shkencor per ta perkujtuar kete figure me nje buqete me lule krahas te madhit Said Najdeni sebashku me perkujtimin prane shtatores se Skenderbeut te gjithe te bashkuar per ceshtjen shqiptare ne ate lulishte ne qender te qytetit te Dibres ne Maqedoni. Krahas kesaj grupi intelektual te dijes dhe kultures ndermori edhe nje udhetim plotesues deri lart ne Nistrove, i shoqeruar nga mikpretesit e Komunes se Dibres, deri tek varret e te pareve te Josif Bagerit. Nje pjese e asaj rruge te perpjete te lodheshme grupi i vogel prej 13 intelektualesh te organizuar nga e papertuara mekuese e figurave te Rilindjes sone Kombetare te dy shekujve te kaluara znj. Elida Jorgoni, Kryetare e shoqates "Foleja kombetare shqiptare" e bene me kembe per te vene lule ne varet e familjareve te Josifit duke kryer ritet perkatese, sic e kerkon kujtesa patriotike e fetare e trevave tona dhe me nje lehtesim u rikthyen ne Shqiperi, me shpresen se ndonje ekspedite shkencore do te kerkoje te gjeje ne Kosove eshtrat e ketij Rilindasi "rebel", shembull i shpreses te kohes se re me heronj te rinj aq te domosdoshem per nje Shqiperi demokratike me rrenje ilire dhe pellazge.

Eshte nje domosdoshmeri te evoluohen te gjitha vlerat shekullore te nje populli te lashte ndryshe nuk mund te arrihet nje zhvillim dhe egzistence kombetare e nje kombi. Eshte detyre paresore e seciles qeveri, sic eshte puna e individeve te shoqerizuar qe krijojne te mira materiale per sot dhe neser, ndryshe nje komb nuk meriton te ekzistoje.

Gazetën "Bulqiza", një pasqyrë e gjallë e të sotmes dhe e të kaluarës së Bulqizës...

Gazeta **"Bulqiza"** feston 1-vjetorin

Nga **Shaqir SKARRA**

Lindi para një viti. U rrit shpejt. E hapi brazdën e parë në udhën e bukur e të vështirë të shtypit. Në fakt, "Bulqiza" ka lindur më herët, vite më parë, por para një viti u rilind dhe shumë shpejt vajti në çdo skaj, kudo ku ka e jetojnë bulqizakë. Dhe jo vetëm bulqizakë. Ndaj, më 15 maj, në ditëlindjen e parë, u mblodhën të gjithë bashkë në një nga sallat e Hotel Tirana International gazetarë, bashkëpuntorë të mediave, studiues e qytetarë të Bulqizës për të festuar ditëlindjen e gazetës "Bulqiza".

Të pranishëm në këtë veprimtari ishtin deputeti Roland Keta, anëtarë të kryesisë së shoqatës "Bulqiza", kryetari i shoqatës "Bashkësia dibrane" Bujar Kapexhiu, nënkryetari i shoqatës "Lidhja e Intelektualëve dibranë" Musa Riçku, botues të gazetave "Rruga e Arbërit", "Dibra" , "Zëri i Gollobordës", gazetarë të njohur dhe miq të gazetës "Bulqiza".

Eva Gjura, një gazetare e njohur kishte marrë rolin e moderatores. Në fillim, për të përshendetur dhe folur për fillimet e gazetës "Bulqiza" foli kryeredaktori i saj, Halil Rama.

"U mbush një vit, tha në fjalën e tij zoti Halil Rama, që botojmë gazetën "Bulqiza" një pasqyrë e gjallë e të sotmes dhe e të kaluarës së Bulqizës, si një rreth i njohur për vlerat ekonomike, kulturore, historike dhe fetare. Gazeta u hap sërish vitin e kaluar (Numri i parë doli në maj 1992), me nismën e një grupi intelektualësh të Bulqizës duke promovuar atë çka vjen si vlerë nga e kaluara dhe i flet të sotmes me një pasqyrim real të problematikave të shumta që ka sot komuniteti i këtij rrethi. Njëkohësisht ky rajon përbën një pasuri të pa të madhe kombëtare në traditën e nxjerrjes dhe përpunimit të kromit duke i dhënë ekonomisë shqiptare të ardhura të fuqishme në industrinë minerare. Ky kantier gjigand ndërtimi i cili nuk pushon së punuari në tre turne të kohës kërkon një pasqyrim që të na japë tabllo të plotë të mundit, djersës, sakrificës së punëtorëve dhe nga ana tjetër jeta e tyre shpirtërore, morale dhe estetike që shpërfaqet në gazetën mujore "Bulqiza" është tashmë një zë i spikatur në tregun mediatik shqiptar".

"Gazeta "Bulqiza", tha Rama, natyrisht nuk do të kishte mundësi të botohej pa mbështetjen financiare të z. Edmond Isaku, administrator i TV-Bulqiza dhe i kompanisë "Isaku SHPK" që merret me nxjerrjen e mineralit të kromit. Edmondi duke qenë edhe kryetar i shoqatës së rrjeteve kabllore dhe televizioneve lokale ka fituar një përvojë të shkëlqyer mbi mediat elektronike dhe të shkruar duke u bërë faktor në komunikimin publik dhe emancipimin e përgjithshëm kulturor. Përvoja e gjatë si kështilltar bashkiak i ka dhënë mundësi Mondit që të njoh në detaje problemet ekonomike shoqërore të Bulqizës. Ndaj i nxitur nga këta stimuj mjedisor rreth 18 vjet ma parë ngriti televizionin lokal i cili tani është fuqizuar në përhapjen e valëve dhe në cilësi programe transmetimi. Po ashtu në rindërtim të ideve të reja dhe të vizionit për të ardhmen.Tani mbushi vitin edhe gazeta "Bulqiza" e drejtuar nga Edmond Isaku. Si drejtor i gazetës "Bulqiza Mondi ka instrukturuar një qëndrim të moderuar dhe ligjor ku përmes fakteve dhe opinioneve iluminohet e kaluara, pasqyrohet me realizëm konteksi aktual dhe vizualizohet e nesërmja. Rubrikat e ekonomisë janë trajtuar me mjaft kompetencë nga inxhinierë dhe ekonomistë të shquar të Bulqizës si dhe nga intelektual që fituan përvojë në minierat dhe ndërmarjet e tjera të këtij rrethi. Kjo zonë e begatë dhe e pashtershme mineralmbajtëse ka njerëzit e saj punëtorë, me një shpirt heroik dhe të guximshëm që nxjerrin nga thellësitë e nëtokës në 1 km, kromin e metaltë që do të eksportohet në vende të ndryshme të zhvilluara perëndimore", tha kryeredaktori i gazetës "Bulqiza".

Më pas, ai bëri një pasqyrë të rubrikave të gazetës si dhe falenderoi bordin e gazetës, i cili punon vullnetarisht, duke bërë një punë fisnike dhe humanitare në emancipimin e gjithanshëm të banorëve të Bulqizës, përmes kësaj tribune të mendimit të lirë. GJithashtu, ai falenderoi të gjithë bashkëpunuesit në veçanti Dr. Gafur Muka, Dr.Jashar Demiri, gazetaren Eva Gjura, gjyqtarin Vladimir Skënderi, bashkëshortët mësues Aishe Balla e Halil Begu, veprimtarin e shoqërisë civile Danjel Bica, mësuesit në pension Mehdi Dema e Destan Rama si dhe studentët e gazetarisë Sami Curri e Edison Balla dhe bën thirrje që ta zgjerojmë diapazonin e gazetës me zgjerimin e gamës së problematikës dhe tematikës si dhe rrethin e bashkëpuntorëve të saj.

Kryetari i këshillit botues të gazetës, shkrimtari i njohur dibran Lutfi Hanku edhe pse i moshuar nuk mund të rrinte pa marrë pjesë në këtë evinement mjaft të rëndësishëm nuk mund të rrinte pa marrë pjesë, nuk mungonte dot pasi ai do ti thoshte bukur fjalët e tij për gazetën dhe stafin që e drejton prej një viti .

"Bukuria e fjalës së shkruar nuk dritëron e metaforizohet vetëm në gjininë e prozës e poezisë por edhe në fuqinë magjike të mendimit të zhanrit të gazetës që bisedon çdo ditë me njeriun-tha në fjalën e tij Lutfiu. Mes këtij prodhimi të begatë , vazhdoi më poshtë ai, këndon e gjëmon, qesh e qan jeta në 36 shkronja edhe në botën e gazetës "Bulqiza" e shoqatës sonë atdhetare, kulturore, me drejtor Edmond Isakun, kryeredaktor Halil Ramën, redaktor Eva Gjura, Dr.Hajri Mandri,Sakip Cami, Sami Curri që meritojnë falenderim dashurie. Vërtet në tunelet e Duriçit, të Muriqit e Martaneshit buçasin simfonitë e kangës së kromit, por edhe 36 shkronjat e gazetës duartrokasin duke harruar gjumin gazetarët, shkrimtarët, zgjojnë në kullat e Dibrës epopetë me vyrtualitetin e forcës e gëzimit.

Natyra e gazetës duke përzgjedhë dhe formën e përmbajtjen, redaktorët me qëllimet e veta ngulmojnë në përsosmërinë e individualitetit fisnik të personazhit për ta çuar tek lexuesi me ashkun njerëzor e të vërtetë.

Më pëlqejnë gazetarët e shkrimtarët që manifestojnë vlera.Lexuesi i mbledh në muzgun e kujtesës dhe ia fal lexuesit të ri imagjinar. Gafur Muka boton vlera artistike, Eva Gjura e tjerë që gëzojnë mendimin poetik.Ringjallet gazeta edhe mistikisht me deputetë, udhëheqës popullrë, filozof, shkencarë, politikanë të majtë e të djathtë dhe klerikë.Kanë rinuar gazetën emra befasues që premtojnë vlera shkrimesh edhe ma të pjekura si Agim Demiri, Halil Begu, Sami Curri, Edison Balla etj.

Sido shtypi i sotëm ka nevojë për qytetarinë e fjalorit e të mendimit metaforik. Kjo i jep më shumë vlerë, peshë e bukuri gazetës me gjithë impenjimin serioz të lavdrueshëm të Halil Ramës e Hajri Mandrit.Duke më dritërue në këtë tubim edhe drejtorin e përkushtuar që ka derdhur dashuri e sakrifica ekonomike. Ai ka çuar tek lexuesi fjalën e mbjellun në letër, zanin, dritën, mendimin, ajrin e jetës por nuk gaboj të them: Edhe dashurinë. Kjo dashuri e shoqatës quhet Edmond Isaku!

Deputeti i zonës zoti Roland Keta në përshëndetjen e tij tha: "Ndjehem i lumtur që ndodhem sot mes jush që keni mbajtur gjallë këtë gazetë të qytetit tim. Ju falenderoi sinqerisht dhe ju uroi suksese të mëtejshme. Ju jeni zëri i qytetarëve të Bulqizës të cilët kanë gjetur dhe do të gjejnë edhe në të ardhmen tek ju një portë të madhe ku do të trokasin për hallet dhe problemet e shumta sociale që mbartin". Përshëdeti edhe Bujar Kapexhiu si dhe Bashkim Lami. Në fund drejtori i gazetës Edmond Isaku pasi falenderoi të pranishmit që kishin marrë pjesë në përvjetorin e parë të gazetës tha:"Jam i bindur se puna ime është e vogël deri tani përballë asaj pune që ka bërë stafi i gazetës "Bulqiza" për të ardhur deri këtu.Unë i falenderoi ata gazetar profesionist dhe me kurajo të lartë dhe ju jap fjalën se si gjithmonë do të kenë mbështetjen time të madhe për ta bërë gazetën "Bulqiza" një zë të fuqishëm për banorët e atij qyteti të vogël jo vetëm këtu në Tiranë por kudo ku jetojnë dhe banojnë shqiptarët".Dhe në fund nga një gotë verë për të gjithë të pranishmit duke e tokur, duke ururar ditëlindjen e parë të gazetës "Bulqiza". Minutat e orët kaluan e vonë të pranishmit filluan të dalin nga salla, të gjithë dolën me një urim të përbashkët:"Edhe mbi njëqind vite gazeta "Bulqiza". Kështu të na mbledhësh ngahera!



Botuesi i gazetës Bulqiza Edmond Isaku (i pari majtas) dhe kryeredaktori i gazetës Halil Rama në një foto familjare.

Gazeta është zëri i qytetarëve të Bulqizës, të cilët kanë gjetur dhe do të gjejnë edhe në të ardhmen një portë të madhe ku do të trokasin për hallet dhe problemet e shumta".



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit
https://www.facebook.com/Rruga-e-Arb%C3%ABrit-259603234230025/

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën

RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print.

Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com

Abonimi vjetor kushton 600 lekë



KORABI NË SUPERLIGË, **ëndrra** e realizuar e dibranëve

Nga **Eduard ILNICA**

Futbolli shqiptar vitin e fundit ka kaluar nga surpriza në surprizë. Pas kualifikimit të Shqipërisë në Europian, pjesëmarrjes së Skënderbeut në grupet e Europa League, fitimit për herë të parë të Kupës së Shqipërisë nga Kukësi, një tjetër risi erdhi në fundin e këtij sezoni. Pas 55 vitesh, Korabi rikthehet mes më të mirëve të futbollit shqiptar, pra në Kategorinë Superiore. Një sukses që bëhet edhe më sugjestionues kur kujtojmë që vetëm një vit më parë ekipi dibran kishte siguruar ngjitjen në Kategorinë e Parë. Vështirësitë kanë qenë të shumta, por në fund është realizuar ëndrra e të gjithë dibranëve që të shohin ekipin e zemrës në majën e futbollit shqiptar.

Po si arriti të ngjitej Korabi në Superligë? Cili ishte çelësi i suksesit? Kush ishin faktorët që ndikuan direkt dhe indirekt në arritjen e objektivit madhor? Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, na duhet ta nisim rrugëtimin që nga Kategoria e Dytë në të Parën e pastaj në Superligë. Korabi i para dy sezoneve e nisi natyrshëm, por pas fitoreve të para, duke marrë plot 8 të tilla radhazi, u zgjua një ëndërr e kahershme për ngjitjen një kategori më sipër. Vetëm një barazim e ndal në javën e nëntë, i ligjshëm, sepse ndeshej me Partizanin B në Tiranë, ku në atë takim në përbërje ishin 5 lojtarë nga ekipi i parë I të kuqve. Për t'u mos u ndalur pastaj deri në fund, vetëm fitore, si jashtë, ashtu edhe brenda. Në ndeshjen e parafundit, pikërisht me Albpetrolin, Korabi ishte 4 pikë para ndjekësit më të afërt (Erzenit) dhe fitorja ndaj ekipit patosarak vulosi ngjitjen në të Parën. Ndeshja e fundit u luajt me të rinjtë dhe me ata që nuk kishin pasur shumë hapësira dhe për pasojë u humb, por ishte thjesht një ndeshje statistikore. Një ecuri vërtet mbresëlënëse, plot 22 fitore, një barazim dhe vetëm 1 humbje, plot 67 pikë, si rrallë ekip në futbollin shqiptar.

Kategoria e Parë ishte një terren tjetër për Korabin, me konkurrentë shumë më të fortë. Megjithatë, u krijua një grup simpatik lojtarësh, duke ardhur futbollistë me eksperiencë nga shumë qytete të Shqipërisë, nga Vlora, si Begaj dhe Bishaj, nga Korça erdhi Frashëri, nga Shkodra ishin më shumë, Guri, Jubani, Kiri e Pelinku më vonë, nga Tirana ishte Shazivari e Muçollari, nga Durrësi luajtën Mezini e Hoxha, pa harruar portierin Kotorri nga Elbasani apo Ramazanin nga Peqini. Natyrisht, shiriti i kapitenit do t'i takonte një dibrani dhe për këtë u zgjodh Sokol Mziu, që "dueloi" me dibranin tjetër Klodian Melanin. Ky ishte grupi pak a shumë, duke shtuar këtu edhe Karaj, Gjoka, Merdini, Vathi apo ndonjë tjetër, që dikush u largua në merkaton e dimrit, e dikush tjetër erdhi. Në krye të këtij grupi u përzgjodh trajner Dritan Mehmeti, me eksperiencë në këtë kategori, pasi më parë kishte drejtuar edhe Dinamon. Paralelisht edhe tifozët u riorganizuan dhe krijuan një tifo-grup, "Arbërit", të cilët do të ishin një mbështetje gjatë gjithë sezonit, një nga elementët që ndikuan në ngjitjen e Korabit në Superligë. Natyrisht, në fillim pakkush mendonte se Korabi do të rivalizonte me kundërshtarë, si Kastrioti, Besëlidhja apo ndonjë tjetër, që kishin bërë edhe merkato më të mirë, shto këtu edhe eksperiencën, të cilën ekipi dibran nuk e kishte. Kalendari i ndeshjeve nis me transfertën më të vështirë të mundshme, duke u përballur me Besëlidhjen, e cila për disa vite radhazi ka hedhur kandidaturën për t'u ngjitur në Superiore. Starti nis keq, ekipi dibran humb në Lezhë 1-0. Megjithatë, dy fitore radhazi, ndaj Adës dhe Ilirisë, menjëherë treguan se Korabi të paktën nuk është thjesht për mbijetesë. As humbja me Erzenin nuk e demoralizoi. Gjithsesi, ekipin dibran asnjë nuk e llogariti në llogoren e parë dhe kjo ndoshta luajti një rol pozitiv te Korabi, pasi nuk pati trysni në fazën e parë. Trajneri Mehmeti nga ndeshja në ndeshje filloi të lidhë shumë grupin, edhe pse ishte një kontigjent i limituar futbollistësh. Fundi i fazës së parë ishte mbresëlënës. Korabi merr katër fitore radhazi, duke "hequr qafe" edhe Kastriotin, por në startin e fazës së dytë edhe Besëlidhjen. Ishin pikërisht 2 fitoret me rivalët direktë ato që bënë të mundur edhe besimin e publikut dibran se ky ekip mund t'i dilte mbanë, duke realizuar ëndrrën 55-vjeçare, atë të ngjitjes në elitën e futbollit shqiptar. Heqja e 3 pikëve nga klasifikimi për Kastriotin i jep vendin e parë Korabit. Gjithsesi, dibranët bëjnë një hap fals, ndoshta më i paparashikueshmi, teksa Ada e frenon me rezultatin 0-0.

(vijon në faqen 15)

Po si arriti të ngjitej Korabi në Superligë?
Cili ishte çelësi i suksesit?
Kush ishin faktorët që ndikuan direkt dhe indirekt në arritjen e objektivit madhor?
Në fillim pakkush mendonte se Korabi do të rivalizonte me kundërshtarë, si Kastrioti, Besëlidhja apo ndonjë tjetër...

KORABI: Kampion, feston, BASHKON



Rruga e Arbrit dhe Stadiumi

Megjithëse festë, shqetësimi për të ardhmen e Korabit ndjehet. Ekipi do t'i luajë ndeshjet e ardhshme në superligë jashtë stadiumit, për shkak të mungesës të kritereve që duhen plotësuar.

Një stadium i ri është premtuar vazhdimisht, madje në këtë fushatë premtimesh është përfshirë edhe Presidenti i FSHF, Armando Duka, i cili e përsëriti premtimin gjatë një vizite muajin e kaluar në Peshkopi, së bashku me trajnerin e kombëtares, De Biazi.

"Dibra ka nevojë për mbështetjen e të gjithëve, veçmas për dy gjëra do të thoja Rrugën e Arbrit dhe një stadium", - tha Defrim Methasani, tashmë "Nderi i Dibrës". "Nuk e imagjinoj dot që gjithë ky qytet mos të ketë një stadium bashkëkohor, tani që është edhe në Superligë, por dhe një rrugë, një rrugë që të sjell më afër kryeqytetit, më afër realitet, më afër Europës, sepse Dibra e ka merituar prej kohësh Europën".

Të njëjtën çështje prek edhe trajneri Dritan Mehmeti. "Presidenti Armando Duka e premtoi një bashkëpunim për stadiumin e Korabit. Tani që jemi ndër dhjetë më të mirat e futbollit shqiptar, mendoj që duhet patjetër që ne të bëjmë të mundur edhe infrastrukturën. Së pari duhet stadiumi, por komuniteti dibran e meriton dhe Rrugën e Arbrit, sepse jeni një komunitet i jashtëzakonshëm, i urtë, i matur dhe i zgjuar".

Edhe qytetari i parë i Kamzës, Xhelal Mziu, e preku këtë çështje, duke bërë apel për qeveritarët për ta bërë "Rrugën e Arbrit", që tifozët të kenë mundësi për të shkuar më shpejt në Tiranë dhe qytete të tjera.

Shemsi Prençi ishte më i ashpër me zyrtarët lokalë dhe përfaqësuesit e Dibrës. "Pushtetarët vendorë duhet të fillojnë procedurën dhe negociatat me qeverinë shqiptare, të mos i lëmë asnjë ditë rehat, të bëhemi të bezdisshëm me këtë qeveri dhe me të gjithë qeveritë që do të vijnë ndër vite, që të fillojnë procedurat për stadiumin e Korabit. Nesër do të jetë vonë", - theksoi ai.

"Unë si një dibran, si njëri prej jush, do të bashkohem me ju edhe në protesta, në mënyrë që dibranët të marrin atë që meritojnë", - theksoi Prençi në fund të fjalës së tij. *B.K*

Më 21 maj, qindra sportdashës mbushën shkallët e Pallatit të Sportit "Bashkim Lala" për të festuar daljen e ekipit të futbollit të Korabit në kategorinë superiore.

Korabi ka shënuar një sukses të madh në dy vitet e fundit, duke ngjitur njëra pas tjetrës dy kategori, duke shënuar kështu një rekord më vete për sportin dibran.

"Që nga viti 1962, Korabi i Dibrës nuk e kishte prekur ëndrrën të luajë në kategorinë e elitës së futbollit shqiptar", - tha gjatë moderimit të veprimtarisë, gazetari sportiv Defrim Methasani, i cili së bashku me të bijën, Lunadën, gazetaren e re të njohur tashmë të Ora News, i dhanë veprimtarisë një shije të veçantë spektakli.

Surpriza e parë e kësaj mbrëmje ishte këndimi i Himnit Kombëtar nga tenori Kastriot Tusha.

"DIBRA ËSHTË SHUMË E VOGËL PËR T'U NDARË"

"Faleminderit futbollistëve të Korabit që na mblodhën në këtë festë, - tha Shemsi Prençi, një nga mbështetësit kryesorë të ekipit gjatë këtij sezoni, i cili përveç ndihmës së drejtpërdrejtë ka bërë të mundur edhe një koordinim të bizneseve për të pasur një mbështetje financiare të ekipit gjatë gjithë vitit. "Përulemi përpara Dibrës dhe Korabit, - tha ai, - pasi Dibra meriton më shumë. Prençi përshëndeti biznesmenët, qeveritarët, të cilët iu bashkuan motos "Korabi Bashkon", duke bërë të mundur që Korabi të dalë kampion dhe t'i bashkëngjitet elitës së futbollit shqiptar.

Prençi bëri një lidhje mes Dibrës dhe Shqipërisë, duke dëshmuar edhe anën historike në këtë lidhje. "Shqipëria është shumë e vogël për t'u ndarë, ndaj ekipi i Korabit duhet të kishte djem të talentuar nga gjithë Shqipëria për të përgatitur një ekip elitë, duke filluar nga trajneri Mehmeti, sulmuesi shkodran Guri, Frashëri nga Korça e plot të tjerë". Ai premtoi që Korabi duhet ngritur në standardet më të larta jo vetëm në futboll, por edhe në disiplinat e tjera sportive si ajo e mundjes, volejbollit, alpinizmit etj.

"QYTETAR NDERI" PËR EKIPIN E FUTBOLLIT TË DY SEZONEVE TË FUNDIT

Pas suksesit të dytë radhazi, Këshilli Bashkiak i Dibrës vendosi në mënyrë unanime që ekipit të Korabit në futboll t'i jepet titulli "Qytetar Nderi i Dibrës" me motivacionin "Për përfaqësim dinjitoz në ngritjen dhe lartësimin e futbollit dibran në superiore, duke i dhënë emër e famë Dibrës".

Të gjithë futbollistët u ngjitën në panel dhe morën medaljet që shoqëronin titullin dhe gjatë gjithë kësaj kohe thirrjet "Korab-Korab" mbushnin sallën. Me këtë rast, këngëtari Dritan Jashari prezantoi edhe këngën e re, një himn për Korabin, duke i dhënë spektaklit ngjyra festive.

"Falenderoj këshillin bashkiak për titullin, - tha në përshëndetjen e tij Sokol Muho, shefi i klubit, pasi ata me vendimin që kanë marrë, kanë vlerësuar punën e mirë ndër vite të futbollistëve, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre, në shi dhe me borë dhe dy vjet arritën që të kalojnë Korabin në kategori të parë dhe sot në Superiore".

Dritan Mehmeti, trajneri që çoi ekipin drejt fitores, falenderoi së pari kontribuesit e ekipit. "Naim Agollin, Selim Rusin, Musa Riçkun, Albert Laçin, Shemsi Prençin dhe gjithë donatorët e tjerë i falënderoj nga zemra, sepse në qoftë se nuk do të ishin kontributorët, nuk do të arrinim suksesin e ngjitjes në superiore".

Më pas ai falenderoi lojtarët e ekipit, të cilët me sjelljen profesionale gjatë seancave stërvitore dhe ndeshjeve zyrtare "kanë qenë të mrekullueshëm". "Jam shumë krenar, - tha Mehmeti, që i kam stërvitur përgjatë një viti të lodhshëm dhe nuk më kanë sjellë absolutisht asnjë shqetësim. Kemi vuajtur bashkërisht me ta dhe janë pjesa kryesore e këtij rezultati historik për Dibrën". Më pas, Mehmeti gjeti rastin të falenderonte edhe drejtorin teknik Telman Përleka, "i cili me qetësinë e tij, pavarësisht presioneve nga jashtë, krijoi të gjitha kushtet që të punonim të qetë".

Në fund, Mehmeti tha një falenderim zemre edhe për tifozët e mrekullueshëm të Korabit. "Pa tifozerinë nuk do ishim këtu ku jemi. Jeni të mrekullueshëm, jeni më të mirët, jeni tifozeri angleze!"

MIRËNJOHJE PËR DONATORËT

Tashmë është koha që kahjet të ndryshojnë: ekipi ka nevojë për financime të vazhdueshme, të garantuara. Dhe me mbështetjen e tifozerisë së saj të mrekullueshme do të arrijë të ketë sukses edhe mes elitës së futbollit shqiptar.

Nuk kishte si t'i mundonte këtij spektakli edhe mirënjohja për donatorët, të cilët, me mbështetjen financiare ndaj ekipit siguruan një bazë mbështetje ku stafi drejtues dhe lojtarët të zhvillonin një edicion të suksesshëm.

Me mirënjohje u vlerësuan biznesmenët Musa Riçku, Faik Bruçi, Bukurosh Koçi, Latif Miha, Flamur Ndreka, Rrahim Dedja, Fatmir Kurti, si dhe dy donatorët që jetojnë në Sh.B.A., dibranët Naim Agolli dhe Selim Rusi.

"Kjo është një ngjarje e rëndësishme për të gjithë dibranët në gjithë Shqipërinë dhe mbarë diasporën", - tha biznesmeni Faik Bruçi gjatë marrjes së mirënjohjes. "Unë falënderoj djemtë që dhanë një kontribut të çmuar, të cilët, edhe pse në kushte mjaft të vështira, me një infrastrukturë mjaft të vështirë, e arritën dhe realizuan qëllimin që i vunë vetes".

Bukurosh Koçi, një biznesmen i njohur në industrinë e kromit, tha gjatë përshëndetjes së tij se ne "do të bëjmë maksimumin që ta ndjekim vazhdimisht Korabin edhe në sukseset e ardhshme".

Latif Miha e krahasoi suksesin e Korabit me suksesin e Leicesterit në Angli, duke uruar që në edicionin e ardhshëm Korabit të shpallej edhe kampion në superiore.

Ish kryetari i bashkisë së Peshkopisë, Ilir Krosi, duke u dhënë mirënjohjen familjarëve të Naim Agollit, tha se "më vjen mirë për vlerësimin që Klubi i sportit Korabi i ka dhënë Naim Agollit. Familja Agolli është një familje me kontribute të njohura në qytetarinë dibrane dhe mirënjohjen e meritojnë plotësisht".

TIFOZËT DHE GAZETARËT, MBËSHTETJA E PAKURSYER PËR KORABIN

Dy grupimet e tifozëve, "Arbëri" të Peshkopisë dhe "Sokolat" e qytetit të Dibrës së Madhe, nga ana e tyre e kanë bashkuar Dibrën në një, pavarësisht kufirit. Ata janë së bashku gjatë ndeshjeve të ekipeve të Korabit, në Shqipëri dhe Maqedoni, duke dhuruar spektakël të pakrahasueshëm me tifozerinë e asnjë ekipi tjetër. Festat e tyre në stadium janë një shembull se si festohet dhe si mbështeten futbollistët në fushë. Pa këtë tifozeri, pavarësisht incidenteve në ndeshjen e parafundit ndaj Kastriotit, është e sigurt që ekipi nuk do ta kishte këtë sukses. Për gjithë këtë mbështetje dhe këtë atmosferë festive që krijojnë tifozët, Klubi "Korabi" i nderoi me "Mirënjohje".

Një nga ngjarjet e këtij sezoni të paharrueshëm për Korabin është edhe dhuna e ushtruar ndaj gazetarit Eduart Ilnica. Kur të gjithë opinioni publik iu turr Korabit dhe tifozerisë së saj për "dhunën e ushtruar" në Stadiumin e Peshkopisë, gazetari Ilnica, me guxim dhe profesionalizëm, tregoi me një kronikë të vërtetën e asaj që ndodhi. Dhe kur opinioni publik pa se si ishte kjo e vërtetë, ata që e mashtruan opinionin e humbën durimin dhe gjithë inatin e tyre kriminal e ushtruan ndaj gazetarit. Ndaj, nuk kishte se si në këtë ceremoni festive të mos nderohej me Mirënjohje, "Për kontributin e dhënë në mbështetje të ekipit të Korabit për arritjen historike të daljes në Superligë".

"Unë nuk jam vetëm gazetar, por jam edhe tifoz, - tha Ilnica. - I përkas grupit të "Arbrit" dhe si tifoz do të bëja aq sa kisha mundësi të bëja. Ndërsa si gazetar, bëra vetëm detyrën".

"QYTETAR NDERI" PËR GAZETARIN DEFRIM METHASANI

Një surprizë e kësaj mbrëmje ishte edhe shpallja "Qytetar Nderi të Dibrës" të gazetarit sportiv Defrim Methasani.

Lulzime Dani, kryetare e Këshillit Bashkiak të Dibrës, mjaft e emocionuar, i dorëzoi Methasanit titullin "Qytetar Nderi", me motivacionin: "Personalitet i spikatur dhe udhërrëfyes në udhëtimin e gazetarisë sportive, që me cilësi personale, njerëzore e sportive ngriti në nivelet më të larta sportin, emrin e ekipit të futbollit Klub Sport Korabi në Dibër e mbarë Shqipërinë, duke u bërë ambasador i denjë i Dibrës dhe misionar i sportit shqiptar". Ajo tha se ky vendim, si rrallëherë ishte marrë në mënyrë unanime.

"Kam marrë shumë urime, vlerësime e dekorime, por kur e merr tek "nana jote" nuk ka gjë më të bukur në botë, tek Dibra ime, tek Dibra e zemrës, tek dibranët e mi, të cilët sa të kem jetën do të mbetem borxhli", - tha mjaft i emocionuar Methasani.

Urimet për Methasanin dhe Korabin i dhanë edhe Donika Hyseni, prefekte në detyrë e Dibrës, Hajri Laçi, kryetari i Këshillit të Qarkut, Xhelal Mziu, kryetar i Bashkisë së Kamzës si dhe Albert Laçi, i cili ka luajtur në këtë sezon rolin e njërit nga bashkëpresidentët e ekipit.

PËRSHËNDETJE E MIQVE

Për të festuar me Korabin kishin udhëtuar nga Prishtina edhe gazetarët Milaim Krasniqi, Gani Kosumi dhe Sabush Selmani.

"Duke filluar nga viti 2006, të gjitha sukseset e shqiptarëve fillojnë me "K", tha gazetari i Radio Televizionit të Kosovës, Milaim Krasniqi. "Fillimisht fjala "Komb", pasta "Kosova", "Kombëtarja" dhe tani "Korabi", - tha Krasniqi. Ai falenderoi Dibrën për dyert e hapura për Kosovën.

Gazetari tjetër i ardhur nga Prishtina, Gani Kosumi, uroi ekipin e Korabit që të prezantohet denjësisht në kategorinë superiore. Ai shprehu dëshirën që në të ardhmen ndeshjet e Korabit në kategorinë superiore të transmetohen edhe në Radio Kosova dhe kjo gjë do të arrihet së shpejti, tha ai.

***

Korabi e mbylli sezonin në mënyrën më të mirë të mundshme. Ndërsa tani nis një fazë e re. Që ekipi të qëndrojë me dinjitet në Superligë ka nevojë për mbështetje.

Ndërsa deri më sot mbështetja morale ka qenë më e madhe se ajo financiare, tashmë është koha që kahjet të ndryshojnë: ekipi ka nevojë për financime të vazhdueshme, të garantuara. Dhe me mbështetjen e tifozerisë së saj të mrekullueshme do të arrijë të ketë sukses edhe mes elitës së futbollit shqiptar.

Bujar KAROSHI

Fotot: © ADNAN ELEZI

cyan magenta yelloë black



Mirënjohje Dibrës dhe dibranëve, të cilët më futën në "borxh" gjithë jetën! Këshilli bashkiak me votim unanim më nderoi me titullin më të lartë "QYTETAR NDERI I DIBRËS". Faleminderit këshilltarëve që më votuan, faleminderit Zot që më jep shëndet dhe jetë, të ec dhe të flas për vendin tim! Faleminderit miqve të shumtë që më shtojnë energjitë, faleminderit familjes, ku marr forcë dhe ekranit të RTSH, që ka qenë dritarja e promovimit të vlerave. Ju më dhatë vlerë, ndërsa unë do t'ju jap krenarinë e përjetshme. Ju më dhatë çmim, ndërsa unë do t'ju dua dhe punoj për ju pa çmim... Mirënjohje!

Sa të kem jetë do t'i mbetem **borxh Dibrës!**

Nga **Bujar KAROSHI**

Dhënia e titullit "Qytetar Nderi" për mësuesin, mikun dhe shokun tim, Defrim Methasani ishte një lajm i mirë. Ky titull për Defrimin është i merituar, është i vonuar, pasi jeta dhe puna e tij kanë qenë pazgjidhshmërisht të lidhura me Dibrën dhe krenarinë e saj.

Defrim Methasani ka qenë mësuesi im, si rrallëkush i pasionuar pas profesionit. E nis punën si mësues në Lurë në vitin 1984, kur ishte vetëm 20 vjeç. Më pas punoi në zona të thella si në Lunarë, Sllovë, Sohodoll. Kur ai erdhi mësues në Fushë Çidhën, ishte një djalosh 23-vjeçar, me plot dëshirë për punë dhe shumë pasion për sportin.

Në Fushë Çidhën ai bëri të pamundurën për organizimin e veprimtarive sportive jo vetëm në shkollë, por edhe në komunitet. Në vitin 1989 u organizua një nga veprimtaritë më të mëdha sportive në zonë, ku kishte një ndërthurje të të gjitha llojeve të sporteve; nga futbolli, volejbolli, hipizmi e deri të lojërat tradicionale popullore, etj. Veprimtaria ishte e paparë në atë kohë, jo vetëm në Dibër, por edhe në të gjithë vendin. Organi zyrtar "Zëri i Popullit" i kushtoi një speciale prej dy faqesh. Këtë veprimtari e risjell për lexuesit në këtë numër në një album fotografish të gazetarit Abdurahim Ashiku.

Defrimi ishte ndër të parët që e ndjeu se "provincat" sillnin mjedis mbytës për të talentuarit. Pas një përpjekje për t'u inkuadruar në Tiranë, u rikthye sërish në Peshkopi, por këtë radhë e degdisën në një shkollë 8-vjeçare, në Blliçe, për ta demoralizuar më shumë dhe për ta bërë të tërhiqej nga puna e mësuesit. Por, pavarësisht kësaj, brenda 6 muajve ai bëri që shkolla 8-vjeçare të fitonte spartakiadën, duke ngjallur xhelozira pa kuptim dhe të sillte veprime absurde. Ata që vendosnin në atë kohë për fatet e punësimit, votuan që Defrimi të hiqej nga sistemi arsimor. Por ndërsa në mëngjes e pushuan nga puna, në darkë u hap një fije shprese: Televizioni Shqiptar hapi një konkurs për gazetarë të rinj sportivë dhe në mesnatë ai niset drejt Tiranës, ndërsa pasditja e gjeti në Elbasan, duke përgatitur kronikën e ndeshjes Elbasani – Partizani.

"Ishim katër konkurrentë, - kujton Defrimi. - Disa gjetje artistike, një ndërthurje e lajmit sportiv me elemente humoristikë, e bënë kronikën interesante dhe në darkë ajo u transmetua në edicionin e lajmeve. Por të nesërmen, një letër nga zyrtarët lokalë të kohës e "denoncoi" punësimin e tij. Falë dashamirësisë së drejtuesve të televizionit, atij iu krijuan hapësira si bashkëpunëtor i jashtëm, pa rënë në sy të letërshkruesve.

Në këtë kohë për Defrimin nisi një epokë e re. U njoh me shumë miq, ngjalli respekt dhe besim, duke përfaqësuar vlerat më të mira dibrane, i krijoi hapësira vetes në të gjitha drejtimet.

Që nga viti 1992, për gjashtë vjet me radhë nuk e humbi asnjë ditë shpresën se puna e tij ishte në televizion. "Të bëhem gazetar sportiv ka qenë dëshira më e madhe", - tregon ai sot për profesionin e tij. Dhe në vitin 1998 filloi punë si gazetar i brendshëm në TVSH, punë të cilën e vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Si gazetar sportiv udhëtoi në të gjithë Shqipërinë. Përmes ekranit bëri të njohur sportistë të rinj e të talentuar, por solli edhe vlera të sportistëve të harruar. "Sporti i një qyteti" është një nga emisionet e tij, që i sjell vazhdimisht në ekran, ku ndërthuren harmonishëm historia, tradita dhe e reja e sportit nga qytete të ndryshme të vendit. Kudo ku ka shkuar ka zënë miq të rinj dhe ka prezantuar Dibrën në mënyrën më të mirë të mundshme. Me dokumentarët për figurat sportive nga Vlora në Korçë, nga Shkodra në Sarandë, nga Fieri në Rubik, në të gjithë Shqipërinë, ka bërë të paharrueshëm sportistë e talente, duke marrë prej tyre mirënjohje e vlerësime.

Nga puna e bërë me përkushtim dhe pasion nuk kanë munguar edhe rezultatet.

Në vitin 2004 u shpall si gazetari më i mirë sportiv nga Shoqata e Gazetarëve Sportivë "Anton Mazreku". Në vitin 2007 në TVSH u shpall si "Gazetari i vitit", me kronikën sportive më të mirë, ndërsa nuk kanë munguar tituj e mirënjohje nga qytete të ndryshme të vendit. Ndërsa Rubiku e ka nderuar vazhdimisht si njeriun e vitit në këtë qytet.

Shumë prej investimeve sportive në këtë qytet janë krijuar falë mundësive përmes lobimit të Defrimi te miqtë e tij biznesmenë apo organizatat të ndryshme që të realizohen. Mes të cilave është stadiumi dhe fusha e basketbollit. Po ashtu edhe në Pukë, etj.

Çmime dhe vlerësime ka marrë edhe nga federatat e basketbollit, volejbollit, mundjes, xhudos, ping-pongut.

Defrimi është ideatori I kupës "Panajot Pano", i cili këtë vit zhvilloi edicionin e 7-të. më parë kishte botuar librin "Pano, mbreti i Golit" (1996) dhe kishte realizuar dokumentarin për Panajot Panon në 70-vjetorin e lindjes. Kjo kupë bashkon çdo vit gazetarë sportivë nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria. Në dy edicionet e fundit kanë bërë pjesë edhe gazetarët e radios gjermane Deuche Ëelle, duke i dhënë veprimtarisë përmasa ndërkombëtare.

KONTRIBUTE PËR DIBRËN

Defrimi kudo ku ka shkuar dhe gjatë gjithë punës së tij, Dibrën e ka pasur me vete. Defrimi nuk gjendet vetëm në Dibër: e gjen në të katër anët e vendit, por Dibra është pika e dobët. Dokumentarin e parë për sportin dibran e kreu në vitin 1994-1995, për futbollistin e njohur të viteve '80-'90, Shpëtim Toska. Më pas, një sërë veprimtarish sportive me në qendër Dibrën dhe



personalitete dibranë të sportit kanë qenë objektiv i punës së tij. Organizimi i 20- vjetorit të volejbollit dibran, ceremonia e laurimit të sportistit Taxhedin Shehu, ish trajnerit të atletikës Rexhep Zebi, ish shefit të Klubit Sabri Abdiu (pas vdekjes), realizimi i dokumentarit "Një mal i sportit dibran", kushtuar trajnerit të volejbollit Bashkim Lala e shumë e shumë të tjerë.

Por ajo që do të ngelet në memorien e të gjithëve është organizimi i 75-vjetorit e Klubit Korabi, në bashkëpunim me ish drejtuesin e klubit Haki Duken dhe me mbështetjen financiare të dibranëve të tjerë të nderuar si Musa Riçku, Muhamet Bitri, Rakip Sulit e shumë të tjerë.

Vlerësimi dhe promovimi i sportistëve dibranë në mënyrë vullnetare ka qenë gjithmonë i pranishëm në punën e tij. Mahir Halili, ish futbollisti i Kombëtares, është promovimi i parë i një dibrani në fillim me Tiranën, Dinamon, Kastriotin pastaj në Zvicër e Turqi. Sukseset e talenteve të boksit, të vëllezërve Keta u bënë të njohura mediatikisht së pari nga puna dhe përkushtimi I Defrimit. Por, sidomos gjatë dy sezoneve të fundit të ekipit Korabi, ai ka dhënë një mbështetje të fuqishme morale dhe mediatike, duke e bërë Korabin të njohur për sportdashësit në të gjithë Shqipërinë. Ai ka qenë një lobues i fuqishëm pranë FSHF në mënyrë që Dibra të ketë vëmendjen e duhur në futboll. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe për sporte e tjera, volejbollin, mundjen, alpinizmin, qitjen etj.

Por puna si gazetar, krahas gjërave të bukura që sjell, ka edhe momente të vështira. Dhe nuk mund të harrohen për shikuesin momentet e ndeshjes së kombëtares në Beograd, ku Defrimi ishte I vetëm në fushë si përcjellësi i lajmit direkt nga terreni. Ai "u harrua" bashkë me kameramanin atje dhe u kthye nga Beogradi disa ditë më vonë, i shoqëruar nga policia vendase deri në kufirin me Maqedoninë.

NJERI HUMAN

Krahas punës si gazetar sportiv, Defrimi nuk ka lënë mënjanë angazhimet në veprimtaritë e shoqërisë civile. Është një nga mbështetësit e parë të idesë së Rrugës së Arbrit dhe, së bashku me kolegun Bajram Hoxha në TVSH kanë realizuar një dokumentar për këtë qëllim (2012). Po ashtu, ai është I gjendshëm çdo herë, kur autorë apo personalitete dibrane organizojnë veprimtari në kryeqytet, Dibër të Madhe apo Peshkopi.

Ndihmat e tij humanitare nuk kanë munguar dhe gjithmonë kanë qenë larg syrit të publikut, por ajo që e njohu publikisht, ishte rasti i mbesës së tij, Ambrës. Me ndihmën e vëllezërve Keta fillimisht, ai mori një iniciativë shumë të vështirë për të mbledhur fonde për sëmundjen e saj, duke bërë atë punë që për shumëkënd ishte e parealizueshme. Një fushatë mediatike në televizione, rrjetet sociale apo takime direkte, i dha një dimension të ri veprimtarisë së tij civile. "Një fitore e jetës" e cilëson ai këtë rast."Ne luftuam për të dhe ajo ia doli, duke treguar se kur jemi bashkë, të gjithë ia dalim".

Defrimit nuk i kishte shkuar mendja se një nderim për të do të bëhej në Pallatin e Sportit "Bashkim Lala", emër i cili iu vu me propozimin e tij, madje edhe germat u vendosën me ndikimin e tij dhe falë dashamirësisë së mikut të tij, Bujar Gjapit.

Më 22 maj 2016, kur kryetarja e Këshillit bashkiak lexoi motivacionin, e gjithë salla u ngrit në këmbë, që tregonte se dekorimi i tij ishte një dekorim i merituar. Sepse Defrim Methasani e meriton plotësisht titullin "Qytetar Nderi i Dibrës".

"Dua të falënderoj të gjithë ata që e firmosën këtë vendim. Qëllimi im ka qenë gjithmonë promovimi i Dibrës. Ëndrra ime ka qenë Korabi në elitën e futbollit shqiptar dhe për këtë, së paku në dy sezonet e fundit, kemi punuar ngushtë me zotin Fehmi Mziu, Ilir Krosi, Sabri Laçi, Musa Riçku, Albert Laçi, Shemsi Prençi, Faik Bruçi, Latif Miha, Bukurosh Koçi, Flamur Ndreka, Fatmir Kurti e shumë e shumë të tjerë. Ai veçon mikun e tij Musa Riçku, edhe ky i shpallur para pak muajsh "Qytetar Nderi i Dibrës", i cili "në këtë maratonë humaniste në shërbim të Korabit, nuk tha asnjëherë Jo, për të bërë gjithçka në shërbim të vlerave të futbollit dibran".

"Unë ndjehem i emocionuar, por nderi që më është bërë mua është nder për lojtarët, trajnerët, anëtarët e stafit të Korabit, njerëzit e medias, biznesmenët dhe tifozët, të gjithë së bashku ia arritëm që sot të kemi një Korab të madh të ëndrrës sonë të përbashkët", - tha ai i emocionuar para publikut dibran."

***

Defrim Methasani është Qytetar Nderi më i riu në Dibër, por prej sot ai mban mbi vete më shumë përgjegjësi, për të mbajtur lart emrin e tij, të familjes dhe gjithë Dibrës.



Defrim Methasani është Qytetar Nderi më i riu në Dibër, por prej sot ai mban mbi vete më shumë përgjegjësi, për të mbajtur lart emrin e tij, të familjes dhe gjithë Dibrës.

Fotoreportazh / Udhëtim në kohë

Dëfrim Methasani, mësues në Fushë-Çidhën...

Dëfrim Methasanin e njoh herët.

E njoh nëpërmjet babait të tij, Shuapit në udhëtimet e bukura bjeshkëve të Korabit.

E njoh kur ishte mësues në Lurë e firma e tij mbushte në çdo numër faqe të gazetës "Ushtima e maleve".

E njoh edhe mësues në shkollën e mesme të Fushë-Çidhnës, ndër të tjera edhe në një festë popullore me nxënësit e tij në cekat e Drinit, aty ku takohet Seta me lumin që përshkon tej e tej tërë gjatësinë e Luginës së Dibrës...

Dëfrim Methasanin e njeh tërë Shqipëria. Madje edhe më gjerë. Ai është kudo, me zë e figurë, një veprimtar i madh jo vetëm i sportit...

Dëfrim Methasanin po e përcjell mes nxënësve të tij më se 30 vjet më parë me disa fotografi nga arkivi fotografik i jetës sime...

Nxënësit e Dëfrimit janë rritur, kanë mbaruar shkolla të larta, kanë lindur fëmijë e ndoshta janë bërë gjyshër. Shpresoj që çdonjëri të gjej vetveten e të kujtojë sa e bukur ishte jeta me mësues Dëfrimin...

Abdurahim Ashiku
Athinë 18 maj 2016


1


2


3

Foto:
1. Me futbollistët e rinj
2. Hipizëm
3. Lojna popullore dibrane
4. Buzë Drinit
5. Volejboll në shkollë
6/7. Si ta hedhim gjylen?


4


5


6


7

sport

(vijon nga faqja 11)

Korabi nuk demoralizohet, përkundrazi, fiton 4 ndeshje radhazi dhe shkon në Krujë për t'u përballur me Kastriotin si kryesues. Arrin të marrë një barazim shumë me vlera, teksa edhe Besëlidhja humb ndaj Erzenit. Fiton edhe me Mamurrasin, por në ndeshjen e fundit të fazës së dytë, që përcaktonte edhe kalendarin e fazës së tretë, kur e gjithë Dibra priste fitoren në Kamzë, Korabi humb 0-3, humbja më e thellë e sezonit. Ishte pikërisht kjo disfatë që e zbret në vend të tretë dhe shanset zbehen, pasi edhe kalendari tashmë ishte në favor të dy rivalëve, Besëlidhjes dhe Kastriotit. Dibranët rikthehen te fitorja me Ilirinë në shtëpi, por bëjnë një tjetër hap fals me humbje, kësaj here në transfertë me Burrelin. Kjo humbje demoralizon jo vetëm ekipin dhe tifozërinë, por edhe trajnerin Mehmeti, që jep dorëheqjen. Ishte pikërisht tifozëria që me këmbënguljen e tyre rikthejnë në stol teknikun, duke pasur besim absolut tek ai, që në fund ua shpërblen më së miri.

Fundi i sezonit ishte vërtet shpërthyes. Pas dorëheqjes së Femi Mëziut, në skenë ridel donatori kryesor Albert Laçi, i cili së bashku me disa donatorë të tjerë, duke pasur edhe kontributin e çmuar nga Amerika të Selim Rusit dhe Naim Agollit, krijuan një bord drejtues, ku Shemsi Prençi u zgjodh kryetar. Ekipit iu sigurua mbështetja financiare, ku nuk munguan edhe premiot e majme. Korabi i fiton të shtatë ndeshjet e fundit, ndërsa rivalët gabojnë, së pari Kastrioti në Burrel e më pas Besëlidhja me Erzenin. Natyrisht, ndeshja më kryesore dhe si të thuash ajo që përcaktoi fatin e Korabit, ishte përballja me Kastriotin në Peshkopi, ku u vendos një rekord për në Grupin e Veriut sa i përket tifozërisë në stadium. Afro 10 mijë vetë nga e gjithë Dibra, por edhe nga Dibra e Madhe me "Sokolat" në krye, apo edhe nga qytete të tjera kishin ardhur tifozë dibranë. Një presion i jashtëzakonshëm për ekipin, por ishte Guri ai që vendosi me supergol fatin e takimit, duke ngritur peshë jo vetëm tifozët në stadium, por edhe mijëra e mijëra të tjerë që e ndiqnin në radio apo përmes rrjeteve sociale jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë Europën, madje deri në Amerikë. Por pas përfundimit të takimit, ndodhi një nga incidentet më të këqija në historinë e Korabit. Edhe pse e provokuar, tifozëria e Korabit kaloi çdo normë, që përveç hyrjes në fushën e lojës, sulmoi lojtarët e ekipit kundërshtar. Mungesa e eksperiencës bëri të veten, por ishte e pafalshme. Histeria e turmës ishte e frikshme, pasi lëndimet mund të kishin qenë tragjike. Pikërisht për këtë stadium i Korabit është i dënuar 1 vit.



ECURIA E KORABIT NË KATEGORINË E DYTË

Sukthi – Korabi	1-2
Korabi – Shënkolli	2-0
Luzi – Korabi	0-1
Korabi – Tirana B	2-0
Olimpik – Korabi	0-1
Korabi – Domosdova	2-0
Skrapari – Korabi	0-1
Korabi – Teuta B	1-0
Partizani B – Korabi	0-0
Korabi – Vora	1-0
Albpetrol – Korabi	1-0
Korabi – Erzeni	1-0
Korabi – Sukthi	3-0
Shënkolli – Korabi	1-2
Korabi – Luzi	2-1
Tirana B – Korabi	1-2
Korabi – Olimpik	5-1
Domosdova – Korabi	0-1
Korabi – Skrapari	4-2
Teuta B – Korabi	0-2
Korabi – Partizani B	1-0
Vora – Korabi	1-3
Korabi – Albpetrol	3-0
Erzeni – Korabi	3-0

Bilanci: 22 fitore,
1 barazim, 1 humbje (45-12)

ECURIA E KORABIT NË KATEGORINË E PARË

Besëlidhja – Korabi	1-0
Korabi – Ada	3-1
Iliria – Korabi	0-1
Erzeni – Korabi	1-0
Korabi – Burreli	3-0
Besa – Korabi	2-0
Korabi – Kastrioti	1-0
Mamurrasi – Korabi	0-2
Korabi – Kamza	2-0
Korabi – Besëlidhja	2-0
Ada – Korabi	0-0
Korabi – Iliria	3-1
Korabi – Erzeni	2-0
Burreli – Korabi	0-1
Korabi – Besa	4-0
Kastrioti – Korabi	1-1
Korabi – Mamurrasi	1-0
Kamza – Korabi	3-0
Korabi – Iliria	2-0
Burreli – Korabi	1-0
Korabi – Besa	1-0
Kamza – Korabi	3-4
Korabi – Erzeni	3-1
Korabi – Mamurrasi	2-0
Besëlidhja – Korabi	1-3
Korabi – Kastrioti	1-0
Ada – Korabi	0-1

Bilanci: 20 fitore,
2 barazime, 5 humbje (43-16)

Ndeshja e fundit, që kurorëzoi ngjitjen e Korabit në Superligë, ishte ajo ndaj Adës në Shkodër. Tifozët dibranë kishin "pushtuar" Shkodrën dhe Bishaj ngre peshë "Reshit Rusin" me golin e tij, që realizon ëndrrën 55-vjeçare të dibranëve. Po të bëjmë një bilanc, Korabi mori 20 fitore, 2 barazime dhe 5 humbje. Natyrisht, jo si në Kategorinë e Dytë, por nga ana tjetër ekipi dibran mban një rekord në futbollin shqiptar, për 2 vjet në stadiumin e Peshkopisë ka vetëm fitore, asnjë pikë të lënë. Asnjë ekip në Shqipëri nuk e ka këtë ecuri fantastike në fushën e tij. Plot 26 fitore radhazi në fushën e Peshkopisë, 12 në Kategorinë e Dytë dhe 14 në Kategorinë e Parë. Por edhe pse për dy vite radhazi Korabi është shpallur kampion në dy kategori në Grupin e Veriut, në finale me fituesit e Jugut nuk ka arritur të fitojë. Një vit më parë humbi me Gramshin 1-3, ndërsa këtë vit, edhe pse bëri një ndeshje fantastike, nga "ruleta" e penalltive, pas 24 të tilla, nga 12 për skuadër, Korabi nuk arriti t'ia dilte. Gjithsesi, Këshilli Bashkiak Dibër vendosi t'i japë titullin "Qytetar Nderi" ekipit të Korabit, duke e lartësuar edhe më shumë emrin e futbollit dibran, që duke nisur nga fundi i muajit gusht, do të luajë në elitën e futbollit dibran. Ëndrra u realizua, një mision edhe më i vështirë e pret ekipin e Korabit, por ndoshta një tjetër ëndërr do lindë…Kurrë mos thuaj kurrë! Korabi ka bashkuar shumë njerëz dhe ndoshta ky bashkim mund t'i japë të tjerë suksese, duke ndjekur shembullin e Kukësit, Leicesterit apo ndonjë ekipi tjetër.







Pamje nga ndeshja Korabi-Kastrioti e cila, pas mbarimit te ndeshjes u kthye ne nje arene dhune mes tifozeve. Keta tifoze te Korabit e meritonin superligen dhe dhuna nuk ka lidhje me ta. Foto: Neki Feta

Dhuna në futboll **nuk e nderon Dibrën**

Nga **Dionis XHAFA**

Dhuna në shoqërinë shqiptare ka përhapje të gjerë dhe në shumë fusha të jetës. Ajo është e pranishme jo vetëm në rrugë, por edhe në stadiume në fakt duhej të luhej futboll dhe të kishte argëtim. Realitet që njihet më së miri është ai se këtu në ndeshje të kampionatit tonë kombëtar apo dhe inferior, zihen gjyqtarë, trajnerë, futbollistë dhe tifozë. Dihet se këtu gjyqtari shahet edhe nga motra e duhet pas kësaj një deklaratë qesharake si ajo se "arbitri nuk ka motër". Dihet po ashtu se futbolli luhet në kushte dramatike e këtu mjaft të kujtojmë faktin se një portier i skuadrës së Burrelit ca vite më parë e la futbollin dhe iku të punonte si emigrant në Greqi. Kjo sepse këtu rroga e tij në atë kohë ishte në nivel tepër qesharak, vetëm 150 mijë lekë të vjetra. Së fundmi një gjyqtar i Kategorisë Superiore iku sepse i doli Llotaria Amerikane. Gjithsesi po rikthehem tek dhuna në stadiumet tona. Dhuna nëpër stadiumet e këtij vendi nuk ka munguar qysh kur ka aguar demokracia jonë. Fillimisht zhvillimet sociale dhe politike ishin të tilla që dhuna ishte në përmasa të konsiderueshme. Kur u duk se filluam të mësojmë diçka nga fillimet gjakësore dhe rrokopujë të demokracisë sonë, dhuna u risoll fuqishëm nëpër stadiume. Fillimisht rasti i paprecedent u shënua në ndeshjen Tirana – Partizani ku pas derbit kryeqytetas shpërthyen edhe grushtat. Më vonë sherr i dendur ndodhi edhe në ndeshjen Pogradeci – Luftëtari ku dy ekipet luanin fort për vendin e parë në Grupin e Jugut të Kategorisë së Parë. Në Pogradec ndodhi një sherr i madh ku hyn në fushë trajnerë, drejtues klubi dhe tifozë vendas. Tjetër rast dramatik ishte humbja e jetës së një tifozi në Vlorë ku po luante Flamurtari. Dhe kjo dhunë u shfaq edhe në ndeshjen Korabi – Kastrioti në Peshkopi. Dhuna që lidhet me Korabin nuk ishte veç në Peshkopi, por edhe më komplekse se kaq. Le të ndalemi pra tek dhuna dhe kjo e parë në tërësi tek klubi sportiv Korabi.

DHUNA NË KORABI – KASTRIOTI

Fillimisht duhet thënë se Korabi fitoi në Peshkopi një ndeshje me shumë rëndësi pasi fill një javë më vonë u ngjit zyrtarisht në Superiore. Ekipi që përfaqëson Dibrën mund të na nderojë në kategorinë më kryesore në vend, pra. Kjo ndodh pasi mbi Korabin, për të thënë të vërtetën është ushtruar presion dhe represion derisa edhe presidentin e klubit në Tiranë e kërcënuan me jetë. Gjithashtu u raportua se në ndeshjen kundër Kastriotit, krutanët provokuan. Pavarësisht këtyre fakteve e sidomos i pari që e kam përmendur, sërish fitorja në Peshkopi duhej gëzuar dhe jo të përdorej dhuna si mjet. Sepse vetiu shtrohet pyetja: Për çfarë duhet dhuna pasi e ke fituar ndeshjen me rezultatin minimal 1:0? Ku do ta çosh këtë dhunë? Përse duhet të dhunosh lojtarët e ekipit tjetër kur e fitove ndeshjen dhe se më tej i kishe shanset e mira për tu ngjitur në Superiore. Pse? E pra duket paksa kontraversale që fill pasi e fiton ndeshjen, tifozët e Korabit përdorën dhunë derisa lojtarët mysafirë i mbyllën edhe në dhomat e zhveshjes. Pse more, kështu pritet miku duke e dhunuar? E di se me këto veprime përpos se mund ta dëmtosh ekipin e Korabit, nga ana tjetër i jep imazh negativ Shqipërisë? Shkurt, dhuna pas ndeshjes nuk duhej asesi. Dhunën pasi ke fituar mund ta shpjegoj vetëm me psikologjinë histerike të turmës, ku të gjithë "marrin flakë" veç nga një ndodhi. Por se e tillë dhunë kurrsesi nuk është e duhura dhe nuk duhet toleruar në futboll.

DHUNA MBI GAZETARIN SPORTIV EDUARD ILNICA

Sa duket "lufta" mes Korabit dhe Kastriotit për atë se cili ekip do ta fitojë kampionatin në Grupin e Veriut është tepër e ashpër. Duket sikur për këtë vend të parë eksponentë të ekipeve bënin çdo gjë, deri edhe veprime që bien ndesh me ligjin. Nisi gjithçka me atentatin kundër një drejtuesi të Korabit, presidentit Fehmi Mëziu. Ky i fundit nga presioni dha dorëheqjen dhe u duk se Korabi u fundos. Fill pas dorëheqjes së Mëziut, Korabi humbi me Kamzën krejt "papritur", ekip ky më inferior se ai i Peshkopisë. Por se me ngadalë ekipi dibran u ngjit sërish. Ekipi nga Peshkopia fitoi një ndeshje me shumë rëndësi kundër Kastriotit dhe këtu u ushtrua dhunë.

Rasti më i tmerrshëm ishte ai se pas fitores së Korabit, në Tiranë pranë "Zogut të Zi" u godit gazetari Eduard Ilnica nga presidenti i krutanëve Alban Vogli. Ilnica rrëfeu se madje kishin dashur deri ta eliminonin fizikisht, a thua se kishte kryer ndonjë krim të rëndë. Ngjarja ishte e bujshme dhe me rastin u mor gjykata duke e proceduar penalisht Voglin. Rasti kundër gazetarit sportiv Ilnica duket sikur të thotë se futbolli në këtë vend nuk luhet në fushë, por me goditje fizike ku përdoret edhe thika. Kjo është e papranueshme për sportin në radhë të parë, dhe duhet të jetë aspak normale për drejtuesit e ekipeve në radhë të dytë. Dhuna duhet eliminuar dhe gara në futboll të jetë demokratike. Madje nëse kundërshtari e fiton ndeshjen duhet uruar sepse me ndershmëri u tregua më i fortë se ty! Por se kulturë e tillë fatkeqësisht mungon.

Reagim i redaksisë së gazetës "Rruga e Arbërit" ndaj dhunës së ushtruar ndaj gazetarit Eduard Ilnica

Disa persona kanë ushtruar dhunë ndaj gazetarit Eduard Ilnica pas ndeshjes Korabi-Kastrioti. Sipas policisë, dhuna erdhi pas kronikës televizive të gazetarit të Telesport, ku fliste për dhunën në ndeshjen në Peshkopi. Kronika e tij pasqyroi të vërtetën e asaj që kishte ndodhur në stadiumin e Peshkopisë, dhe kjo nuk u pëlqeu disa personave të lidhur me interesa të caktuara në kategorinë e Parë.

Redaksia e dënon dhunën ndaj kolegut, bashkëpunëtorit dhe mikut tonë, dhe dëshirojmë që organet ligjvënëse të vendosin sa më shpejt drejtësinë.

Askush në këtë vend nuk ka të drejtë ta gjejë të drejtën përmes kërcënimeve dhe grushteve. Ekipi i Korabit mori një fitore të merituar në Peshkopi dhe dhuna pas ndeshjes nuk është në nderin e askujt. Dhe për këtë, Komisioni i Disiplinës pranë FSHF dha një vendim të drejtë.

Të kërkosh fitoren përmes dhunës, kërcënimeve dhe shantazheve është kriminale dhe nuk ka të bëjë me futbollin!

Redaksia i uron gazetarit Ilnica shërim të shpejtë dhe qëndron pranë tij në këto ditë të vështira!

Dhunimi i gazetarëve në detyrë dhe dhunimi i tifozëve apo lojtarëve, është një akt i dënueshëm, që përveç "dënimit" nga opinion qytetar, duhet të marrë edhe ndëshkimin ligjor.

Dhuna duhet eliminuar dhe gara në futboll të jetë demokratike. Madje nëse kundërshtari e fiton ndeshjen, duhet uruar, sepse me ndershmëri u tregua më i fortë se ty!

portret

TAHIR SKEJA, një valltar që do të mbahet mend gjatë



Tahir Skeja lindi me 8 tetor 1944, ne fshatin Ploshtan, Kala e Dodes Diber. Ai vjen nga një familje patriotësh që nuk ju ndal pushka, e megjithatë krahas dëshirës për të luftuar, ai kishte edhe shpirt artistik. Familja e tij përbëhej 8 persona. Kishte dy prindër të mrekullueshëm, dy vëllezër më të mëdhenj dhe tre motra me të cilat kishte marrëdhënie shumë të mira. Bazat e para të arsimimit i filloi në vitin 1950 në vendlindje. Ai, së bashku me moshatarët e tij merrnin njohuritë e para në një ndërtesë që sot është kthyer në shtëpinë e Baftjar Skejës. Kohët ishin të varfëra, ekonomia gjithashtu. Kjo ishte arsyeja që në vitin 1954, babai i tij Rrahimi i ndërpret shkollën. Edhe pse ishte thjesht një fëmijë, ai kishte vizione krejt të ndryshme nga të tjerët qofshin ata edhe më të rriturit. Që i ri ai u bë krah i babait dhe vëllezërve. Filloi punë si kamarier në rrethin e Pukës, fshati Miliskaj. Pas disa kohësh ai ndërron vend nga Puka për t'u zhvendosur në Elbasan, në fshatin Lepush Breshkë. Në vitin 1964, i vjen fletë-thirrja për ushtar. Detyrimin ushtarak e kreu për dy vite në Berat. Në 1966 u emërua brigadier në Fabrikën e Çimentos në Fushë-Krujë për rreth një vit. Pas vitit 1970 filloi punë në Kooperativë e më pas u zhvendos në Peshkopi për të kryer një kurs 6 mujor për berber. Filloi punë si berber në fshatin Ceren. Dukej sikur "Ylli i Artit" po e udhëhiqte drejt një rruge për të hapur horizontin e tij drejt një të ardhmeje artistike. Kjo, pasi ai arriti të plotësonte dëshirën dhe pasionin e tij për t'u futur në grupin artistik të fshatit që më pas do të prezantoheshin edhe në Ansamblin e famshëm të Këngëve dhe Valleve. Djemtë dhe vajzat e reja kërkoheshin si vullnetarë dhe kjo ishte një fije shprese për Tahirin, që ai të mund të bënte realitet ëndrrën e tij. Ai arriti të përzgjidhej si një ndër më të talentuarit dhe ju bashkangjit grupit që do të përfaqësonte rrethin e Dibrës në Festivalin e përvitshëm të Gjirokastrës. Debutimin e parë e kishte si këngëtar së bashku me Aziz dhe Liljana Ndreun në "Sofrën Dibrane". Në këtë festival do të ndryshonte rrënjësisht jeta e tij, pasi aty në vitin 1972 njohu edhe vajzën e cila i rrëmbeu zemrën dhe do të bëhej shoqëruesja e tij për gjithë jetën. Kështu në vitin 1973 ai u martua me zonjën Lutfie, e cila gjithashtu ishte një valltare. U shpërngul në fshatin e tij të lindjes, Ploshtan. Aty ndërtoi shtëpinë e tij dhe thuri ëndrrat për të krijuar familje. Ndërkohë që ngjiste shkallët e karrierës, ju dha mundësia që të merrte pjesë në përfaqësimin që "Sofra Dibrane" do të bënte në Ohër. Ishte një ngjarje historike për artin dhe artistët dibranë si dhe për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve. Kështu, në vitet 1974-1975 mes emrash të mëdhenj si Dali Hoxha, Vera Laçi, Liri Rasha, Qerim Sula, Sajo Poleshi, Fitie Ndreu, Skënder Cala si dhe kompozitori Përparim Tomçini, debutoi denjësisht në Ohër duke finalizuar ëndrrën e tij për të qenë një emër që do të mbahej mend gjatë. Gjatë prezantimit të performancave, grupi u dekorua me Fleta Lavdërimi si "Valltarë me shumë talent". Gjatë këtyre viteve ai krijoi një familje. U bë babai i dy vajzave dhe dy djemve. Ndërkohë që ishte i përfshirë në aktivitetet e Ansamblit, punonte edhe si berber. Me ardhjen e demokracisë u detyrua ta ndërpriste aktivitetin e tij si valltar, si rezultat i ndryshimeve të sistemit dhe gjendjes në vend. Pjesën tjetër të jetës e kaloi në fshat duke u marrë me punët që ai ofronte dhe duke rritur fëmijët e tij. Në shkurt të vitit 2003 u prek nga kanceri në mushkëri që i kushtoi edhe jetën në 26 prill të po këtij viti.

Jeta e tij nuk ishte e gjate, por kontributi që dha në jetën kulturore të vendit ishte shumë e çmuar. Ai nuk mbahet mend vetëm nga familjarët e tij që ndihen krenarë për të, por edhe nga artistë e njohës të artit që ruajnë të paprekur kujtimin e tij. Do të mbahet mend ndër breza si një njeri i mirë dhe një artist plot vlera.

Hamdi Skeja

mundje

Mundja, sporti që nderon Gollobordën

Më 19 maj 2016, në praninë e qindra banorëve, nën një atmosferë feste e dasme, nën tingujt e lodrës e culës, në Ostren u mbaj "Kupa e 5-të e Mundjes Tradicionale të Gollobordës".

Në këtë veprimtari sportive të veçantë morën pjesë veteranë të mundjes tradicionale shqiptare nga të gjithë fshatrat e krahinës së Gollobordës, bashkia Bulqizë, qarku Dibër si dhe nderuan me pjesëmarrjen e tyre kampionë të mundjes, mjeshtra sporti dhe mjeshtra të meritуar të sportit burrëror të mundjes.

Kjo veprimtari u organizua nga Shoqata Kombëtare e Mundjes e Shqiptare, Bashkia Bulqizë dhe Shoqata Sportive "Golloborda". Përmes kësaj veprimtarie objektivat ishin për të vlerësuar, prezantuar dhe çuar më tej traditën kombëtare, shekullore të popullit të Dibrës dhe në veçanti të kësaj zone me tradita atdhetare, kulturore e sportive dhe shumë punëtore.

"Tradita shekullore e mundjes shqiptare, sot po paraqitet me madhështi në Dibër dhe në zonën e Gollobordës, duke evidentuar vlerat historike, shekullore, kulturore e sportive të kombit shqiptar, - thotë Xhelil Cibaku, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Kombëtare të Mundjes Shqiptare.

"Për traditën kombëtare shqiptare të mundjes tradicionale në Gollobordë flet fakti që ndeshjet e mundjes, si në dasma dhe festa popullore zhvillohen në praninë e Bajrakut dhe Flamurit Shqiptar. Mundja popullore, tradicionale e krahinës së Gollobordës ka lindur shekuj më parë, duke u kultivuar në vazhdimësi në rastet e festave popullore dhe dasmave e gëzimeve në të gjithë fshatrat", - thekson Cibaku.

Mundja popullore në Dibër, në fshatrat e Gollobordës dhe në disa treva të tjera të Shqipërisë, Kosovës e të shqiptarëve të Maqedonisë po rigjallërohet, si për të treguar historinë, trimërinë, traditën, kulturën e popullit tonë të fortë dhe vital, por edhe për të dëshmuar dëshirën e nxënësve, të rinjve dhe burrave për të zhvilluar gara sportive - mundje popullore në festa popullore, në dasma dhe aktivitete shkollore.

"Sot do të evidentojmë historinë dhe traditën e mundjes popullore, nëpërmjet historikut të saj, kujtimeve dhe veçanërisht të Ekspozitës Fotografike, për veteranët, pjesëmarrësit në garat e mundjes popullore për çdo fshat, për kampionët kombëtarë dhe mjeshtrat e sportit shqiptar nga Golloborda", - tha Cibaku gjatë fjalës së hapjes në Edicionin e 5-të të Mundjes në Gollobordë.

Në këtë veprimtari u nderuan disa personalitete të sportit dibran, disa kampionë të Gollobordës dhe mundës popullorë që kanë lënë gjurmë me ndeshjet e tyre. Me Kupen "Nderi i Mundjes Shqiptare" u nderuan mundësit e shquar Hiqmet Elezi, Haki Duka, Jashar Ibrahimi, Masllum Tola, Baftjar Bekteshi, Laura Rama, Abedin Dehari, Shefqet Karasani, Nesim Rama.

Me kupa për "Merita të veçanta" u nderuan Prof. dhe trajneri Hiqmet Elezi, drejtuesi i sportit të Dibrës, Haki Duka dhe arbitri ndërkombatar Abedin Dehari.

Me medaljen "Nderi i mundjes shqiptare" u nderuan Ilmi Tafa, Dilaver Cenaj, Flamur Muca, Rudin Rama dhe Ramadan Karasani.

Me medaljen "Nderi i Mundjes së Gollobordës u nderuan mundësit Ylber Zenuni, Fadil Avdia, Muhamet Avdia, Dilaver Tafaj, Liman Limani, Ferit Sula, Muhamet Kuniqi, Ilir Rexhepi, Marsild Muca, Bardhyl Karasani, Perparim Dauti, Dail Terziu, Petrit Koçi dhe Remzi Ismaili.

Gjithashtu, me certifikata mirënjohje u nderuan edhe mundës që janë shquar në ndeshjet e mundjes në Gollobordë, sponsorë, organizatorët e aktivitetit të parë të mundjes në Gollobordë në vitin 1954, trajnerët dhe gjyqtarët në vite të mundjes nga Golloborda dhe Dibra, të ftuar nderi, veteranë e pjesëmarrës vendas në garat e mundjes popullore.

Fitues për shkollorët u shpall Erion Sulku, fshati Ostren, i cili mori Kupën Tradicionale të Mundjes me emrin "Mentor Muglica", Certifikatën për vendin e parë dhe një komplet sportiv dhuruar nga Familja Muglica. Në këtë moshë garuan 24 mundës.

Për grupmoshat deri në 20 vjeç garuan 24 mundës dhe pas 21 ndeshjeve fitues u shpall Ilir Rexhepi nga fshati Smollik.

Për çmimin e madh konkurruan 10 mundës, disa prej tyre edhe mjeshtra sporti.

Në finale u ndeshën Bardhyl Karasani nga Radoveshi dhe Sallan Osmani nga Trebishti, ndeshje që u fitua nga Bardhyl Karasani, i cili fitoi kupën dhe dashin, si simbol të këtij aktiviteti.

Kupa Tradicionale e Mundjes nuk është vetëm një veprimtari sportive, por është një veprimtari që kërkon të ruajë traditat e kësaj krahine dhe në vitet e ardhshme të kthehet në një veprimtari mbarëkombëtare, me anë të së cilës do të promovohet Golloborda dhe mikpritja e banorëve të saj.

Korresp. Rr.A.



Më 19 maj u zhvillua në Ostren edicioni i 5-të i mundjes tradicionale, i cili synon të kthehet në një veprimtari të përvitshme sportive që do të promovojë vlerat tradicionale të zonës dhe zhvillimin e turizmin

Koncert me rastin e Kupës së Mundjes

Golloborda, *djepi i mundjes shqiptare*

Nga **Xhelil CIBAKU***

Mundësit popullorë të krahinës së Gollobordës janë shquar jo vetëm në garat e mundjes të zhvilluara me rastin e festave dhe dasmave në fshatrat e krahinës, por edhe në pjesëmarrjet e mundësve më të mirë dhe më të fortë të krahinës në garat jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë, si në Dibër të Madhe, Strugë, Tetovë, Gostivar e Shkup dhe më herët deri në Selanik e Stamboll.

Pas çlirimit të vendit, aktiviteti i parë zyrtar i Mundjes në Qarkun e Dibrës është zhvilluar në vitin 1954 në Ostren. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë mundësit më të mirë të Gollobordës, por edhe nga Peshkopia, Shupenza, Bulqiza, Maqellara, Klosi, Burreli etj. Në këtë aktivitet u zgjodh ekipi përfaqësues i Qarkut të Dibrës, të gjithë mundës nga fshatrat e Gollobordës, me trajnerë mundësin e shquar, "Nderi i Mundjes Shqiptare", Hiqmet Elezi dhe përgjegjës ekipi Shaban Saden nga fshati Tucep. Organizatorë të këtij aktiviteti kanë qenë z.Ismet Bellova, ish inspektor i Fizkulturës së Qarkut Dibër, komentator i shquar sportiv dhe z. Rexhep Rama, Inspektor i sporteve të rënda në Ministrinë e Arsimit.

Në vitin 1962 për herë të parë u zhvillua aktiviteti kombëtar i mundjes në Ostren (Lagjen e Gurit), me pjesëmarrjen e mundësve më të shquar nga gjithë Shqipëria. Në finale u ndeshën mundësit e shquar Rrahim Rama nga fshati Radovesh, Dibër me Neshat Alejdinin, përfaqësues i Kukësit, ndeshje që u fitua nga Rrahim Rama.

Krahas vazhdimit të traditës të mundjes në Festa dhe Dasma në Radovesh, Trebisht, Ostren i Madh, Ostren i Vogël, Tucep etj., dashamirës të mundjes popullore nga Golloborda kanë organizuar dy Kupa: Kupën "Haziz Karasani" dhe Kupën "Veli Muça". Mbahen mend dhe janë transmetuar nga TVSH, TV lokale dhe TV Danez, ndeshjet e zhvilluara në dasmën e djalit të mundësit të shquar të Gollobordës, Ivzi Muça në vitin 1997.

Populli kujton me respekt mundësit më të vjetër dhe më të fortë të Gollobordës. Golloborda është djepi i mundjes shqiptare. Mundësit nga Golloborda, krahas përfaqësimit me dinjitet dhe rezultate të larta të ekipit "Korabi", Dibër kanë furnizuar të gjithë ekipet e mundjes që nga Partizani, Dinamo, 17 Nëntori, Durrësi, Fieri, Elbasani, Berati, Shkodra, Kukësi etj., duke u shpallur kampionë kombëtarë, mjeshtra dhe mjeshtra të meritуar të sportit, Nderi i Mundjes Shqiptare, Nderi i Mundjes Dibrane etj., dhe disa prej tyre kanë përfaqësuar dhe nderuar Shqipërinë në aktivitete ndërkombëtare, duke ngritur lart Flamurin Shqiptar.

Ky është një nder i madh që këta djem të fortë i kanë bërë Gollobordës, Dibrës dhe Kombit tonë.

Ekspozita Fotografike pasqyron mjaft mirë traditat, vlerat dhe kontributin në vite të mundësve gollobordas dhe më gjerë. Jemi përpjekur të evidentojmë të gjithë mundësit popullorë që kanë zhvilluar ndeshje në festa e dasma, mundësit që kanë konkurruar në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, trajnerët etj.

Në emër të SHKMSH, dua të përshëndes organizatorët e krijimit të Shoqatës Sportive "Golloborda" dhe të ekipit të Mundjes. Për herë të parë Golloborda u përfaqësua denjësisht në Kupën e Shqipërisë me mundësit e rinj.

Kupa e Mundjes Tradicionale të Gollobordës do të zhvillohet çdo vit, duke e zgjeruar pjesëmarrjen me mundës nga të gjithë krahinat dhe qytetet në Shqipëri dhe nga trevat shqiptare: Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Diasporë; ndoshta duke e shoqëruar me ekspozita të punëve të traditës në ndërtimtari, qëndistari dhe prodhime bujqësore e blegtorale.

Këto ngjarje sportive i shërbejnë edukimit të rinisë me traditat kombëtare, kulturën sportive, larg alkoolit, drogës dhe veseve të këqija; nxisin komunikimin, bashkëpunimin dhe zhvillimin e turizmit kulturor e sportiv.

**Mjeshtër i Meritуar i Sportit.*
Sekretar i Shoqatës Kombëtare të Mundjes Shqiptare.



Fituesi për moshat shkollore, Erion Sulku.



Fjala e autorit në përurimin e librit të tij me poezi “Une cloche à ton cou”/Kambanë në qafë, mbajtur në mjediset e Ministrisë së Kulturës në Tiranë, më 29. 4. 2016)



Nga **jugu** i **Shqipërisë** në **jug të Francës!**

Nga **Agim VINCA**

...Në Jug të thellë Francës, buzë Mesdheut, ai kërkoi nga unë që të lexoja patjetër poezinë *Plepat e vendlindjes*, ku unë flas për bashkëfshtarët e mi buzëdrinas dhe qëndresën e tyre jetike në brigjet e Drinit të Zi, duke e cilësuar atë si “poezi të mrekullueshme”.

Ju falemnderit të gjithëve që keni gjetur kohë të vini në këtë takim, që ka si shkas një libër me poezi, i cili rastësisht është libri im.

Kur në verë të vitit të kaluar (2015), nga Struga buzë Liqenit, ku kemi lindur unë dhe poezia ime, mora rrugën për në qytetin bregdetar Sète të Francës, ku për çdo verë mbahet festivali i poezisë VOIX VIVES de Mediterranée e Mediterranée (ZËRATË GJALLË nga mesdheu në Mesdhe), as që kam menduar se ky udhëtim do të përfundonte me një libër – me botimin e librit që po përurojmë sot këtu në Tiranë. Pa pjesëmarrjen time në Sète, ku unë, për çudi, përfaqësoja Shqipërinë, ne nuk do të ishim sot këtu. Por ja që manifestimet letrare dhe veçanërisht ato prestigjioze e përmbajtësore si VOIX VIVES, e kanë këtë të mirë: krijojnë njohje e miqësi mes krijuesve, por edhe mes krijuesve dhe atyre pa të cilët krijimtaria e tyre nuk mund të arrijë në duart e lexuesve, botuesve. Botuesi i këtij libri, zoti Luc Vidal, që është edhe poet, ishte në Sète, si botues dhe si poet, por ai gjatë ditëve të Festivalit luante edhe rolin e moderatorit. Gjithçka zuri fill një natë të ngrohtë vere, fundkorriku, në mbrëmjen e quajtur “Lecture a la chandelle” (Lexim me qirinj), ku unë duhej të lexoja para publikut, në orët e vona të natës, poezitë e mia shqip, ndërsa të njëjtat në frëngjisht i deklamonte Sharlota, një aktore sharmante e inteligjente, që e kapi aq shpejt sensin e vargjeve të mia, ndërsa drejtuesi i “Éditions de Petit Véhicule”, zoti Luc Vidal, bënte prezantimin.

Në Jug të thellë Francës, buzë Mesdheut, ai kërkoi nga unë që të lexoja patjetër poezinë *Plepat e vendlindjes*, ku unë flas për bashkëfshtarët e mi buzëdrinas dhe qëndresën e tyre jetike në brigjet e Drinit të Zi, duke e cilësuar atë si “poezi të mrekullueshme”. Por edhe: *Baladë për Malin e Thatë*, *Udhëtimi i fundit i motrës sime*, *Të shkosh në Pogradec*, *I jashtëzakonshëm*, *Ode biçikletës*, pa harruar as vjershën për *Zogjtë* që i kalojnë kufijtë pa pasaportë, edhe atëherë kur kufijtë janë të pakalueshëm, ashtu siç ishte dikur kufiri Kosovë-Shqipëri, por edhe ato për gjendjen e jashtëzakonshme dhe për *Idrizovën,* burgun famëkeq, që më ka rënduar tërë jetën si “kambanë në qafë”.

Të nesërmen, te stenda e tij në *Place de livre,* ma bëri ofertën që të më botonte një libër.

Kështu filloi...

Ky projekt nuk do të dilte në dritë, së paku jo i tillë çfarë është, pa gatishmërinë dhe mirëkuptimin vëllazëror të mikut tim të vjetër, Aleksandër Zotos, të cilin ne miqtë e tij shqiptarë e thërrasim Lekë, i cili pati mirësinë t’i përkthente poezitë e mia në frëngjisht, duke bërë një punë çfarë vetëm ai di e mund ta bëjë; pa harruar kurrsesi as piktorin e talentuar pogradecar, Anastas Kostandinin-Tason, i cili brenda një afati rekord arriti t’i bënte ilustrimet për këtë libër mbi motivet e poezive të mia (gjithsej 13) dhe, para së gjithash, botuesin Luc Vidal, i cili u tregua njeri i fjalës dhe e mbajti premtimin e dhënë në Sète për të më botuar një libër në koleksionin e veçantë *Galerie de l’or de temps*, ku libri im *Une cloche à ton cou* (Kambanë në qafë) mban numrin rendor 27.

Njëzet e shtatë! Numër domethënës për mua, veçanërisht sot kur flas nga Tirana, ku shkela për herë të parë në jetë pikërisht kur i kisha njëzet e shtatë vjet.

Isha djalë i ri kur erdha për herë të parë në Shqipëri, në vitin e largët 1974. Kisha botuar vetëm një libër, librin tim të parë me poezi, *Feniksi* (1972) dhe kur njërit nga kolegët që na shoqëronin, studiues i letërsisë, i dhashë një kopje, të nesërmen, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare, ku ne “vëllezërit kosovarë”, punonim për temat tona të magjistraturës e doktoratës, më tha: “Shoku Agim, duhet të jeni shërbëtor i dy zotërinjve!”, që i binte të ishte: i Artit dhe i Shkencës. Tani, pas dyzet e sa vitesh, është rritur numri i librave të mi dhe akoma më shumë ai i viteve. Dhe, gjithsesi, edhe i thinjave, por ëndrrat nuk janë shuar dot, edhe kur janë ndeshur me andralla, sepse: “Kryesorja është të mos thinjesh në shpirt”.

Më lejoni të falënderoj me këtë rast botuesin tim francez, zotin Luc Vidal, të cilin unë dhe miku e përkthyesi im, Aleksandër Zoto, alias Leka, në komunikimet tona të shumta filluam ta thërrisnim me shaka “Lukan”, duke dashur ta shqiptarizonim pak; falënderoj përkthyesin, Lekën e Madh, për punën e jashtëzakonshme që ka bërë në “frëngjishtizimin” e poezisë sime, të them kështu, duke kërkuar pa u lodhur, në çdo rast, zgjidhjet më të mira e jo më të lehta; falënderoj gjithashtu mikun tim nga ana tjetër e Liqenit, piktorin Anastas Kostandini-Taso, që i dha një dimension të ri këtij libri me ilustrimet e tij dhe të gjithë të tjerët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e tij.

Falënderoj dy Ministritë tona të Kulturës, të Kosovës dhe të Shqipërisë, që e mbështetën këtë veprimtari dhe në mënyrë të veçantë ministren Kumbaro e ministrin Shala, që të dy njerëz të letrave, për praninë e tyre në këtë event.

Falënderoj referuesit, miqtë dhe kolegët e mi të çmuar, shkrimtarin Besnik Mustafaj dhe studiuesen Ferida Papleka, për fjalët e mira që thanë për poezinë time, ndërsa aktorët Sokol Angjeli dhe Erjona Hanku për deklamimin e bukur të vargjeve të mia në shqip dhe frëngjisht.

Një falënderim i veçantë i shkon zonjës Shqipe Zani, e cila interpretoi me aq dëshirë e pasion këngën e kompozuar nga kompozitori Xhimi Lazri me vargjet e mia plot 30 vjet më parë (1986): Kur dalin cucat.

Janë edhe dy njerëz në këtë sallë, të cilët dëshiroj t’i përshëndes posaçërisht: ime bijë, Doruntina dhe i dashuri, në të vërtetë bashkëshorti i saj, Flori. Ndërsa ne, baballarët e tyre, e bëjmë me fjalë bashkimin kombëtar, ata e kanë bërë tashmë në vepër. Janë ata, Flori dhe Doruntina ose Floruntina, si i quajtën shokët e tyre një vit më parë, që më nxitën ta bëja promovimin e këtij libri në Tiranë.

Edhe një herë ju falemnderit të gjithëve, të dashur miq e kolegë: shkrimtarë, studiues, artistë, publicistë etj. dhe mirupafshim në takime të tjera të ngjashme, në Tiranë dhe në Prishtinë, për dhe me Mbretëreshën e Arteve, si e quanin dikur Poezinë.

AGIM VINCA

KËNGË PËR TË PARIN E FISIT

(Apokrif për Marko Këqezën)

... Dhe ish viti 871, sipas Hixhrit;
1467, sipas Krishtit ...

Në defterin osmanlli
Shkruan qartë, me bojë të zezë
N’Dibër t’Poshtme, përmbi Dri’
Kish një fshat me emrin Vincë.

E në Vincë Marko Këqeza
Një shtëpi, asnjë më shumë
Prodhon musht e verë me vedra
Më shumë se mel e elb e grurë.

Lëron tokën, kit hardhinë
Mark Këqeza i Vinecit,
Pushton gruan, lind fëmijë
Tund mustakun sipër djepit.

Tund mustakun e kaptinën
Mark Këqeza eshtërmadh.
Rrëmih arën e bashtinën
Kosit barin në livadh.

Tund mustakun, dredh cigaren
Ngjesh kësulën përmbi sy.
Mark Këqeza eshtërmadh
Nga një shpi bëhet një mijë.

Në defterin me të zeza
Të dovletit me pahir
Emri yt Marko Këqeza
Thik përpjetë si një menhir!

Prishtinë, 7. I. 2013

homazh

Meditime duke lexuar vëllimin e parë të librit
"DIBRA 1840-1860" të Munir Shehut

Dy dervishët që zhveshën Hysni Pashën dhe taboret e tij

Dhe një homazh për Dervish Hysenin (Sheh Hysenin), Dervish Emrullahun, Sheh Ibrahimin e Tominit, Sheh Hysenin e Peshkopisë

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Munir Shehun e mbaj mend me një çantë violine nën dorë në qetësinë kalimtare të tij nën kurorën e blirëve në rritje drejt shtëpisë së kulturës apo shkollës pedagogjike. Nuk e kam njohur nga afër dhe nuk do ta kisha njohur sikur, rastësisht, mbi një tavolinë në librarinë e mikut tim në Tiranë Bujar Karoshi mos më ishte fiksuar shikimi mbi kopertinën e një libri ku shkruhej: "MUNIR SHEHU. DIBRA I NË VITET 1840-1860, RRËFIME DHE KËNGË DIBRE."

Nuk ngurova ta blej në vijimin jetësor që sa herë udhëtoj në Atdhe të mos marr me vete "një dorë" libra me autorë të vendlindjes, "dorë" e cila mbush vazhdimisht raftet e bibliotekës sime modeste në mërgim.

Prisja të gjej "Këngë Dibre", folklor, anekdota, përralla...

Gjeta histori të gjalla dibrane, histori të marra nga gojë e kujtesë njerëzish të mençur, me laps e letër në dorë, pa mikrofon, në kohë që nisnin nga vitet '30-të të shekullit të kaluar. Qindra emra tregimtarësh, këngëtarësh të këngëve historike, me emër e mbiemër, të njohur, të dëgjuar, ndonjërin prej të cilit e ke tëndin, ke pirë kafe, ke ngrënë bukë e ke biseduar pa kalem e letër në dorë, pa mendjen e "vjelësit" të "fryteve" të jetës së tyre. Dhe kur i përjeton këto, faqe pas faqeje të vëllimit të parë të Munir Shehut për Dibrën dhe Dibranët e viteve 1840-1860, të dy ngjarjeve të mëdha historike, fitoreve kundër urdisë së Hajredin Pashës dhe Hysni Pashës, ndjen respekt për autorin dhe përgjegjësi intelektuale se pse ti nuk ke bërë të njëjtën gjë, pse duke udhëtuar nëpër Dibër, nuk ke vënë në gjunjë fletoren e nuk ke hedhë kujtimet e njerëzve.

Diku, në kujtimet e tij Ismail Strazimirit, luftëtar i tre betejave të mëdha historike në Dibër, i betejave kundër turqve osmanlinj, serbëve lakmitar për të dalë në Adriatik dhe nazifashistëve (Ai dha jetën në Sllovë në përballje me forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre në nëntor 1943) thotë se dibranit nuk i ka munguar kurrë shpata dhe pushka, trimëria, por i ka munguar pena për të shkruar historitë e shpatës dhe pushkës në duar njerëzish trima e të mençur...

Munir Shehu më vjen në librin e parë DIBRA me vlera që të bëjnë të ngrihesh në këmbë e të përkulesh me respekt.

Nga leximi "pa laps në dorë", u ktheva pas për tu ndalë në një fletë të historisë së treguar prej Munirit, në vendin dhe rolin e klerikëve dibranë në fitoren historike popullore kundër Hysni Pashës...

* * *

...Hysni Pasha vjen në Dibër me krenarinë dhe arrogancën anadollake të një pashai të ri, vjen pa e mësuar "Këngën e Hajredin Pashës", metafora e së cilës jeton edhe sot e kësaj dite në të folmen popullore. Vjen "hipur në kalë", metaforë tjetër kjo e "Odës dibrane". Vjen për të rënë në një "grackë" të menduar mirë, "grackë" (as)pak të njohur dhe (as)shkruar.

Autor i "grackës" Salë Markja kish lënë djalin peng tek pashai, kishte ra edhe vetë peng, madje në një pozicion ku i rrezikohesh jeta, atij dhe dy të tjerëve, kjo si rezultat i një kobureje shkrepur në drejtim të pashës me devijim plumbi në sekondën e fundit...

Pashai detyrohet të presë një dyshe klerikësh, dyshe e përbërë nga Dervish Emrullahu i Teqesë së Këllëç Babës dhe Dervish Hyseni i Teqesë së Kuqit. Misioni i tyre ishte të qetësonin pashain dhe të lironin nga burgu pengjet në rrezik jete.

Taktika që do të ndiqnin ishte.... njeri ta mbajë e tjetri t'i bjerë...

Po e përcjellim skenën ashtu siç na e ka dhënë me mjeshtërinë e historianit dhe të tregimtarit Munir Shehu...

* * *

Kapuxhiu hyri në dhomë dhe lajmëroi se dy dervishët e ditës së djeshme, kishin ardhur përsëri dhe bënin rixha të pranoheshin në takim.

- Ata thonë, shtoi kapuxhiu, - se janë dy dervishët e teqeve më të vjetra të qytetit. Njëri është Dervish Emrullahu i teqes së Këllëç-Babës dhe tjetri Dervish Hyseni i teqes së Kuqit. Ata thonë se janë të dërguar nga gjithë ulematë dhe paritë e qytetit për të biseduar.

Këta dy dervishë ishin dërguar nga populli i qytetit, me qëllim që t'i mbushnin mendjen pashës për t'i liruar të burgosurit. Ata qenë të caktuar për dy arsye:

E para, se ishin fetarë dhe pasha nuk bënte luftë me çallmat e pejgamerit, kurse të tjerëve jo vetëm që nuk do tu shkonte fjala, por edhe do t'i arrestonte.

E dyta, sepse ata ishin zë lidhur me popullin dhe luftën, ishin shumë të zgjuar, hazër xhevap dhe ajo që kishte rëndësi, ishin moshatarë me pashën, bile dervish Hyseni ishte martuar atë vit.

Duke ecur rrugës, dervish Hyseni i thotë shokut tjetër:

- Nuk e dimë si do të na ecë falli, megjithatë unë jam i mendimit se pashës nuk duhet t'ia nxjerrim frikën që i ka hy në bark. Prandaj ti lëmoje e unë t'i bije me çekiç dhe të mos i ndahemi, derisa të na i japë me vete.

Kur dy dervishët u dukën në prag të derës, pasha ra në shehadet (një lutje fetare), se iu kujtuan dy dervishët e ëndrrës, të cilët nuk i shqepeshin nga truri. Por këta ndryshonin, se në vend të qefinëve kishin herka prej cohe të shtrenjtë damasku dhe në vend të tebereve mbanin tespi të duar. Pastaj nuk ishin të vdekur, por ishin të gjallë e, megjithatë, ndoshta pasha kishte frikë se po i del paralajmërimi i ëndrrës. Dervish Emrullahu, kishte trup të gjatë e të hollë, kurse dervish Hyseni, pak më i shkurtër, por më i mbushur. Qysh në prag të derës të dy i qeshnin pashës. Ky e mori veten dhe u çua në këmbë. Pasi mbaruan "merhabatë e temenatë" (përshëndetjet), me pashën dhe me zabitllarët, dervishët u ulën në divanin pranë tavolinës së pashës dhe i tërhoqën një salavat (bënë një lutje të shkurtër fetare). Atëherë dervishi që kishte marrë përsipër të përdorte "limën", e mori fjalën:

- Pasha hazreteli, Allahu është i madh. Pa urdhër të tij, robi robit nuk mund t'ia shkurtojë jetën. Ne na kanë dërguar të gjithë ulematë, shehlerët, hoxhallarët, dervishët e muhibët tonë, si dhe gjithë bejlerët, agallarët, tregtarët e zanatçinjtë, gjithë qyteti, i madh e i vogël, për shyqyrllëk që shpëtove nga ai taksirat (rrezik), që të ndodhi dje. Ne të erdhëm edhe dje, por kapuxhiu na tha se ishit zënë me punë dhe shkuam në shtëpiat tona. Shyqyr, njëmijë herë shyqyr! Allahu ta shtoftë ymrin e të ruajte nga rreziqet!

Pasha e dëgjoi me vëmendje. Ai kishte nevojë për një ngushëllim të tillë fetar dhe iu bë qejfi shumë. Ai tha:

- Allahu qoftë me ju! Jam shumë i gëzuar që më keni ardhur për ziaret. Por mua më duhet të rregulloj punët e hyqimetit. Përse të mos vijnë bashkë me ju edhe bejlerët dhe agallarët? Këtu po shkon puna shumë keq. A s'kam të drejtë të zemërohem?

Tani i erdhi radha dervish Hysenit të marrë "çekiçin" në dorë, por në fillim duhet sjellë me ngadalë:



- Ashtu është pasha hazreteli, vërtet punën kanë vajtur ters, por do të vijnë të gjithë, bejlerë dhe agallarë, veçse edhe ti, punët duhet ti marrësh pak më me ngadalë dhe më shtruar, sepse, pastaj, do të jetë keq për të dy palët. Ju keni pushkë edhe ata kanë pushkë, mirëpo të dy palët i keni hipur mushkës së prapthi dhe do të hani kokën e njeri-tjetrit. A nuk do të jetë më mirë të merremi vesh, se ky popull është pak i egër, po të zemërohet e të çohet në këmbë, bën hata!

- Si të merremi vesh, kur asnjë nuk vjen të bisedojë me mua?

- Ke ca faj edhe ti vetë. E ke zemëruar shumë popullin. Atë ditë që erdhe, të gjithë dualën përpara për të të pritur me nderime e donamë, por ti, as nuk begenise të zbresësh nga kali për të nderuar e përshëndetur taxhat e pejgamerit dhe krerët e agallarët. Asnjë pashë nuk ka bërë kështu. U zemëruan të gjithë, Edhe ne, ulematë, u zemëruam, se mbajmë në kokë kijafetin (uniformën, taxhën) e pejgamerit. Allahu ka thënë: "Kush nderon taxhën e pejgamerit, ka nderuar mua!"

Hysni pasha u skuq si fëmijë i kapur në faj. Oficeri i papjekur i taborit të Bursës, nuk kishte ç'të thoshte dhe nguli sytë në mes të tavolinës.

- Vazhdo, -i pëshpëriti Emrullahu kolegut të tij, - për limë nuk ka nevojë.

- Prandaj edhe ne u shpërndamë dhe nuk të erdhëm në hyqimet, - vazhdoi Hyseni, - domethënë, ta bëmë si na e bëre. U bëre shkaktar edhe që të mbyllet pazari, fajet i ke vetë.

- Ju duhet të më njihni për mytesarif, se më ka dërguar Divani i Lartë, më ka dërguar vetë Sulltani.

- Si të të njohim ty, kur ti nuk na njeh ne? Kur ti nuk njeh as çallmat e pejgamerit! Sulltani nuk të ka përgatitur kështu! Nuk ka si bëhet kjo!

- Për këtë duhet të më falni, kjo nuk është gjë e madhe. Ç'të keqe kam bërë tjetër?

- Si? Pak të duket kjo që bëre dje? Shave e horlladise gjithë qytetarët të cilët kishin dalë për të të përshëndetur e për të të marrë temena. Shave e horlladise, duke ua luajtur kërbaçin përreth hunde, krerët më të mëdhenj të Dibrës, të cilët do të vinin për vizitë, për mysafirë në zyrën tënde, në shtëpinë tënde. Kështu i pret miqtë ti? Kështu asnjeri nuk të vjen në zyrë. Kështu nuk të duron kush! Punët do të shkojnë shumë keq, prandaj, duam s'duam jemi të detyruar t'i shkruajmë edhe sulltanit për këto gjëra, gjatë e gjerë.

Pasha, shtangu në vend dhe iu prenë damarët. Këtë nuk e priste. Atij i hyri frika, se e ndjente veten me të vërtetë fajtor.

- Çekiç i rëndë ky!- pëshpëriti Dervish Ermullahu.



- Vazhdo njëherë ti me limën, - i tha Hyseni, të shohim ç'do të dalë.

- Megjithatë, këto punë mund të rregullohen, - foli me zë të lartë Emrullahu.

Pasha ia nguli sytë e hapur, se kishte nevojë për ndihmë. Dervishët e shikonin se kishin të bënin me një kalama të mbrapshtë e të papjekur, i cili kishte në dorë të të prishë shtëpinë dhe prandaj ishte shumë i rrezikshëm e duhej sjellë me kujdes me të.

- Puna e parë që të bësh, - i tha dervish Emrullahu, ata tre të burgosurit, duhet t'i sjellësh këtu në zyrë sa jemi edhe ne këtu. Ti duhet të pajtohesh me ta dhe t'i lirosh nga burgu, se i ke miq. Ata, erdhën me qëllim që të të ndihmojnë. Ata prishin e ndreqin çdo punë, pa ta, nuk mund të bësh asgjë, prandaj unë them se kjo është e mira jote. Dërgo një nizamë dhe thirri të vijnë këtu.

- Ata më vranë por më shpëtoi Allahu, u përgjigj pasha.

- Ti u bëre sebep!- ia priti Hyseni- për pak sa nuk i shtype me kalin tënd!

- Ajo ishte punë e shejtanit, - ndërhyri Emrullahu.- Shejtanit nuk duhet t'i shkojë fjala. Allahun duhet t'a dëgjojmë, se kështu shkojnë punët mbarë. Thirri të vijnë këtu, pasha hazreterli, për të mirën tënde e kemi.

Këtu u hap një bisedë e gjerë, në të cilën morën pjesë edhe zabitllarët. Si përfundim doli se Salë Markja i kishte shpëtuar jetën pashës duke i rënë me bërryl Mane Demës. Salë Demiri kishte folur me urtësi dhe nuk kishte pasur qëllim vrasjeje, ndërsa Mane Dema ishte rrëmbyer nga gjaknxehtësia dhe nuk kishte qenë në vete.

- Shikoni ç'keni bërë? – ia priti pashës Dervish Hyseni.- Ai tjetri ju shpëton jetën dhe ju e futni në burg! Si e quani ju këtë? E vërteta është se jo kot më koti mbani në burg katër njerëz të pafajshëm. Edhe djalin e Salë Markes, të cilin e keni mikun më të ngushtë, kot e mbani në burg. Kjo është punë për t'u çuditur! Tani këtu do të vijnë të gjithë malësorët dhe do të bëhet luftë e madhe, do të vriten gjithë ata njerëz, të gjithë, ju do t'i merrni në qafë. Për këtë duhet shkruar sa më parë valiut dhe sulltanit, se ju jeni fajtor.

Hysni Pasha thirri kapuxhiun dhe i dha urdhër të sillte vetëm Salë Marken e Salë Demirin.

- Edhe dy të tjerët!- thirrën me një gojë dervishët.

Ata nuk i liroj. Do t'i mbaj peng. Nuk kam besim tek këta njerëz. Po t'i bëhet dëm, ose të më vritet ndonjë nizam, unë do t'i vras. Ndryshe u betohem për Allah, se do t'i mbaj shumë mirë, derisa të zgjidhen këto çështje dhe punët e administratës të shkojnë në rregull. Më tepër mos kërkoni, shkurt fjalë.

Dervishët e panë se ishte e kotë të vazhdohej më tej.

* * *

Dervishët natyrisht janë njerëz fetarë dhe çështjet i lidhin gjithmonë me fenë, por këtu duhet të kuptohet gjithashtu se ata fenë e përdorin si një mjet për tu ardhur në ndihmë të burgosurve, sepse ndryshe nuk do të merreshin vesh dhe ta bindnin pashën. Duhet theksuar gjithashtu se këta dy dervishë kanë mbajtur një qëndrim patriotik gjatë gjithë jetës së tyre. Në kohën e Rilindjes, teqet e tyre ishin çerdhe ku bënin mbledhje klubistët dhe patriotët, të ashtuquajturit "farmasonë", të cilët punonin për luftën kundër turqve, për pavarësinë dhe shkollën shqipe. Dervish Hyseni, më vonë sheh Hyseni, është dekoruar me rastin e jubileut të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në vitin 1978

Natyrisht, kuptohet se edhe biseda e mësipërme në zyrën e pashës, është ndërtuar në bazë të të dhënave të cunguara të pleqve të Dibrës së Madhe, sepse edhe vetë ngjarjet dhe rrjedhimet e tyre, lenë të kuptohet, që kjo bisedë pak a shumë, kështu duhet të jetë bërë. F.225-230

* * *

Disa nga krerët e Dibrës së poshtme, të fushës e të malësisë, pasi vunë përpara sipas zakonit të atëhershëm fetarët e tyre, sheh Ibrahimin e Tominit dhe Sheh Hysenin e Peshkopisë e ndonjë tjetër, u nisën për në Dibër të Madhe. Po kështu erdhën aty edhe krerët e fushës dhe të maleve të Dibrës së Epër. Ata bujtën atë natë nëpër miqtë e tyre. Të nesërmen, muarrën edhe krerët e qytetit, bashkë me Dervish Emrullahun dhe dervish Hysenin dhe, pasi vunë përpara fetarët dhe Salë Marken, i vajtën pashës në hyqimet dhe u ulën në sallën e xhelisit f. 246

* * *

Ka qenë zakon në atë kohë që, kur shtroheshin sofra (gosti) të tilla të mëdha, në fund të të ngrënit bëhej duva, prandaj, pavarësisht se aty tani do të bëhej luftë, ishin ftuar edhe fetarë. Sidomos në këtë rast, këta ishin të domosdoshëm, për t'i dhënë pashës të kuptojë se aty po shtrohej një drekë e zakonshme. Mungesa e tyre, do t'a bënte pashën të dyshojë. Por këta fetarë ishin fetarë të lidhur me popullin, si dervish Emrullahu, dervish Hyseni, etj. Këta shehlerë ishin të rinj, moshatarë me pashën, por ishin edhe shokë e miq midis tyre. Sheh Ibrahimi ishte martuar me motrën e dervish Emrullahut. Sheh Hyseni i Peshkopisë bënte bejte, të cilat në mungesë të alfabetit shqip, i shkruante me shkronja turke. Mosha e tyre e re, si dhe kjo periudhë kryengritjesh në të cilën ishin rritur, nuk i lejoi të futen në fanatizmin e theksuar fetar, por të kenë po ato mendime të popullit në mes të të cilit jetonin. Pasha mendonte se ata kishin ardhur aty, që të bënin duva për vendosjen e administratës së plotë turke, kurse ata kishin ardhur aty, për të luftuar e ndoshta edhe do të vriteshin... f. 268.

* * *

Dervish Hyseni i Teqes së Kuqit dhe Dervish Emrullahu i Teqes së Këllëç Babës u bënë pjesë e "Loxhës" që iu bë Hysni Pashës, "Loxhë" e çarmatosi dhe zhveshi pashën osman pa derdhur asnjë pikë gjaku...

Dhe kënga i shkoi prapa...
Udhë e mbarë, or Hisni pasha,
Se Nand Malet i ke përmbrapa!

Athinë, 22 mars 2016

Rruga e Arbërit nr. 121

kujtesë

Blliçjanët e diasporës shqiptare





Nga **Mentor HOXHA**

Diaspora e Blliçes në Belgjikë Varre të Blliçjanëve në Belgjikë.

Fshati Blliçe njihet si fshati më disident në hapësirën mbarë shqiptare. Pjesmarrja e blliçjanëve përkrah Halil Alisë, kreut më të fuqishëm nacionalist në trevën dibrane i vunë ata përballë urrejtjes së komunistëve shqiptarë. Kjo urrejtje u shtua më shumë kur banorët e Blliçes luftuan me armë kundër partizanëve në dy betejat e fuqishme që u zhvilluan më 9 dhe 29 korrik në Fushë Alie midis forcave nacionaliste të kryesuar nga Halil Alia dhe forcave partizane të udhëhequra nga Mehmet Shehu, Haxhi Lleshi dhe Dali Ndreu. Në këto beteja humbën jetën shumë partizanë dhe nacionalistë. Pas thyerjes së Halil Alisë dhe triumfit të komunistëve shqiptarë u dogjën shtëpitë e nacionalistit Rustem Bitri, Avdullah Nokës, Zenel Nokës, Musë Murrakut, vranë Jahe Murrakun dhe hodhën në zjarr vëllain e tij, Brahimin, i cili u dogj. Do ishte djegur gjithë fshati Blliçe, nëse nuk do të kish ndërhyrë kushërira e Dali Ndreut, Zatije Hoxha (Ndreu). Ajo i thotë Daliut që të tërheqë trupat dhe të largohet menjëherë nga fshati, në të kundërt do t'i bënte thirrje fshatit të ngrihej kundër tyre. Pasi dëgjoi fjalët e kushërirës së tij, u largua nga Blliçja pa bërë asnjë veprim tjetër. Megjithatë, terrori komunist mbi fshatin Blliçe dhe banorët e saj nuk mbaroi me kaq. Sapo morën pushtetin në nëntor të vitit 1944 ata filluan terrorin nëmbarë fshatin Blliçe. Arrestuan, pushkatuan, dënuan dhe internuan shumë figura të nderuara të këtij fshati. Më 17 qershor 1946 pushkatuan pa gjyq tek mulliri Kapç Rustem dhe Adem Bitrin. Lista e të arrestuarve, e të burgosurve dhe e të internuarve është shumë e gjatë. Jo më kot ky fshat u dekorua më 30 prill 2015 me Dekoratën "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani"në shenjë vlerësimi të lartë dhe respekti të thellë për qëndresën e pamposhtur ndaj diktaturës mizore gati 50-vjeçare komuniste, si dhe në nderim të vullnetit, kurajës dhe këmbënguljes së paepur të treguar gjatë gjithë asaj periudhe të pashpirt shtypjeje dhe përndjekjeje të pabarabartë në emër të luftës shkatërrimtare dhe vëllavrasëse të klasave".

Represioni i pashembullt komunist në Blliçe, detyroi shumë familje të këtij fshati të arratisen jashtë Shqipërisë duke kërkuar strehim politik në Perëndim dhe në SHBA. Më 1948 u rratisën Shaqir Derti, Hamit Derti dhe fëmijët e Ahmet Dertit; Kafilja, Hazizi, Rushija. Ahmeti u vra në vitin 1944. Më vonë u arratis edhe Rexhep, Selim e Mexhit Leka. Në vitin 1953 arratiset Adem Bushi. Në maj 1958 arratisen: Lam, Haxhi e Qani Skepi dhe familja e Halil Alisë. Iku edhe Ramadan Tota. Më 20 tetor 1965 arratisen: Nazmi Dauti, Haxhi Pula, Xhemal Spata, Muharrem Spata, Qamil Spata, Dalip Spata. Në këtë arratisje u vra Haxhi Pula dhe u arrestua Xhemal Spata.

Ramadan Tota u strehua në Francë, Sakip Derti dhe Sakip Skepi në Belgjikë, kurse Shaqir Derti, Hamit Derti dhe fëmijët e Ahmet Dertit: Kafilja, Hazizi dhe Rushijaemigruan në SHBA. Ata punuan me mish e me shpirt për rrëzimin e regjimit komunist duke bërë protesta dhe aksione luftarake në shtetet ku ndodheshin. Ramadan Tota u inkuadrua në Lëvizjen e Mbretit Zog.

Një rol të madh ata luajtën edhe në vitet e para të demokracisë, ku mjaft prej tyre strehuan dhe ndihmuan financiarisht partitë e para opozitare shqiptare dhe pritën në shtpitë e tyre liderët e këtyre partive. Ndër ta spikat Din Derti i cili priti në shtëpinë e tij në Amerikë dhe ndihmoi me para Sali Berishën, Azem Hajdarin, Gramoz Pashkon, Eduard Selamin etj. Një gjë të tillë bëri edhe Ramadan Tota ku priti në Paris të Francës, Preç Zogajn, Sali Berishën etj. Sakip Derti ka pritur në shtëpinë e tij në Belgjikë shumë bashkëfshatarë të tij. Ai është shumë mikpritës dhe shumë dashamirës.

Siparin e arratisjes e hapi fisi Derti me arratisjen e dy vëllezërve: Hamit dhe Shaqir Derti dhe fëmijët e vëllait të tyre, Ahmet Derti: Kafilja, Hazizi dhe Rushija. Shaqiri u arratis bashkë me fëmijët e tij: Din Derti, Xhetan Derti, Nazmi Derti, Sakip Derti dhe Majune Derti. Fatkeqësisht, Xhetani u nda nga jeta në një moshë shumë të re. Ai vdiq nga një aksident automobilistik në Belgjikë në moshën 25 vjeçare. Hamiti u arratis me dy djemtë: Ramadanin dhe Mediun. Këta u arratisën në Jugosllavi, por atje u kapën nga forcat policore jugosllave, u futën në burg dhe u torturuan mizorisht nga gardianët e burgut. Për t'u shpëtuar torturave dhe burgimit, Haziz Derti dhe Xhetan Ndreu shpërthyen burgun, vranë dy oficerë jugosllavë dhe ikën së bashku në Itali. Më pas mbërrijnë në Belgjikë. Sakipi qëndroi në Belgjikë, kurse të tjerët emigruan në SHBA ku banojnë edhe sot.

Shaqiri u rikthye në fshatlindje në vitet 90 në moshën 80 vjeçare. Kontribuoi me para në ngritjen e xhamisë së fshatit Blliçe dhe ndihmoi njerëzit në nevojë me pensionin e tij prej 800 dollarësh amerikanë. Vdiq dhe u varros në fshatlindje. Sakipi është martuar dy herë: me një franceze dhe një marokene. Me gruan franceze lindi Qerimin, i cili është martuar me një vajzë nga Skrapari dhe ka një djalë e një vajzë. Me gruan marokene, Sakipi ka tre fëmijë: Saminin, Iliazin dhe Safien. Samini është martuar me një marokene, kurse Iliazi dhe Safia janë beqarë. Ramadan Derti ka një djalë dhe një vajzë. Rushia ka dy vajza, Nazmiu, dy djem. Dy djem ka edhe Dina, të cilët janë me arsim të lartë. Hazizi ka një djalë e një vajzë. Djali quhet Artan dhe është diplomuar për AND, punon për FBI-në amerikane.

Nëntogeri që u burgos nga komunistët për antiserbismin e tij

Fshati Blliçe dhe banorët e tij njihen për nacionalizmin e theksuar, për disidencën dhe për persekutimin që u është bërë për afro 50 vite me radhë nga regjimi komunist. Të gjitha figurat nacionaliste dhe ushtarakët më në zë të këtij fshati, si Qazim Noka, Xhaferr Hajredin Dauti etj. u arrestuan dhe u dënuan me vite të gjata burgimi sapo regjimi komunist mori pushtetin në Shqipëri. Ndaj tyre u sajuan akuza të pavërteta dhe nga më të ndryshmet.

Xhafer Hajredin Dauti u arrestua më 18 nëntor 1946 në moshën 29 vjeçare. Gjyqi iu bë më 17 tetor 1946 në sallën e hotel dëfrimit të Peshkopisë.

U dënua si Armik i Popullit dhe Sabotator i Pushtetit me 10 vite burg, humbjen e të drejtave qytetare dhe politike baras me kohën e ndëshkimit të tij. Në aktakuzën ndaj tij ndër të të tjera shkruhet. "I pandehuri Xhaferr Dauti nga katundi Blliçaj i Shumbatit, gjatë kohës së okupacionit fashist ka marrë pjesë si militant në radhët e grupit Skënderbeg dhe në luftën kundra partizanëvet Malezez. Ka marrë pjesë si N/Toger i Milicisë nën komandën e trathtarvet Asllan Beqiri dhe Qamil Çelës, ka marrë pjesë në djegjen e katundevet Mavrove dhe në luftimet e Prizrenit.



Xhaferr Hajredin Dauti



Hajredin Dauti

Mbas çlirimit të Shqipnisë tue qenë se nuk ishte zhvilluar veprimtaria e tij antipopullore, ka marrë pjesë së nënëpunës i Pushtetit tue u shënuar si sekretar i III i N/Prefekturës Shumbatit. Qëndrimi i tij në Pushtetin Popullor ka qenë reaksionar dhe sabotator. Me datën 3/9/1946 ndërsa manifestonte në shenjë proteste kundra padrejtësive të Konferencës së Paqes që bajshin për vendin t'onë dhe për provokacionet greke, i pandehuri në masën që manifestonte ka hedhun parrulla disfatiste për të provokuar demoralizimin e popullit".

Xhaferr Dauti u lind në Blliçe më 1 Prill 1919. Pasi kreu pesë klasë fillore dhe dy klasë gjimnazin, kreu më 1940 edhe kursin e nënoficerave në Përmet. Ka marrë pjesë në luftën italo-greke dhe në shtypjen e kryengritjes malazeze. Gjatë shërbimit ushtarak ka qenë tetar (14 prill 1940), rreshter (27 shkurt 1942), komandant toge, kapter dhe nëntoger (10 qershor 1944). Për meritat ushtarake është dekoruar me Kryqin e Luftës dhe Dinatativën e tre vjetëve të luftës. Pas çlirimit dhe deri më 18 nëntor 1946 ku u arrestua ka punuar si nënpunës i Gjendjes Civile në Shumbat. Pasi doli nga burgu, u martua dhe bëri 4 fëmijë: Hajredinin, Rremziun, Skënderin dhe Alltanen. Fëmijët e tij, ndonëse të shkëlqyer në mësime nuk mund të vazhdonin studimet e larta, kështu që Hajredini, Rremziu dhe Skënderi punuan për shumë vite në minierën e Bulqizës. Pas viteve '90 u diplomuan, Hajredini për Histori-Gjeografi, kurse Skënderi për Informatikë.

Xhafer Dauti ishte një antiserbist i madh. Ishte djali i Hajredin Dautit, i cili u vra në moshën 36 vjeçare më 20 gusht 1920 nga serbët kur u hodh mbi mitralozin e tyre për të shpëtuar shokët, që i kishin rreshtuar për t'i pushkatuar tek lisi i Daute në Blliçe. Dina e vrau mitralierin serb, shpëtoi shokët por vetë u martirizua. Ai la dy tre fëmijë; Ramadanin, Safijen dhe Xhaferrin.

Hajredin Dauti, vrarë nga serbët me 20 gusht 1920

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

recension

Në studim sillet e shqyrtohet një pasuri e madhe e emërtimeve në shqipe. Ai mund të futet ndër studimet e rralla në literaturën gjuhësore, që analizon këtë pasuri leksikore të shqipes në përbërje të fushës konceptore të ngjyrave.

Studime për *leksikun dhe për leksikografinë e sotme shqipe*

Nga **Prof.dr. Thanas FEKA**

Përmbledhja "Studime për leksikun dhe për leksikografinë e sotme shqipe" e prof. dr. Hajri Shehut përfshin mbi pesëdhjetë artikuj, pothuajse të gjithë të botuar në revistat shkencore "Studime filologjike", "Gjuha jonë", "Gjuha shqipe" etj. Tematika e saj është: I. Çështje të leksikut popullor me vlerë letrare potenciale; II. Çështje të fjalëformimit në gjuhën shqipe; III. Çështje të sintagmatikës; IV. Çështje të kulturës së gjuhës; V. Kritikë leksikologjike; VI. Kritikë leksikografike etj. Siç shihet, studimet dhe artikujt mbulojnë një tematikë të gjerë e të larmishme.

Çështjet e shtruara në këto studime e artikuj analizohen e shqyrtohen me kompetencë shkencore. Përmendim, p.sh., studimin për sindajshtesat në gjuhën e sotme shqipe, tek i cili, nëpërmjet analizës së një lënde konkrete, autori jep mendimin e vet për pyetje të tilla themelore, me karakter teorik, si: "A janë të ashtuquajturat sindajshtesa fjalë të plotkuptimshme jashtë njësisë së njëfjalëzuar, apo janë larguar nga sistemi i njësive leksikore të gjuhës, domethënë janë kthyer në morfema me semantikë abstrakte deri në rrafshin fjalëformues të ndajshtesave? A jemi të vetëdijshëm për kuptimin e tyre përgjithësues (karakteristik për ndajshtesat), apo për kuptimet e tyre leksikore si tema motivuese në njësinë e njëfjalëzuar? Në këtë studim ai mban qëndrimin e vet për njësi të caktuara, si *bashkë-, brenda-, jashtë-, para-, krye-, shumë-* etj., duke hyrë në diskutim me qëndrimin e shprehur se "ato janë shndërruar e po shndërrohen në parashtesa në të gjitha formimet me to", se "paraqesin më shumë një lëvizje me drejtim nga kompozimi në parashtesim, por, pa u larguar shumë nga burimi". Më konkretisht, ai pohon se "këto elemente nuk janë gramatikalizuar e as nuk po gramatikalizohen, domethënë, nuk kemi të bëjmë me fjalë shënuese që janë kthyer ose që po kthehen në formant; përkundrazi, semantikisht ato ruajnë mëvetësinë". Po ashtu, i njëjti qëndrim mbahet për këtë problem edhe në studimin "Formimet me gjymtyrë të parë temën *vetë-* në gjuhën e sotme shqipe". Në studim shqyrtohet gjerësisht nga pikëpamja leksiko-semantike grupimi më i madh paradigmatik i formime-ve me *vetë-*. Rritjen e numrit të këtyre formimeve në krahasim me periudhat e mëparshme të zhvillimit të gjuhës letrare, autori e lidh jo vetëm me faktorë brendagjuhësorë, por edhe me ata jashtëgjuhësorë. "Vetë zhvillimi i sotëm i prodhimit, mekanizimi dhe automatizimi i tij sjellin nocione të reja. Nga ana tjetër, dihet që shoqëria ushtron ndikim rregullues mbi gjuhën letrare nëpërmjet përpjekjesh sistematike e të vetëdijshme jo vetëm për pasurimin e saj, por edhe për pastrimin e saj të mëtejshëm nga ndikimet e huaja të panevojshme. Formimet me *vetë-* e përmbushin këtë synim, pasi shumë njësi të huaja, madje edhe ndërkombëtarizma me elementin *auto-* janë kalkuar për të mbuluar emërtime nga fusha të ndryshme të shkencës e sidomos të teknikës". Në punim dallohen e analizohen ndarazi formimet me *vetë-*, kur ky përbërës zbërthehet me emrin e gjinisë femërore *vet / e, -ja (vetëqortim)* dhe me përemrin vetvetor *vetë (vetëveproj)*. Një analizë e detajuar bëhet për rastet e mundshme e të pamundshme të bashkimit të *vetë-* me foljet sipas diatezave përkatëse, të cilat shërbejnë në këtë rast edhe si kritere për të dalluar formime e kalkime të parregullta foljore.

Për vëzhgimet dhe përfundimet me interes të veçantë shkencor mund të përmendim midis të tjerave, edhe studimin "Rreth shtimit të fjalëve të përbëra në gjuhën e sotme shqipe". Shtimi i këtyre



njësive analizohet mbi bazën e valencave të brendshme e të jashtme. Më konkretisht, nënvizohet qartë se mundësia për të formuar fjalë të përbëra kushtëzohet nga valenca e të dyja temave që hyjnë në kompozitë, por, në radhë të parë, nga tema e përsëritshme, që është gjymtyrë e parë e njësisë: sa ajo hyn në lidhje me gjymtyrë të tjera, cila është mundësia për të formuar vargje leksiko-semantike.

Nisur nga pasqyrat e nxjerra nëpërmjet analizës statistikore të fjalëve të përbëra në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980), të krahasuara me ato që janë nxjerrë nga "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954), autori pohon se shtim më të madh kanë pasur kompozitat mbiemërore e pas tyre, ato emërore, sepse edhe temat emërore e mbiemërore në përbërje të këtyre kompozitave kanë valencë më të lartë në krahasim me temat e tjera që u përkasin pjesëve të tjera të ligjëratës. Mbi bazën e krahasimit të të dhënave të pasqyrave të hartuara për kompozitat e Fjalorit sipas pjesëve të ligjëratës, nxirret edhe një përfundim tjetër: "Valenca e lartë e temave emërore dhe mbiemërore përcakton edhe prirjet e zhvillimit të mëtejshëm të fjalëve të përbëra në gjuhën e sotme shqipe. Kjo do të thotë, – thekson ai, – që edhe në të ardhmen klasa e mbiemra-ve dhe e emrave do të ketë prirje për t'u shtuar më shumë me njësi të përbëra. Është, gjithashtu, e rëndësishme të theksohet, – shton më tej autori, – se ky shtim i mbiemrave dhe i emrave të përbërë sjell në tërësi rritjen e kategorisë leksikore të emrit dhe të mbiemrit në gjuhën e sotme letrare shqipe, madje jo vetëm për etapën e tanishme të zhvillimit të saj, por edhe për të ardhmen".

Një tjetër trajtim shkencor me interes i është bërë leksikut me burim popullor me vlerë letrare potenciale për gjuhën e sotme shqipe në disa artikuj studimorë: "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" (1980) dhe leksiku popullor me vlerë letrare potenciale", "Rreth disa vlerave letrare potenciale të leksikut popullor për gjuhën e sotme shqipe" etj.

Në artikullin e parë nënvizohet fakti se një ndër veçoritë dalluese të këtij Fjalori është se ka përfshirë në fjalësin e tij një numër të konsiderueshëm njësish leksikore popullore me prejardhje krahinore, të panjohura ose pak të njohura deri atëherë në gjuhën letrare. Është një zgjidhje krejt e ndryshme nga ajo e shumë fjalorëve shpjegues të gjuhëve të tjera, si të rusishtes, të bullgarishtes, të rumanishtes etj., të cilët leksikun popullor me burim krahinor e pasqyrojnë vetëm mbi bazën e përhapjes së tij të gjerë, tej kufijve vendësorë, ose mbi bazën e përdorimit të tij mjaft të gjerë në gjuhën letrare, sidomos në letërsinë artistike. Kjo zgjidhje origjinale është mbështetur në parimin udhëheqës më të përgjithshëm për zgjedhjen e fjalësit, sipas të cilit "vlerësimi i çdo fjale-leksemë (për ta futur ose jo në Fjalor) duhet bërë, në radhë të parë, jo sipas burimit dialektor, as sipas burimit letrar, por sipas vlerës së saj objektive në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare".

Në artikullin e dytë autori është ndalur në fushat leksikore që kanë gjetur mjaft vend në këtë Fjalor, si: leksiku etnografik, leksiku profesional (emërtime për vegla, mjeshtëri e zeje të ndryshme popullore, procese pune me këto vegla e pajisje, pjesë të tyre etj.), leksiku etnobotanik dhe etnozoologjik etj.

Një analizë e imët leksiko-semantike e fjalëformuese u bëhet edhe njësive leksikore që emërtojnë ngjyrat në studimin "Rreth emërtimeve të ngjyrave në gjuhën shqipe". Në studim sillet e shqyrtohet një pasuri e madhe e këtyre emërtimeve në shqipe. Ai mund të futet ndër studimet e rralla në literaturën gjuhësore, që analizon këtë pasuri leksikore të shqipes në përbërje të fushës konceptore të ngjyrave.

Për kulturën e gjuhës janë disa artikuj: "Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe", "Për anglicizmat në mjetet e sotme të informimit masiv", "Disa probleme të gjuhës së folur të mjeteve të informimit masiv", "Për fjalët e huaja të panevojshme në mjetet e informimit masiv", "Edhe një herë për gjuhën e televizioneve dhe të radiove tona" etj. Autori analizon shkencërisht qëndrimin ndaj anglicizmave. Për të përcaktuar gjuhësisht në mënyrë objektive vendin që huazimet angleze zënë a mund të zënë në gjuhën e sotme shqipe, autori shtron disa kritere, të cilat mund të vlejnë njëherazi për të gjitha huazimet: 1- a jepet fjala e huazuar angleze a me prejardhje nga anglishtja me mjetet fonetike të shqipes e sipas drejtshkrimit të saj; 2- a mund të sillet në kategorinë leksiko-gramatikore përkatëse të shqipes; 3- a është aktive fjala e huaj, domethënë, a bën pjesë ajo në shtresën aktive, pak aktive apo pasive të leksikut e të terminologjisë; 4- ç'jep më tej nga pikëpamja fjalëformuese, domethënë ç'valencë të brendshme ka: a shërben si temë për formime të reja, a vijnë prej saj kalke, gjymëkalke etj.; 5- ç'sjell nga pikëpamja kuptimore: ç'semantikë zgjeron; a rikuptimësohet në gjuhën shqipe, domethënë, a zhvillon kuptime të reja; a krijon varg sinonimik me fjalë të tjera të gjuhës ose a i zgjeron më tej të tilla vargje; a kemi ndikim semantik në sinoniminë vendëse, domethënë, a lind ndonjë kuptim i ri ose ngjyresë e re kuptimore, stilistikore si rrjedhojë e induksionit semantik; 6-cila është valenca e jashtme e fjalës së huazuar a me prejardhje të huaj, cila është mundësia e bashkëlidhjes së kësaj fjale në ligjërim etj. Bazuar mbi këto kritere, autori jep në artikujt e vet edhe një pasqyrë të gjerë me anglicizma të nevojshëm e të panevojshëm për gjuhën shqipe.

Artikujt për leksikografinë janë të shumtë. Ata mund të klasifikohen në dy grupe: 1- artikuj problemorë, si: "A duhet të përfshihen dialektalizma e krahinorizma në një fjalor shqip – gjuhë e huaj?", "Për një fjalor të përgjith-shëm dialektor të gjuhës shqipe", "Fjala bashkë me fjalën", "Për një fjalor drejtligjërimor të gjuhës shqipe", "A duhet botuar një fjalor shkollor i gjuhës shqipe?" etj.; 2- disa artikuj recensionues për disa vepra leksikografike, si "Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe" i M. Samarës, "Fjalor shqip-anglisht i Oksfordit (Oxford Albanian-English Dictionary) i L. Njumarkut, i botuar në një variant më të shkurtuar edhe në Revistën Ndërkombëtare për Leksiko-grafinë (International Journal of Lexicography), "Fjalor arabisht-shqip" i S. Tomçinit, "Fjalor persisht-shqip", hartuar nga një grup autorësh etj. Veçanërisht në artikullin "Fjalor shqip-anglisht i Oksfordit" të L. Njumarkut bëhet një analizë e imët leksikografike e shqyrtohen objektivisht arritjet dhe mangësitë e këtij Fjalori dygjuhësh.

Një vend të rëndësishëm zënë edhe artikujt recensionues për disa monografi me karakter leksikologjik, si: "Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme" e J. Thomait, "Parafjalët në shqipen e sotme" e M. Samarës, "Termi dhe fjala në gjuhën shqipe" e A. Duros, "Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor në viset veriore të Shqipërisë (në përqasje me të folmet e tjera të gjuhës shqipe)" e S. Pepës etj.

Një shkrim më i veçantë, por, sigurisht brenda tematikës së përgjithshme të kësaj përmbledhjeje është "Profesor Androkli Kostallari – personalitet i shquar i shkencës dhe i arsimit". Është një vlerësim i merituar për veprën e tij studimore në nivel europian, për udhëheqësinë e tij shkencore në krye të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë e brenda tij, të Sektorit të leksikologjisë e të leksikografisë, për punën e tij dinjitare në shërbim të studimeve shqiptare.

Studimet dhe artikujt janë strukturuar logjikshëm sipas tematikës që mbulojnë.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Halil Kaçi, *miku i bujqësisë*

Nga **Metush SKEJA**

Halili Kaçi është zemërbutë, por jo mendjelehtë. Respekton arsyen. E ka dashtë punën dhe njerëzit e punës. Puna i ka dhënë qëllim jetës së tij. Ka qenë miku i punës. Kjo i ka dhënë rregull e dinjitet.



Halil Kaçi, foto 2008

Halil Kaçi është agronom dhe gjithë jetën ia ka kushtuar bujqësisë në rrethin e Dibrës. Edhe sot në pension, shfaq interes për të mirën publike, zhvillimin e modernizimin e bujqësisë. Në shtator 1961 ka filluar shkollën e mesme bujqësore në Peshkopi dhe ka dalë në pension në vitin 2011në drejtorinë e bujqësisë Dibër. Plot 51 vjet rresht është marrë duke studiuar bimët dhe duke u shërbyer atyre.

Halil Kaçi u lind në Vleshë. Prindërit e tij kanë qenë njerëz të dlirët e bujq të mirë. Ka qenë familje e madhe. Kanë pasur një shtëpi dykatëshe me gjashtë dhoma dhe një tjetër me katër dhoma. Dhoma e burrave dhe e miqve ka qenë e madhe veçmas me të grave e të fëmijëve. Përpara shtëpisë shtrihej oborri i sheshtë, i gjerë, i gjatë e i mbushur me pemë. Kanë pasur në oborr dy mana, njëri i bardhë e tjetri i zi. Pak më larg mollë vendi të ëmbëla e disa rrënjë rrush. Përreth shtëpisë trëndafila me petale të vogla dhe erëmirë. Nuk mungonin lulet e mëllagës, krizantemat, shpatoret. Jashtë avllisë kanë pasur bahçen me peme drufrutorë e rrushsi dhe kopshtin e perimeve. Si çdo familje vleshase kanë pasur arra në mejat e arave e vende joprodhuese. Përpunimi i frutave ka qenë artizanal.

Familja Kaçi ka pasur tokë arë të vetëmjaftushme për tu ushqyer dhe për treg. Ajo e ka punuar tokën me shumë kujdes ashtu si dhe familjet e tjera të zonës. Vjeshta ka qenë me lëmenj plot. Prodhonin misër, fasule, grurë, fruta, jonxhë. Kanë mbajtur blegtori sipas mundësive, por asnjëherë nuk i kanë hequr, veçse në kohën e tufëzimit.

Halil Kaç i ka tejkaluar prindërit, i vetëdijesuar për përparësitë e tij në jetë. Ai ka marrë edukim shkollor në institucionet arsimore të konsoliduara. Ka pasur mësues të ditur e të përkushtuar në arsimin e detyruar shtatëvjeçar, mes të cilëve ka qenë Rruzhdi Biba. Ka qenë fat që është mësuar nga mësues Rruzhdiu. Shkolla shqipe në zonën e Sllovës është hapur më 1914, kurse shkolla shtatëvjeçare pas Luftës Dytë Botërore. Halili ka qenë nxënësi më i mirë i klasës tij edhe ndër më të mirët e shkollës.

Në vitin 1961 ka filluar shkollën e mesme bujqësore në Peshkopi. Ajo ka qenë shkollë profesionale rajonale për gjithë veriun e Shqipërisë. Ka pasur mësuesit më të zgjedhur. Baza prodhuese dhe eksperimentale të kujtonte një shkollë perëndimore. Nuk mund të lë pa përmendur drejtorët e shkollës. Ato kanë qenë personalitete te bujqësisë e arsimit. Do të përveçoj Tase Rada, Abaz Kaca, Moisi Cami. Sa më shumë ti kesh njohur, aq më shumë të shtohet respekti për to. Dy të parët kanë studiuar në Bullgari për shkenca bujqësore, ndërsa Moisi për shkenca biologjike në Tiranë. Shkolla e mesme bujqësore ka qenë katërvjeçare. Halili e ka mbaruar shkollën e mesme në vitin 1965. Në shtator të këtij viti ka filluar punën si agronom në kooperativën Vleshë-Kallë, ku ka qëndruar një vit. Më pas e kanë transferuar në kooperativën Kala-Radomirë në vitet 1966-1968.

Në vitet 1960bujqësia ka bërë rrugë të rrëmbyer. Kishte filluar revolucioni i gjerbërt. U futen në mënyrë sistematike kultivarë të drithërave me prodhushmëri të lartë. Nga ana tjetër këto kultivarë të ri kërkonin metoda e teknologji të veçantë. Halili e vrojtonte nga larg këtë bum të bujqësisë. Kërkon të bëhet subjekt i këtij revolucioni të gjelbërt , por revolucioni kërkonte pjesëmarrje, koncepte modern dhe dije teorike . Së brendshmi, Halili ishte i pakënaqur për sa kishte arritur, individualist për ti shumëfishuar dijet e tij në fushën e bujqësisë në mënyrë programore. Përgatiten dokumentet e i pranohet e drejta të studioi në arsimin e lartë drejtimi bujqësor.

Fatin e prekën me dorë, ose fati e dërgon ku dëshiron Halili. Me plot ndezulli e vullnet niset vetëtimthi në Tiranë. Universiteti bujqësor është ndërtuar në Kamëz mbi një kodër të bukur . Për studentin e vitit të parë ky Universitet i sillte në kujtesë kështjellën e Trojës të mësuar në letërsia e bukur greke. Por nuk është kollaj për tu marrë kjo fortesë. Kishe pritur tre vjet pas mbarimit të shkollës mesme, që të frynin erërat, për tu nisur drejt kështjellës e cila kishte romantizëm, ritëm e xanxat e veta. Në shtator 1968 Halili ka nisur studimet në UB Kamëz dega agronomi, pesë vjet, koha e plotë. I ka përfunduar studimet në qershor 1973 me formim akademik solid. Halili ka qenë i përpiktë në auditore, leksione, seminare, punë laboratori, detyra kursi, punë praktike, në çdo gjë që ka pasur lidhje me edukimin në atë institucion të arsimit të lartë. Jo vetëm kaq, por edhe për t'i zënë dora e kthyer në shprehi gjërat praktike të bujqësisë. Ka qëndruar me orë të tëra çdo ditë në bibliotekë e natën vonë pa gjumë në dhomë mbi libra, për tu përgatitur vijimsisht. Nëse do të shprehsha me një togfjalësh ose me një cilësor -njeri I lexuar. Me vetëvlersim të lartë. I vetëdisiplinuar. Unë, do të doja të sjell për lexuesit e të këtij shkrimi një fjali që më sillet përpara syve të mi dhe përbën filozofinë e jetës së Halilit. "Mund t'u japim forcë fateve tona individuale e kolektive". (Barak Obama, *Guxim për të shpresuar*, Tiranë, 2008, f. 46)

Bimët bujqësore janë qenie të gjalla. Ato kanë filluar të kultivohen para njëqind shekujsh. Dua të sjell në kujtesë të lexuesve se ilirët para tetëmijë vjetësh kanë nisur kultivimin e grurit, po kështu edhe të shumë bimëve të tjera. Studimet tregojnë se në këtë kohë ka ardhur gruri në kontinentin tonë, të marrë nga shumerët. Përvojë kolosale për tu asimiluar nga studentët. Kultivimi i bimëve dhe zbutja e kafshëve ka bërë të mundur që njerëzit të nguliten për të jetuar në vendbanime të përhershme. Duke pasur me çfarë të ushqeheshin u shtua numri i njerëzve. Revolucioni bujqësor shkaktoi jetë sedentare. Lindën fshatrat. U krijua tepricë ekonomike. Lindi pushteti komandues për ti mbrojtur këto teprica. U shfaq hierarkia. U rrit jetëgjatësia e njerëzve. U shtua popullsia. Unë nuk e dijë se sa ka qenë popullsia e botës para fillimit të revolucionit bujqësor, por ka të dhëna se "Në vitin 1 (një) të erës sonë popullsia e botës numëronte 150 milion banorë". (Zyri Bajrami& Neila Bajrami, *Gjenetika e njeriut*, Tiranë, 2007. f. 167) Deri në vitin 1700 kur ndodhi revolucioni industrial popullsia e globit ishte rritur qindra herë në saj të ushqyerit më të mirë. Përherë bujqësia përbën bazën e të ushqyerit tonë. Për aksh njeri që studion për bujqësi i din shumë mirë këto që thashë më sipër. Nga ana tjetër studimet për bujqësi përdegëzohen në njohjen e qelizës, biologjisë e biologjisë molekulare, të teorisë së përzgjedhjes, gjenetikës, hidroteknikës, menaxhimin e forcave njerëzore e teknike. Sa më shumë t'il njohësh aq më shumë dalin probleme. Halil Kaçi ka qenë i vetëdijshëm për gjerësinë e lidhjeve të shumanshme të shkencave bujqësore me dijet e shkencave të tjera gjatë kohës student I bujqësisë e më pas.

Kur Halili mbaron studimet e ka shkuar agronom në Dibër, por është ballafaquar me disa përvoja. Nga njëra anë dibranët kanë qenë e janë bujq të mirë e nga ana tjetër Halili ka gjetur agronom të talentuar, që kanë qenë marrë për shumë vite me bimët. Brezi i parë i perfesionistëve të bujqësisë janë të shkollës së Harry Fultz. Shkollë amerikane e bujqësisë që bazohet në filozofinë pragmatiste. Shkolla më e suksesshme në botë. Studentë të kësaj shkolle në Dibër janë Xhavit Hysa, Xhetan Xhika, Xhevat Xhidra, Sabri Kola. Grupi i dytë i agronomëve janë Xhevat Dani më shokë. Halili vjen pas tyre si moshë dhe është rreshtuar i miri ndër të mirët. Lëvizjet e shpeshta e kanë ndihmuar të njohë jetën e njerëzve me gjithë problematikat e veta. Nga ana tjetër jeta është e mbushur me marrëdhënie me njerëz që nuk i kemi zgjedhur, por kemi nevojë të ndërveprojmë. Halili Kaç e ka njohur shumë mirë marrëdhënien. Njeri zemërbutë, por jo mendjelehtë. Vende-vende skeptik. Njeri që respekton arsyen. E ka dashtë punën, e njerëzit e punës. Puna i ka dhënë qëllim jetës së tij. Ka qenë miku i punës. Kjo i ka dhënë rregull e dinjitet.

Nga korriku deri në shtator 1973 ka qenë agronom në kooperativën e Çidhnës. Nga janari1974 deri më 1987 ka qenë agronom në drejtorinë e ujërave Peshkopi, që përfshitë bashkinë Peshkopi dhe bashkinë Bulqizë. Rendimenti në bimët e kultivuara është madhësi funksionale, ku variabli kryesor është ujitja në stinën e verës, ose e thënë ndryshe ujë përbën operatorin më të rëndësishëm në barazimin e procesit të fotosintezës, të krijimit të lëndës organike nga substance jo organikë.

Vetëm territori që shtrihet sot në bashkinë Peshkopi ka 615 km kanale të para ujitëse. Kjo, përafërsisht, e barabartë me rrugën automobilistike Peshkopi -Sarandë. Shto këtu edhe kanalet ujitëse qëpërfshihen në bashkinë Bulqizë. Hapësira që përfshihet sot në Bashkinë Peshkopi ka20 ujëmbledhës më aftësi ujëmbajtëse6. 8 milion metra kub ujë ose sa 15% të liqenit të hidrocentralit të Komanit. Gjatësia e kanaleve të ujëmbledhësve është 86km përafërsisht sa Rruga e Arbërit. Bashkia Peshkopi ka 18433ha tokë nën kultura me aftësi ujitëse 10047 ha. Në çdo ha misër është shpenzuar afro 5000-6000 metra kub ujë. Duke iu referuar kulturës së misrit, Dibra përdorte afro 10 milion metra kub ujë gjate një sezoni në misër. Shto këtu edhe sasinë e ujit në kulturat e tjera e pemëtore, shifra del e madhe.

Bashkia Peshkopi ka një rrjet prej 138 km kanale kulluese kryesore . Peshkopia ka pasur100% të tokës fushore të kullueshme. Tokat malore e kodrinore nuk kanë nevojë për largim ujërash të tepërta.

Detyra e Halil Kaçit si agronom ka qenë punë kolosale. Të gjitha shifrat e thëna më lart i ka mbajtur në parametra të kënaqshëm. Gjatë stinës së verës kanalet kanë qenë plot me ujë e dimrit pastroheshin nga inertet. Në vitin 1975 Halili ka bërë gjashtë muaj trajnim në UB Kamës për kullimin e tokave , duke u njohur me përvojën më të mirë në shkallë kombëtare e më gjerë.

Në mars 1989 deri janar 1993 Halili ka qenë kryeagronom në stacionin e makinave e traktorëve në Dibër. Makineritë kanë qenë prodhim i vjetër sovjetik e kinez. Me këto makineri duhet të punonte 13902 ha tokë e mbjellë. Grurë 4480ha me 21kv/ha, misër 1810 ha me rendiment23. 4kv/ha, patate 702ha me 40 kv/ha. Natyrisht Halili nuk ka qenë i vetëm. Kanë qenë edhe plot agronom të tjerë të talentuar e punëtorë krahu të bujqësisë. Më 1990 Dibra që përfshin sot bashkinë Peshkopi dhe bashkinë Bulqizë ka pasur 1. 25 milion rrënjë peme frutore, ose numrin më të madh të pemëve frutore se çdo rreth tjetër i Shqipërisë. Pasuri kombëtare kolosale. Gjatë kohës së monizmit prodhohej. Shpërndarja ka qenë shumë e keqe. Njerëzit që prodhonin grurë, mollë, arra, qershi etj nuk i kanë pasur në shtëpi këto produkte. Aq më pak fëmijët. Produkti i punës tyre ikte tjetër kund.

Në vitet 1993 deri më 2011 Halili ka qenë agronom në drejtorinë e bujqësisë të qarkut Dibër. Në vitin 1990 kanë ndodhur ndryshime të mëdha në marrëdhëniet e pronës mbi tokën. Hapja e vendit liberalizimi i tregjeve kërkon të ballafaqohesh me teknologjitë e sotme të rritje së bimëve. Ndryshoi raporti i agronomit me bujqit, por nuk ndryshoi raporti miqësor i agronomit me bimët. Këto të fundit janë bujare, por fshehin edhe të panjohura. Në vitin 1993 Halili mësoi TI. Nuk u çorientua. Hapi librat. Studioi përvojën e vendeve përreth e me gjerë. Iu përshtat mirë kohës, por gjithnjë ka mbajtur distancë nga përkatësia partiake e politika. Nuk i ka dashtë angazhimet politike, ose në një farë mënyre i ka parë me përbuzje. Nëse ka pasur ideologjizim në ndërgjegjen e tij ka qenë përkushtimi ndaj bimëve të gjitha llojeve dhe rritja e rendimenteve në njësi sipërfaqe. Parë në tërësi, jeta e ndërgjegjshme e Halil Kaçit ka pasur si bazë teorike pragmatizmin.

Halil Kaçi ka rritur e edukuar pesë fëmijë. Secili më qytetar se tjetri. Pensionin po e jeton në kryeqytet, në një nga lagjet më të bukura e qytetare. Por jo pasojat e lodhjes së punës tij të ngulmët e të gjatë se sa të problematikave të moshës. Rituali i çdo dite ka qenë, ngritja herët në mëngjes, pinte një kafe në një nga lokalet e qytetit dhe në orën 7 gjendej në punë. Në darkë kthehej në shtëpi. Puna i merrte shumë energji, aq sa i duheshin asaj. Nganjëherë puna i ka marrë më shumë energji se saka pasur ai. Kjo nuk e ka penguar të ketë jetën e tij sociale, lidhjet me njerëzit e tij të dashur, me ngjarjet e qytetit e vendlindjen. Ka punuar për realizimin e vetvetes. Nuk e ka tjetërsuar lirinë e tij. Halili vishet bukur, por jo modern. Flet me etiketë e fjalor të pasur si intelektual me klas. Unë i uroj jetë të gjatë.

kujtesë

Me rastin
e 60 vjetorit të lindjes

Lulzim Sharku, intelektuali me personalitet model

Lulzim Sharku lindi më 25maj 1956 në Klos. Prindërit e tij, babai Skënder dhe nëna Shyret, ishin mësues në Gur të Bardhë të rrethit të Matit.

Familja e Skënderit ishte nga Dibra e Madhe. Si pasojë e gjenocidit serb, më 1920 erdhi në Tiranë dhe merrej me një biznes të vogël. Më pas u zhvendos në Homesh të Dibrës, ku lindi dhe u rrit Skënderi. Ai ishte nip i Loke (Mustafa) Demës, një patrioti bashkëkohës e vëlla i Mersim Demës, që luftoi për çlirimin e Shqipërisë, konsolidimin e pavarësisë dhe hapjen e shkollave shqipe.

Mbas mbarimit të shkollës pedagogjike në Peshkopi, si maturant i parë i saj më 1952, Skënderi filloi punë si mësues në Shupenzë dhe Zerqan, ku u njoh edhe me mësuesen e re, edhe ajo me origjinë nga Dibra e Madhe, por rritur jetime në Gjoricë në familjen e patriotit Latif Shehu (Sheh Latifi). Gjyshja e Lulit nga nëna ishte nga Struga, ndërsa gjysh Edipi nga Dibra e Madhe, i cili qe burgosur në vitet 1948-953, si punonjës i administratave të Mbretit Zog. Mbas martesës, Skënderi me Shyretin punojnë si mësues në Shupenzë e Gur i Bardhë. Në vitin 1961 u transferuan për të punuar si mësues në Bulqizë. Skënderi derisa ndërroi jetë (1983) dhe Shyreti derisa doli në pension (1988). Për punën e tyre të lavdëruar gëzuan gjithmonë respektin e mbarë opinionit shoqëror. Skënderi është dekoruar me Urdhrin "Naim Frashëri" kl.III dhe ka marrë titullin "Qytetar Nderi i Bulqizës"(2012), ndërsa Shyreti, "Qytetare nderi e Gjoricës" (prill 2012), si mësuese, e para femër në Grykë të Vogël të Dibrës. Luli ishte fëmija i parë i çiftit të ri, pas tij lindën edhe tre djem tjerë: Agroni, Mehmeti dhe Genci. Që të katër djemtë, nën shembullin dhe kujdesin e prindërve të tyre, mbaruan studimet e larta duke reflektuar në punë të suksesshme dhe të respektuar në çdo komunitet. Vëllai më i vogël, Genci, u zgjodh dhe Deputet i Kuvendit të Shqipërisë në vitet 2005-2009 dhe më pas Prefekt i Dibrës (2010-2012).

Arsimin fillor dhe 7-vjeçar, Luli e kreu në Bulqizë, ndërsa gjimnazin në Peshkopi, me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 1974 u shpall fitues i olimpiadës kombëtare të matematikës. Mbas mbarimit të gjimnazit, punoi 3-4 vjet punëtor e mekanik në minierën e Bulqizës. Në vitet 1979-'83 mbaroi me rezultate të shkëlqyera, Fakultetin Ekonomik me profil bujqësor në Kamëz. Me mbarimin e studimeve emërohet llogaritar në koop. bujqësore Fushë- Bulqizë, në vazhdim shef llogarie po aty. Në vitin 1987 kalon shef llogarie në NB-në e Bulqizës, ku u shqua për profesionalizëm e përkushtim në studimin e përvojave pozitive dhe kualifikimin profesional të tij. Si rezultat, më 1989, fitoi konkursin e shpallur nga gazeta "Mësuesi" për pedagog në Fakultetin Ekonomik të Kamzës. Në



vitin 1991 fillon punë në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Ekonomik (në katedrën e Biznes-Financës). Më 1992 ndjek për dy vite Universitetin BOCONI në Milano, bëhet Laurant për Ekonomi-Biznes, duke marrë titullin "Lektor" të këtij specialiteti në Universitetin e Tiranës.

Në vitin 1993 studion dhe mbron Doktoraturën në Universitetin Nebraska (SHBA) me temë "Sistemi financiar i bankave në ekonomitë në tranzicion". Në të njëjtën kohë krijoi dhe drejtoi një OJQ të quajtur S.E.G. Më 1994 bëri 4 muaj specializim për "Informatikë të sistemit financiar" në Mynih.

Në vitin 1995, Drejtor i Bankës Kombëtare Agrare, ku menaxhoi borxhet e trashëguara në vite, duke bërë bankën lider për financimin e biznesit dhe mirëfunksionimin e ekonomisë shqiptare si ekonomi agrare. Pas mbylljes së bankës agrare, profesor në Fakultetin Ekonomik. Lulzim Sharku ishte një djalë i pasionuar pas profesionit. Në kushtet e ekonomisë së tregut ai hodhi bazat për një biznes privat (DUR - AL), duke perfeksionuar vazhdimisht prodhimin me teknologjinë bashkëkohore, në bashkëpunim edhe me vëllezërit e tij. Ai ishte një humanist i madh, i donte dhe i respektonte njerëzit. Mori në punë në biznesin e tij, njerëz pa të ardhura e pa përkrahje, kryesisht nga Bulqiza, dhe i kualifikoi ata për proceset e punëve që do të bënin. Lulzim Sharku ishte altruist i madh, kontribues shembullor në kohën e eksodit të kosovarëve , duke ndihmuar dhjetëra familje në nevojë; me dijet dhe përvojën që kishte ndihmoi pa rezerva studentë dhe kolegë, si pedagogë, por edhe si biznes. Ai ishte shumë i thjeshtë në marrëdhëniet shoqërore, gëzohej për sukseset e kolegëve dhe të familjarëve të tyre; ishte një organizator i përkryer në eventet me të afërmit, shokët dhe miqtë e tij.

Më 1998 u martua me Mimoza Sadik Vokshin, pedagoge në Fakultetin Ekonomik. Ata trashëguan vajzën Ajlin dhe djalin Keni, që të dy të shkëlqyer në mësime. Në vitin 1998 mbrojti doktoraturë në Fakultetin Ekonomik me temë "Privatizimet strategjike të vendeve në tranzicion", që gjeti jehonë si në

Lulzim Sharku përbënte në vetvete një personalitet me vlera të mëdha, aq të domosdoshme për ekonominë shqiptare. Megjithëse jeta e tij qe e shkurtër, puna e tij e vlerësuar, njohuritë, pjekuria dhe puna krijuese përbëjnë një shembull që duhet ndjekur nga brezat e rinj.

opinionin mediatik, ashtu dhe në implementim në ekonomitë lindore në tranzicion.

Luli qe një shembull i madh uniteti vëllazëror, gjë që përpiqej ta transmetonte edhe tek të tjerët, që nga më të afërmit me të, moshatarët e tij në Bulqizë, ku kaloi një pjesë të konsiderueshme të jetës, por edhe në Tiranë. Kudo e kurdoherë, me sjelljen e tij, jo vetëm admirohej, por gëzonte respekt në rrethet akademike, studentët dhe mbarë opinioni shoqëror.

Dashuria dhe respekti tij për prindërit përbën një shembull tjetër për brezin e ri. Këtë dashuri e respekt ai e shprehte, jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri, në ambiente festive dhe në jetën e përditshme. Si gjithë prindërit, ai jepte dashuri pa fund për fëmijët e tij, i stimulonte ata, duke shprehur kënaqësinë e madhe që ndiente për rezultatet e mira në mësime, kur merreshin me sport e muzikë, pasione pa kufi edhe për atë vetë. Luli nuk ndahej asnjëherë nga puna me librin, por edhe me muzikën e aktivitete sportive, si: futboll, ski, alpinizëm, etj. I rrethuar nga një mjedis ku respektohej gjithnjë, ai krijonte e të ngjallte admirim me sjelljen, edukatën dhe kulturën e tij. Ndërroi jetë mbas një sëmundje të papritur nga infarkti i miokardit, më 12 shtator 2003, në një moshë shumë të re, duke krijuar një boshllëk të madh për familjen, të afërmit dhe mbarë shoqërinë.

Lulzim Sharku përbënte në vetvete një personalitet me vlera të mëdha, aq të domosdoshme për ekonominë shqiptare. Megjithëse jeta e tij qe e shkurtër, puna e tij e vlerësuar, njohuritë, pjekuria dhe puna krijuese përbëjnë një shembull që duhet ndjekur nga brezat e rinj. Shoqëria ka nevojë për intelektualë të tillë. Me eksperiencën, studimet, analizat e përgjithësimet e realizuara në veprimtarinë akademike, përbëjnë një pasuri për t'u studiuar e vënë në zbatim.

Brezi me të cilët u rrit, të gjithë ata që e kanë njohur, familja dhe fëmijët, gjithmonë do ta kujtojnë dhe nderojnë Doktorin e Shkencave Lulzim SHARKU!

Zabit LLESHI
Mehdi DEMA

Gjokë Basha, njeriu që la një emër të mirë

Kujtesë në 1-vjetorin e ndarjes nga jeta

Kur udhëton me makinë në rrugën automobilistike nacionale nga Burreli për në Milot, po të ndalosh aty tek vend-toponimi "Koci i Kalit" dhe të hedhësh shikimin në drejtimin perëndimor, të shfaqet natyra e bukur e fshatit tradicional Stojan, që bën pjesë nnë Njësinë Administrative Ulëz, së bashku me fshatrat Lundre, Bushkash, Madhesh e Kokërdhok. Është një fshat kodrinor me një histori e kulturë të lashtë në Trevën e Matit, që bën pjesë në zonën e Rranxës, e cila për shumë kohë ka qenë Bajrak i Mirditës . Në këtë fshat ka banuar edhe Llesh Basha, njeri nga kontribuesit gjatë historisë në këtë fshat, i veshur si bartës i vlerave atdhetare, patriotike, luftarake dhe punëtore, mikpritëse e bujare, pinjoll të të cilit janë dy djemtë dhe katër vajzat e tij, respektivisht djemtë Gjoka, Ndueja dhe vajzat Prena ,Mrika, Luka dhe Tina. Fatkeqësisht sot rrojnë vetëm Ndueja dhe Tina, të tjerët janë ndarë nga jeta. Në këtë shkrim të shkurtër do të skicojmë portretin e Gjokës, biri i Lleshit, i cili është lindur më 12 shkurt të vitit 1928.

Nën kujdesin e prindërve, të atit, Lleshi dhe të së jëmës Dila, Gjoka mundi të përfundojë vetëm shkollën fillore dhe atë 7-vjeçare. Falë dëshirës e pasionit të tij, më pas mori mësime audodidakte nga Kisha Ungjillore në Stojan, institucioni kishtar i madh dhe më i rëndësishëm në Bajrakun e Rranxës. Në këtë kishë për shumë vite kanë shërbyer, frati i parë Robert Ashta dhe të tjerë famulltar me emër, si i mirënjohuri Marin Serdani, i cili ka qenë dhe nje studiues e publicist i njohur në fushën e historisë kombëtare shqiptare.

Pajisja me dije në fushën kishtare i shërbeu Gjokës, jo vetëm thjeshtë botës së tij shpirtërore, por dhe për të propaganduar vlerat e rëndësishme që kishin institucionet kishtare për formimin dhe edukimin e banorëve ndër breza. Si njeri me besueshmëri të lartë politike, shërbimin ushtarak të detyrueshëm e kreu në një vend strategjik ushtarak, në Sazan të Vlorës, ku u shqua për përkushtimin e tij në plotësimin e detyrave në fushën e mbrojtjes. Kjo kohë në ushtri i shërbeu formimit të tij me dije dhe ideologji të përparuar, dhe me kthimin nga ushtria punoi në disa sektorë të disa ndërmarrjeve ekonomike në rrethin e Matit, si në kooperativën bujqësore, në minierën e bakrit në Kurbnesh, në ndërmarrjen e fermës bujqësore etj.

Në intervale të ndryshme kohore ka kryer edhe detyra në role drejtuese të këtyre ndërmarrjeve , si dhe ka kryer edhe detyra shoqërore, si në organizatën e rinisë, në Bashkimet Profesionale, si i zgjedhur për meritat e tij. Ishte njeri i thjeshtë, i dashur me shokët, i gatshëm për të t'u gjendur pranë njerëzve, në raste nevoje, ishte dhe mjaft human.

Për punët e kryera me përkushtim e me cilësi të lartë, për aktivitete shoqërore të shumta e të rëndësishme, gjatë kohës është nderuar me medalje pune nga ish-Presidiumi



i Kuvendit Popullor, si dhe është nderuar me shumë Fletë Nderi e Lavdërimi në vendet e punës ku ka punuar në rreth.

Gjoka, përveçse ishte një punonjës i devotshëm dhe një familjar e prind shembullor. Me bashkëshorten e tij, Dilën, bijë kjo nga një derë e nderuar , lindën e rritën ,dhe edukuan 11 fëmijë, respektivisht djemtë Kolën, Lekën e Yllin, dhe vajzat Lizën, Martinën, Kristinën, Agen, Terezën, Donikën, Letën dhe Florindën. Që të gjithë fëmijët e tij, në saj të edukatës së shëndoshë që iu ka dhënë i ati i tyre, Gjoka, së bashku me Dilën, janë bërë njerëz me personalitet, të devotshëm për familjen e për shoqërinë, atje ku banojnë së bashku me pjestarët e familjeve të tyre, punojnë e gëzojnë dashurinë e respektin e shoqërisë që i rrethojnë. Gjoka, edhe pas daljes së tij në pension nuk e ndaloi veprimtarinë e tij, si aktivist shoqëror. U dallua gjatë periudhës së ndryshimeve politike, duke kontribuar në zhvillimet demokratike, si një domosdoshmëri për të sotmen dhe për të ardhmen e shoqërisë. Janë të shumtë bashkëmoshatarët dhe bashkëpunëtorët e tij të punës e të jetës, që japin përshtypjet e bëjnë vlerësime të larta për Gjokë Bashën. I tillë ka qenë dhe Ramiz Totraku, i cili e ngre shumë lart kontributin dhe vlerat e tij: ". . . Gjokë Basha – ka thënë ai, - bën pjesë në atë grup njerëzish që për sjelljen, punën dhe kontributin e tij, do të mbetet i paharruar, . . . prandaj shoqëria duhet ta vlerësojë në vazhdimësi. . .". Ndërsa nipi i Ramizit, që e ka njohur nga afër, ndër të tjera thotë: ". . . Gjoka, me inteligjencën e lartë prej natyre, me paraqitjen e tij elegante, me sjelljen e tij shembullore në lagje, shpaloste vlera të larta qytetarie, jo vetëm për trashëgimtarët e tij, por dhe për banorët e lagjes e më gjerë për tërë komunitetin, si një pikë referimi për të tjerët në sensin pozitiv, me të gjitha cilësitë karakteristike shqiptare . . .".

Më 16 qershor 2015, në moshën 87 vjeçare u nda nga jeta, iu nda gjirit të familjes e të shoqërisë, duke lënë në pikëllim të thellë, por që do të nderohet e kujtohet gjatë e do të jetë i paharruar. Familja dhe shoqëria kanë humbur modelin progresiv të Gjokës, që duhej ta kishin pranë si udhërrëfyes gjatë jetës. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij.

Renato TOTRAKU

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj



Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

Klinika Mjekësore "VENIS"

Klinika mjekësore "VENIS" është klinika e parë private e Shëndetit Mendor në Shqipëri, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një aktivitet i tatueshëm.

Në klinikën "VENIS" ofrohet një shërbim i standarteve bashkëkohore si përsa i përket diagnostikimit dhe opsioneve të trajtimit mjekësor jo vetem me skemat e mjekimeve më të reja me barna por dhe me aplikimin e terapisë biologjike të elektrokonvulsoterapise ECT-Thymatron IV (Teknologjia më bashkëkohore), për trajtimin e pacientëve, te të cilët trajtimi i mëparshëm me barna nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

1. **DIAGNOSTIKIM**. Procesi i diagnostikimit të çrregullimeve psikologjike apo psikiatrike realizohet pas një ekzaminimi të kujdesshëm nga specialistët e shëndetit mendor të cilët janë psikiatrit ose psikologët klinikë.
2. **TRAJTIM I DEPRESIONEVE REZISTENTE.** Procedura e ECT-së është një procedurë që realizohet vetëm në klinikën "VENIS" në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare.
3. **TRAJTIM MJEKËSOR.** Në klinikët tonë ruhet privatësia e individit, respektohen dhe mirëkuptohen orientimi seksual, përkatësia etnike, gjinore, apo preferencat fetare.
4. **KONSULENCË PROFESIONALE LIGJORE.** Klinika mjekësore "VENIS" ju ofron informim dhe ndihmë konkrete ligjore mbi të drejtat e pacientëve.

MOS KINI PARAGJYKIME! Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

"Venis" ju ofron mbështetjen e duhur.
Klinika ofron shërbimet e saj vetëm në ditët e javës
Orari: 08:00 - 16:00 E Shtunë, E Diel dhe Festat zyrtare: PUSHIM
Vizitat kryhen me planifikim paraprak.
Kontakt: Sekretaria: **04 2400 669** dhe **068 23 96287**
E-mail: **sadikhlala@gmail.com**

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603